



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**KOSOVË: 2014-2018**

**STRATEGJIA PËR BASHKËPUNIM PËR ZHVILLIMIN E VENDIT**





# PËRMBAJTJA

	Faqe
Përmbledhje e Shkurtër .....	i
Akronimet .....	ii
Harta e Kosovës .....	iv
I. Konteksti Zhvillimor, Sfidat dhe Mundësitë .....	1
II. Hipoteza Zhvillimore .....	13
III. Korniza e Rezultateve .....	16
A. Deklaratë e Synimit Strategjik .....	17
B. Objektivi Zhvillimor (OZh) 1: <i>Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja ashtu që t'i Përbushin Nevojat e Qytetarëve</i> .....	19
C. Objektivi Zhvillimor (OZH) 2: <i>Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat</i> .....	27
D. Objektivi Zhvillimor (OZH) 3: <i>Të Forcohet Kapitali Njerëzor 3</i> .....	38
IV. Monitorimi, Vlerësimi dhe Mësimi .....	43
Shtojca 1: Treguesit e Performancës .....	47
Shtojca 2: USAID Forward .....	52
Shtojca 3: Bibliografia .....	54

## PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Strategjia e USAID-it për vitet fiskale 2014 - 2018 është e dizajnuar për të mbështetur arritjen e objektivit kryesor të politikës së jashtme të Qeverisë së ShBA-së i cili synon paqen dhe stabilitetin në Ballkan. Me qëllim që Kosova të bëhet shtet i suksesshëm, ajo duhet të ndërtojë kapacitetin e institucioneve të saj qeverisëse, të përforcojë ekonominë e saj dhe të përmirësojë nivelin arsimor si dhe kualifikimin e qytetarëve të vet. Vetëm nëpërmjet arritjes së këtyre objektivave të ndërlidhura Kosova do të mund të integrohet në strukturat e Evropës Perëndimore dhe në strukturat Trans-Atlantike, dhe njëkohësisht do të sigurojë prosperitetin dhe stabilitetin brenda shtetit për tërë popullin e vet. Qëllimi i USAID-it, i cili gëzon qasje jashtëzakonisht të mirë brenda vendit, është që të vazhdojë punën krah-për-krah me institucionet e Kosovës dhe me donatorët tjerë në drejtim të këtij synimi.

Kjo strategji propozon një qëllim gjithëpërfshirës që *"Kosova të Bëhet Shtet Gjithnjë e më i Begatshëm, i cili në Mënyrë Progressive Integrohet në Komunitetin Euro-Atlantik, me Qeverisje më Efektive dhe më Llogaridhëse"*. Ky qëllim rrjedh drejtpërdrejtë nga planet e Qeverisë së Kosovës të cilat synojnë avancimin e rritjes ekonomike dhe përforcimin e institucioneve në të mirë të të gjithë qytetarëve. Kjo është në pajtim me *Strategjinë e integruar shtetërore për Kosovën (Viti Fiskal 2014-2016)* e cila rishtazi u miratua nga Qeveria e ShBA-së, e cila synon angazhim të vazhdueshëm dhe asistencë zhvillimore për Kosovën, për t'u siguruar *"...se ky cep i Ballkanit, i trazuar për kohë të gjatë nga tensionet dhe dhuna ndëretnike, do t'i bashkohet Evropës në tërësi, në liri dhe në paqe"*. Ajo gjithashtu është e përvijuar me Strategjinë e përbashkët rajonale të Departamentit të Shtetit/USAID-it, e cila artikulon zotimin e Administratës *"...që të sheh Ballkanin plotësisht të integruar në institucionet Euro-Atlantike si pjesë e Evropës demokratike dhe prosperuese"*.

**Objektivi Zhvillimor (OZh) 1: Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja Ashtu që t'i Përbushin Nevojat e Qytetarëve.** Ky OZh është përzgjedhur duke marrë parasysh gjendjen e tanishme të institucioneve demokratike brenda vendit të cilat janë të reja. Përkundër reformave institucionale, ende vazhdojnë të metat në zbatim, edhe pse në përgjithësi ekziston korniza adekuate e ligjeve dhe rregulloreve. Pavarësia e gjyqësorit dhe sundimi i ligjit mbesin të dobëta, përderisa mos-efikasiteti i vazhdueshëm brenda sistemit bën që gjyqësori të mos e luajë rolin e vet në mënyrë efektive. Deputetët e Kuvendit kanë kapacitet dhe aftësi të kufizuara teknike për të bërë analizë, për të hartuar legjislacion dhe për të siguruar mbikëqyrjen. Përparimi në bartjen e autorizimeve dhe përgjegjësi nga niveli qendror pengohet nga administratat komunale të cilat kanë aftësi të kufizuara në ofrimin e shërbimeve efikase publike, por edhe nga shërbyesit civil të cilët ndjekin interesat politike. Duke pasur parasysh këto rrethana, OZh1 do të fokusohet në ngritjen e aftësive zbatuese të sektorit gjyqësor, të sektorit ekzekutiv/të administratës lokale, dhe të sektorit legjislativ, dhe njëkohësisht do të adresojë çështjet e integritetit dhe të "zërit" të ngritur të shoqërisë civile.

**OZh2: Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat.** Kosova mbetet shteti më i varfër në rajon dhe vuan nga papunësia tepër e lartë. Ajo varet për së tepërmi nga importet dhe ka bazë shumë të vogël të eksportit. Mungesa e energjisë paralizon ekonominë, përderisa shfrytëzimi i përgjegjshëm i bazës së gjerë minerale të vendit pengohet nga kornizat rregullative konfuze, e cila zbatohet dobët, e ndonjëherë nuk ekzistojnë fare. Ky OZh do të adresojë zbutjen e këtyre rrethanave duke promovuar mjedisin më të favorshëm afarist, duke nxitur një ekonomi më të diversifikuar të udhëhequr nga rritja e sektorit privat, dhe duke vazhduar adresimin e nevojave të shtetit për energji.

**OZh3: Të Forcohet Kapitali Njerëzor.** Sistemi arsimor në Kosovë nuk adreson nevojat pedagogjike dhe nevojat për aftësimin e popullsisë më të re në Evropë, gjë që rezultoi në numër të lartë të rinjve të papunë pa aftësi apo kualifikime të cilat kërkohen nga ekonomia në rritje. Ky OZh do të vazhdojë të fokusohet në përforcimin e arsimit parauniversitar, të ofrojë trajnime të pjesëmarrësve, dhe nëse plotësohen parakushtet e caktuara, do të punojë me Universitetin e Prishtinës me qëllim të përmirësimit të menaxhimit dhe pedagogjisë në fakultetet kryesore.

## AKRONIMET

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
ZAM	Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve
ADS	Sistemi i Automatizuar i Direktivave (USAID)
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
SBZhV	Strategjia për Bashkëpunim për Zhvillimin e Vendit
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PGjS	Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisaarit)
DCA	Autoriteti për Kredi Zhvillimore (USAID)
DIA	Demokracia në Veprim (OJQ Kosovare)
OZh	Objektiv Zhvillimor
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Evropian (si dhe Konservimi i Energjisë)
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (tash Zyra e Bashkimit Evropian)
VPVZhe	Vizioni dhe Plani i Veprimit për Zhvillim Ekonomik (Qeveria e Kosovës)
FPM	Fundi i pavarësisë së mbikëqyrur (të Kosovës)
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë (Qeveria e Kosovës)
ESCO	Kompanitë për Kursim të Energjisë
FPM	Fundi i pavarësisë së mbikëqyrur (të Kosovës)
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
FAA	Ligji për Asistencë të Huaj (Qeveria e ShBA-së)
IHD	Investimet e Huaja Direkte
G2G	Qeveria-Qeverisë
NKG	Ndryshimi i Klimës Globale
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
GIZ	<a href="#"><u>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit</u></a> (Organizata Gjermane për Bashkëpunim Teknik, ish-GTZ)
BHK	Bruto të Hyrat Kombëtare
QK	Qeveria e Kosovës
QS	Qeveria e Serbisë
HICD	Zhvillimi i Kapacitetit Njerëzor dhe Institucional
IHM	Instituti Hidro-Meteorologjik (Qeveria e Kosovës)
ICITAP	Programi për Asistencë Ndërkombëtare në Trajnime në Hetuesinë Penale (Departamenti i Drejtësisë së ShBA-së)
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
ICO	Zyra Ndërkombëtare Civile për Kosovë
IFC	Korporata Ndërkombëtare për Financa
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IPA	Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (BE)
RN	Rezultatet e Ndërmjetme
KAEF	Fondi Kosovar-Amerikan për Arsim
ASK	Agjencia Statistikore e Kosovës
KEDS	Kompania për Distribucionin e Energjisë në Kosovë
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011-2016
KFOR	Forca e Kosovës (NATO)
KfW	<b>Kreditanstalt für Wiederaufbau</b> (Instituti për Kredi për Rindërtim)
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
IGjK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës



LGBT	Lesbian, Gej, Biseksual dhe Transseksual
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (Republika e Kosovës)
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Qeveria e Kosovës)
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (Qeveria e Kosovës)
ZAMV	Zyra Administrative në Mitrovicën e Veriut
MF	Ministria e Financave (Qeveria e Kosovës)
MD	Ministria e Drejtësisë (Qeveria e Kosovës)
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
NARUC	Shoqata Kombëtare e Komisionarëve Rregullator të Shërbimeve Komunale (ShBA)
NATO	Traktati i Atlantikut Verior
PKVM	Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin (Qeveria e Kosovës)
OJQ	Organizatë Joqeveritare
MRN	Menaxhimi i Resurseve Natyrore
VKO	Vlerësimi i Kapaciteteve Organizative
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
DVP	Dokumenti për Vlerësim të Projektit (USAID)
AKP	Agjencia Kosovare për Privatizim
PD	Zyra e Diplomacisë Publike (Ambasada e ShBA-së)
PMP	Plani për Monitorim të Performancës
PPP	Partneriteti Publiko-Privat
RAE	Pakicat Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovës
SL	Sundimi i Ligjit
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
SDC	Agjencia Zvicereane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
Nën-RN	Nën-rezultati i Ndërmjetëm
TIP	Trafikimi me Njerëz
USAID	Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UP	Universiteti i Prishtinës
USEA	Shoqata e Shteteve të Bashkuara për Energji
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USG	Qeveria e Shteteve të Bashkuara

## HARTA E KOSOVËS



## I. KONTEKSTI ZHVILLIMOR, SFIDAT DHE MUNDËSITË

### Konteksti Zhvillimor (Pasqyrë e Vendit)

Që nga hartimi dhe miratimi i planit strategjik të Kosovës për VF 2010-2014 nga USAID-i (i miratuar nga USAID/Uashington në muajin maj të vitit 2010), Kosova ka vazhduar me shtegun e saj të ndërtimit institucional, të trendëve ekonomik dhe pjesëmarrjes qytetare. Megjithatë përparimi nuk ka qenë i njëtrajtshëm dhe shumë kushte mbesin problematike.

Fundi i "pavarësisë së mbikëqyrur" në vitin 2012 dhe mbyllja e Zyrës Ndërkombëtare Civile (ICO) paraqiti sukses, dhe gjer tani 98 shtete kanë njohur shtetësinë e Kosovës. Institucionet qeveritare, në veçanti në nivel qendror, vazhdojnë të forcojnë operimin e tyre, përderisa decentralizimi i pushtetit nëpër komuna<sup>1</sup> po përforcon qeverisjen lokale dhe zhvillimin demokratik. Kosova ka një kornizë mjaft mirë të zhvilluar të ligjeve dhe politikave, edhe pse zbatimi i tyre shpeshherë ngecë. Gjatë tri viteve të kaluara nisën reformat fillestare brenda gjyqësorit. Ka pasur përparim në administrimin e zgjedhjeve konkurruese dhe kjo punë është kryer kryesisht në pajtim me standardet ndërkombëtare, edhe pse mbetet rreziku që parregullsitë në zgjedhje të nxisin konfliktin.

Megjithatë në nivel ndërkombëtar, dhe përkundrejt përparimit të arritur, Kosova ende ka mungesë të njohjes zyrtare nga shumë shtete. Kjo ka penguar anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara dhe në organizatat tjera botërore dhe ka bërë që Bashkimi Evropian të miratojë një politikë "neutrale ndaj statusit" në lidhje me Kosovën, gjë që pengon mundësitë e saj në promovimin e plotë të zhvillimit të vendit. Kjo gjendje drejtohet nga mos-vullneti i Serbisë që të pranojë pavarësinë e Kosovës dhe të ndërpresë përkrahjen e strukturave të saj ilegale qeverisëse në komunat me shumicë serbe. Raportet e fundit rreth procesit të negociatave në mes të Kosovës dhe Serbisë tregojnë mundësinë e normalizimit të marrëdhënieve<sup>2</sup>, por përparimi po arrihet me vështirësi. Gjer tani, sistemi "paralel" i qeverisjes në viset me shumicë serbe mbetet faktor i destabilizimit.

Përkundër reformave institucionale, ende vazhdojnë të metat në zbatim, edhe pse në përgjithësi ekziston korniza adekuate e ligjeve dhe rregulloreve. Pavarësia e gjyqësorit dhe sundimi i ligjit mbesin të dobëta, përderisa mos-efikasiteti i vazhdueshëm brenda sistemit bën që dega e gjyqësorit të mos e luajë rolin e vet në mënyrë efektive si kundërpeshë ndaj degës së ekzekutivit. Deputetët e legjislativit (Kuvendi i Kosovës apo Kuvendi Kombëtar) gëzojnë autonomi të kufizuar, dhe pejsazhi politik mbetet i dominuar nga dega e ekzekutivit dhe nga liderët e partive politike. Kuvendi i Kosovës ka kapacitet joadekuat për të bërë analiza, për të hartuar legjislacion dhe për të siguruar mbikëqyrje (të zbatimit të ligjeve). Përparimi në bartjen e autorizimeve dhe përgjegjësi nga niveli qendror pengohet nga administratat komunale të cilat kanë aftësi të kufizuara në ofrimin e shërbimeve efikase publike, por edhe nga shërbyesit civil të cilët ndjekin interesat politike në barrë të elektoratit. Sistemi arsimor në Kosovë nuk adreson nevojat pedagogjike dhe nevojat për aftësimin e popullsisë më të re në Evropë, e kjo dobësi në sistem paraqet një pengesë gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të shtetit.

Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajon dhe përballet me nivele të larta të varfërisë, papunësi masive (që në mesatare llogaritet të jetë 45%, për dallim për shembull nga Maqedonia me 37% dhe Shqipëria me 14%), varësia e rëndë nga importet dhe me sektor shumë të vogël të eksportit, dhe me mungesë të energjisë. Bruto të hyrat kombëtare (BHV) për kokë banori llogariten në 3,520 \$, dhe kështu

<sup>1</sup>Komuna paraqet njësinë themelore administrative në Kosovë. Janë 38 komuna, ku 10 prej tyre janë me shumicë të popullsisë serbe.

<sup>2</sup>Naim Rashiti, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Serbi dhe Kosovë: *Shtegu drejt normalizimit*, shkurt 2013.



Kosova radhitet në vendin e 93-të në botë, prapa Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës<sup>3</sup>.

Ekonomia ka vazhduar me normën e rritjes prej 3-5% për afro një dekadë gjer në vitin 2011. Agjencia Kosovare e Statistikave (AKS) përllogaritë se gjatë këtij trevjeçari (2013-2015) ekonomia do të rritet në mesatare për 4,7%, që është norma më e lartë mesatare në mesin e ekonomive të Evropës Juglindore. Megjithatë ritmi i rritjes fare nuk mjafton për të pasur efekte të dukshme në varfëri dhe papunësi. Për shembull, Banka Botërore përllogaritë se Kosova do të duhej që së paku të dyfishojë normën e rritjes dhe të arrijë së paku 12% rritje në vit për një dekadë të tërë për të arritur nivelin e tashëm të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) të Malit të Zi për kokë banori<sup>4</sup>. Thënë shkurt, hendeku në të ardhura në mes të Kosovës dhe shteteve tjera të Evropës Juglindore ka gjasë që të mbetet i thellë, përkundrajt rritjes më të madhe.

Kosova është duke bërë përparim të qëndrueshëm dhe të rëndësishëm makro-ekonomik si në ristrukturimin e fazës së parë (liberalizimi i çmimit, reformat në tregti dhe në shkëmbime të huaja si dhe privatizim) ashtu edhe në atë të fazës së dytë (politikat konkurruese dhe reformat në ndërmarrje, sistem bankar, infrastrukturë dhe reforma financiare jashtë bankare). Vendi ka performancë mjaft stabile ekonomike, edhe pse deficitin buxhetor në vitin 2011 është rritur në 4% të BPV-së. Vjelja e tatimeve është përmirësuar për 4% gjatë vitit 2012, në krahasim me periudhën e njëjtë një vit më parë. Megjithatë në vitin 2012 shpenzimet e Qeverisë së Kosovës tejkaluan të hyrat, gjë që rezultojë në deficit prej mbi 2%, dhe Ministria e Financave (MF) llogaritë se shpenzimet do të vazhdojnë të kalojnë të hyrat gjatë tri viteve të ardhshme. Kjo rritje e shpejtë në shpenzimet publike tani për tani është forca kryesore ngasëse prapa rritjes së investimeve. Investimi privat ka mbetur në 20-22% të BPV-së për pesë vitet e fundit, përderisa investimet publike janë rritur nga 5% në 12% të BPV-së.

Aktiviteti ekonomik është koncentruar kryesisht në sektorin e shërbimeve i cili është zgjeruar si rezultat i nivelit të lartë të remitancave dhe nga prezenca e madhe ndërkombëtare në Kosovë. Ende nuk ka pasur investim substancial produktiv në sektorin e mallrave tregtare<sup>5</sup>.

Deficiti i madh aktual (19% i BPV-së në vitin 2011) financohet kryesisht nëpërmjet ndihmave dhe remitancave. Në të vërtetë, Kosova është një nga dhjetë vendet me nivelin më të lartë të remitancave ku 13% e BPV-së vjen nga dërgesat e parave nga jashtë. Të dyja këto burime të të hyrave janë mjaft të brishta dhe varen nga kriza ekonomike në Evropë. Edhe pse remitancat ruajtën nivelin e lartë dhe mbetën stabile gjer tani, vetëm rreth 11% e parave shfrytëzohen për investime, kurse shumica e parave shkojnë për konsum.

Përderisa Kosova ka bilanc shumë negativ të tregtisë ndërkombëtare (afro 45% e BPV-së në vitin 2011), është projektuar që eksportet të rriten shumë më shpejtë sesa importet, dhe si rezultat ky çekuilibër të përmirësohet bile paksa. Inflacioni mbetet i ulët, si rezultat i shfrytëzimit të Euros që ka pasur lëkundje të kufizuara monetare dhe kjo i ka kontribuar politikave relativisht të shëndosha fiskale. Kriza e fundit globale financiare ka pasur ndikim të kufizuar në ekonominë Kosovare si rezultat i nivelit të ulët të integritit të ekonomisë lokale me tregjet ndërkombëtare.

Edhe pse shoqëria civile vetëm sa ka filluar të luajë rol proaktiv në avokim dhe mbikëqyrje, Kosova ka gamë të gjerë të organizatave të shoqërisë civile (OShC) dhe të medieve aktive. Kur qytetarët përfshihen në ndonjë çështje, kjo kryesisht bëhet nëpërmjet partive politike dhe iniciativave qytetare dhe të

<sup>3</sup> Banka Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror 2012

<sup>4</sup> Banka Botërore, Njësia për ulje të varfërisë dhe menaxhim ekonomik, Kosova po zhbllokon potencialin për rritje: Strategjitë, politikat, veprimet; Memorandum ekonomik i shtetit, prill 2010.

<sup>5</sup> Ibid.

komunitetit. Problemet kryesore për qytetarët dhe për grupet e tyre të avokimit janë mungesa e mundësive ekonomike, frustrimi me institucionet qeveritare të cilat vazhdojnë të mos adresojnë nevojat më imediate që kanë të bëjnë me arsimin, mundësitë për punësim, shërbimet publike dhe qasjen e barabartë për gratë, të rinjtë dhe pakicat. Sa i përket mbajtjes së zgjedhjeve, vetëm 17% e qytetarëve kosovarë pajtohen se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike, dhe si reagim, vullneti i qytetarëve për të votuar është në rënie<sup>6</sup>. Integrimi i papërfunduar i pakicave, në veçanti i serbëve, kufizon mundësinë për ndërtimin e qeverisë më gjithëpërfshirëse.

### *Të Arriturat e USAID-it*

Edhe pse vazhdojnë problemet zhvillimore, USAID-it mund të krenohet me përparimin të cilin e ka ndihmuar të arrihet. Në një mjedis ku realizimi i programeve të USAID-it bëhet nëpërmjet marrëdhënieve jashtëzakonisht të mira të punës, Agjencia që nga viti 1999 ka zbatuar një portofolin të gjerë të projekteve të cilat fokusohen në formimin e institucioneve demokratike, zhvillimin e institucioneve ekonomike dhe të sektorit privat, përmirësimin e aftësisë së qeverisë në menaxhimin e sektorit energjetik, në rindërtimin e sistemit arsimor dhe të infrastrukturës së komunitetit.

Asistenca kryesore teknike është ofruar për të ndihmuar hartimin e kushtetutës, në themelimin e gjykatës kushtetuese dhe në vendosjen e sistemit elektoral. Gjithashtu me ndihmën e USAID-it është krijuar edhe metodologjia për reduktimin e lëndëve vjetra gjyqësore. USAID-i i ka ndihmuar Kosovës në rigjallërimin e shoqërisë civile nëpërmjet ndihmës për qendrën burimore dhe për trajnime për organizatat joqeveritare (OJQ). USAID-i ka ndihmuar në themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV) që është institucioni i parë lokal i Qeverisë së Kosovës në pjesën veriore të vendit. Është dhënë asistencë edhe për themelimin e dy rrjeteve të para të pavarura televizive në Kosovë.

Me ndihmën e USAID-it dhe duke filluar nga baza e ulët, përparime të mëdha janë arritur në vendosjen e politikave të reja ekonomike dhe fiskale, për të përgatitur skenën për tranzicion nga ekonomia e komanduar në atë të tregut. Sistemet buxhetore dhe tatimore si dhe sistemi gjithëpërfshirës pensional u krijuan dhe u funksionalizuan. U krijua sistemi modern bankar, u themelua Banka Qendrore dhe u vendosën kapacitetet për mbikëqyrje bankare. USAID-i themeloi një bankë komerciale, Bankën Amerikane të Kosovës, për të ndihmuar investimet, për të shtuar qasjen në financa dhe për të krijuar punësim (u dhanë kreditë me vlerë 64.5 milionë \$ për zhvillim të biznesit, gjë që rezultoi në 11.000 vende të reja pune). Një vit e gjysmë më vonë USAID-i ia shiti ndërmarrjen e suksesshme Bankës Raiffeisen të Austrisë, dhe të ardhurat nga shitja iu derdhën fondit të bursave (Fondi Kosovaro-Amerikan i Arsimit KAEF) që i mundëson banorëve të Kosovës të kryejnë studimet post-diplomike në Shtetet e Bashkuara. U përforcua kapaciteti kryesor i Ministrisë së Financave. U instaluan proceset moderne të buxhetit dhe të thesarit, me sistem efikas e transparent për menaxhim elektronik financiar që mundëson kreditim direkt të gjitha pagesave qeveritare. U themelua administrata tatimore (1.2 milionë \$ tatime të vjela që nga janari i vitit 2012). U vendos korniza ligjore bërthamë për ekonomi funksionale të tregut. Së bashku, këto institucione të reja ekonomike, këto korniza rregullative dhe sisteme financiare, i kontribuan rimëkëmbjes pas konfliktit dhe ofrojnë perspektivë për revitalizim të vazhdueshëm ekonomik. U realizuan përmirësimet fillestare të institucioneve që punojnë me energji. Dhe çka është më e rëndësishmja, privatizimi i cilit pritet të bëhet së shpejti i sistemit të distribucionit të energjisë është mundësuar nëpërmjet asistencës intensive të USAID-it.

Që nga viti 2010, USAID-i në partneritet me Qeverinë e Kosovës ka reformuar sistemin arsimor të klasave 1-9 që përmirëson aftësitë e nxënësve dhe shton mundësinë e punësimit, një intervenim që në përgjithësi kuptohet si përmirësim i tregut të punës. USAID-i gjithashtu ka ndërtuar apo rehabilituar një numër të madh të infrastrukturës së komunitetit, siç janë shkollat (dhe kështu ka reduktuar punën në ndërrime), spitale dhe klinika shëndetësore, sisteme ujësjellësi dhe rrugë. Mbi pesëdhjetë studentë kanë

<sup>6</sup> USAID, vlerësimi i konfliktit: Rrënim i mureve të padukshme, shtator 2012.

magjistruar në institucionet e ShBA-së, dhe 12 studentëve pakicë i është dhënë bursa për studime baçelor. Grupet e cënueshme siç janë familjet e zhvendosura, gratë dhe fëmijët janë shënjestruar për kujdes të veçantë.

### *Nga Stabilizimi në Shtetësi*

Gjatë pesë viteve të ardhshme USAID-i do të vazhdojë me këto suksese në përputhje me politikat e jashtme të qeverisë së ShBA-së dhe me konsideratat e sigurisë kombëtare, gjë që kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe aktiv të qeverisë së ShBA-së në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe të pavarësisë së Kosovës, si mënyrë për të promovuar paqe më të madhe dhe stabilitet në Ballkan dhe për të ndihmuar integrimin rajonal dhe Euro-Atlantik. Duke punuar me përparësinë e ndjenjës së theksuar pro-amerikane që mbretëron brenda Qeverisë së Kosovës dhe në mesin e popullsisë, është detyrë e USAID-it që me sukses të përballlet me sfidat dhe të shfrytëzojë mundësitë me të cilat përballlet, ashtu që "*Kosova të bëhet shtet gjithnjë e më i begatshëm, i cili në mënyrë progresive integrohet në komunitetin Euro-Atlantik, me qeverisje më efektive dhe më llogaridhënëse*".

### **Sfidat**

Sfidat madhore gjatë kohës së SBZhV-së kanë të bëjnë me arritjen e stabilitetit politik, përfshirë zgjidhjen e problemeve në pjesën veriore me shumicë serbe, nxitjen e pajtimit ndëretnik dhe integrimin e tërë popullsisë pakicë, dhe realizimin e përmirësimeve në sektorin e ekonomisë dhe të arsimit që do të shtonte mundësitë për të gjithë qytetarët dhe do të promovonte integrimin rajonal dhe Euro-Atlantik.

Gjatë një dekadë e gjysmë, Kosova ka shënuar progres të dukshëm në fushat kritike të ndërtimit të institucioneve dhe në përforcimin e qeverisjes demokratike, krijimin e themeleve të shëndosha për rritjen e ekonomisë dhe në institucionalizimin e sistemit të decentralizuar e modern të arsimit fillor me mësimnxënie të bazuar në vlerësim dhe me fokusim te nxënësit. Megjithatë në të gjitha këto arena mbesin dobësi të rëndësishme të cilat duhet të adresohen me urgjencë nëse populli i Kosovës dëshiron të shfrytëzojë potencialin e vet të plotë si individ dhe si shtet. Gjatë kësaj periudhe të strategjisë, USAID-i synon të vazhdojë punën në këto angazhime në të gjitha këto fusha, duke punuar me Qeverinë e Kosovës dhe me aktorët tjerë me qëllim të tejkalimit të sfidave, nëpërmjet shënjestrimit të vëmendshëm të asistencës në vijë me interesat e menaxhueshme dhe me realitetet buxhetore.

### *Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja*

USAID-i përballlet me disa sfida me Qeverinë e Kosovës dhe me aktorët tjerë në lidhje me nevojën për të përforcuar institucionet kryesore dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve (*OZh1: Të përmirësohet sundimi i ligjit dhe qeverisja ashtu që t'i përmbushin nevojat e qytetarëve*).

Së pari, vazhdimi i asistencës për sektorin e gjyqësisë kërkon që Qeveria e Kosovës të vazhdojë me zotimin e fuqishëm për të udhëhequr dhe zbatuar reformat kyçe, në veçanti në rindërtimin e gjykatave. Siç u tha më sipër, Kosova ka në përgjithësi një kornizë adekuate të ligjeve, por performanca gjyqësore duhet të përmirësohet dukshëm sa i përket efikasitetit, transparencës, pavarësisë dhe llogaridhënies. Në anketën e fundit, vetëm 18% shfaqën kënaqësinë me punën e gjykatave, dhe vetëm 16% ishin të kënaqur me punën e prokurorive. Anketa e njëjtë tregoi se vetëm 21% e qytetarëve ishin të kënaqur me punën e përgjithshme të Qeverisë<sup>7</sup>.

Sa i përket institucioneve legjislative, Kuvendi i Kosovës mbetet i dobët, dhe siç tregon anketa e sipërpërmendur, është shumë e distancuar nga niveli më i ulët i elektoratit. Pa kulturë institucionale që thekson kontaktimin dhe punën me qytetarët, përmirësimet në funksionet legjislative, siç janë hulumtimi

<sup>7</sup> UNDP dhe USAID, *Raporti Puls i Publik, 4 gusht 2012*.

dhe analiza, hartimi i legjislationit, dhe mbikëqyrja e zbatimit, do të kenë ndikim të kufizuar. Kjo vlen edhe për kuvendet komunale.

Pushtetet lokale shpeshherë nuk mbajnë përgjegjësi para elektoratit të tyre dhe nuk demonstrojnë menaxhim të shëndoshë financiar. Shumë pushtete lokale vazhdojnë të kenë probleme në ofrimin efektiv të shërbimeve themelore, për shembull menaxhimi i drejtë i ujësjellësit dhe i kanalizimit, mbledhja e mbeturinave dhe lëshimi i dokumentacionit personal, siç janë certifikatat e lindjes. Disa komuna vënë në pah disa veprime të Qeverisë së Kosovës të cilat duken si lëvizje drejt centralizimit të sërishëm, edhe pse qeveria qendrore thotë se përkrah me fjalë decentralizimin e pushtetit të zyrtarët lokal të cilët janë më afër qytetarëve dhe realiteteve me të cilat ata përballen. Prandaj mbetet sfida vazhdimi i decentralizimit efektiv.

Vlerësimi i fundit i USAID-it identifikoi zgjedhjet si nxitje e mundshme e konfliktit<sup>8</sup>. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) megjithatë pritet të ndryshojë përkrahjen e saj për zgjedhjet ashtu që në vend të këshillave dhe ndihmës, përkrahja e saj do të jetë vetëm në vëzhgim pa monitoruar zgjedhjet në terren. Duke i pasur parasysh këto ndryshime, do të jetë e vështirë të thuhet nëse Kosova do të ketë kapacitete për të menaxhuar me zgjedhjet në mënyrë kredibile.

Qeveria e Kosovës ruan zotimin për të adresuar çështjet e pakicave, përderisa këtu sfida është rezistimi i presioneve të brendshme dhe i dinamikave shoqërore të cilat theksojnë karakterin etnik shqiptar të shtetit në barrë të pakicave. Njëkohësisht Qeveria e Serbisë vazhdimisht i bën thirrje serbëve të Kosovës që të punojnë në sistemet paralele, ashtu që Qeveria e Serbisë financon administratat nën hije në viset me shumicë serbe në Kosovë. Natyrisht se kjo është në kundërshtim me integritetin dhe integrimin e Kosovës.

Në fund, në të gjitha këto fusha, d.m.th. në fushën e gjyqësorit, legjislativit, administratës, zgjedhjeve dhe pakicave, dëshira dhe mundësia e shoqërisë civile që të punojë ngushtë me qeverinë dhe t'i jep zë konstruktiv brengave të tyre, gjithashtu do të dëshmohet si sfida madhore, duke ditur nivelin e ulët të pjesëmarrjes aktive.

### *Rritja Ekonomike*

Krijimi i një mjedisi për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për përmirësim të konkurrueshmërisë ka qenë fokusi kryesor i përkrahjes së USAID-it për Kosovën prej tranzicionit nga kriza në zhvillim afatgjatë. USAID-i synon të vazhdojë ofrimin e përkrahjes së fuqishme për këtë sektor (*OZh2: Rritja e investimeve dhe shtimi i punësimit në sektorin privat*), duke punuar ngushtë me Qeverinë e Kosovës për t'u përballur me sfidat dhe për të zbutur pengesat duke ndërtuar një ekonomi të shëndoshë dhe me bazë të gjerë.

Institucionet e QK-së që janë përgjegjëse për ruajtjen e stabilitetit makro-ekonomik kanë bërë punë të admirueshme që siguron se Kosova do të mbetet një nga shtetet me stabilitetin më të madh fiskal dhe financiar në rajon. Pas periudhës së investimeve të koncentruara të USAID-it, tani është sfida që arritjet e këtyre institucioneve të konsolidohen dhe të mbrohen nga tronditjet e papritura, ashtu që reformat të zbatohen plotësisht në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse, dhe të përmirësohet menaxhimi i buxhetit.

Është arritur përparim i dukshëm në "*Indeksin e të bërit biznes*" të Bankës Botërore ku Kosova ka përparuar nga vendi 128 në atë 98 në vitin 2012<sup>9</sup>. Ky përparim është arritur pas shumë përpjekjesh nga Qeveria e Kosovës, me përkrahje të madhe teknike nga USAID-i. Megjithatë, kur e analizojmë situatën

<sup>8</sup> USAID, vlerësimi i konfliktit në Kosovë: Rrërimi i mureve të padukshme, shtator 2012.

<sup>9</sup> Banka Botërore, Raporti i të bërit biznes 2013.

tek fqinjët dhe konkurrencën, është e qartë se Kosova ende ka punë për të bërë sepse Maqedonia radhitet në vendin 23, Mali i Zi në 51, Shqipëria në 85 dhe Serbia në 86. Tani është sfida të bëhen përmirësime në mjedisin e përgjithshëm rregullativ ashtu që Kosova të krijojë një sektor të fuqishëm privat dhe të joshë investimet e huaja direkte.

Për shembull, Kosova ende vuan nga rregullimi i tepruar qeveritar i aktiviteteve të ekonomisë private nëpërmjet licencave, lejeve dhe proceseve tjera penguese në nivel lokal dhe qendror që shton koston e të bërit biznes dhe bën Kosovën më pak konkurruese në joshjen e investimeve të reja. Një shembull specifik ka të bëjë me inspektimet. Në praktikën ndërkombëtare, inspektimet shfrytëzohen për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë publike. Megjithatë në Kosovë nuk ka parime të përgjithshme të cilat vendosin parametrat për shfrytëzim të inspektimeve, dhe disa agjenci qeveritare i kryejnë inspektimet në mënyrë të këtillë që kalon përtej aspektit të shëndetit dhe sigurisë (supozohet se ka mbetur si trashëgimi nga sistemi socialist i kaluar). Tutje, agjencitë nuk koordinojnë inspektimet e tyre dhe nuk ndajnë informatat të cilat do të kishin ndihmuar në përvijimin e proceseve. Sfidë madhore është eliminimi i këtij regjimi të inspektimeve që paraqet barrë të panevojshme, merr kohë të panevojshme, është i kushtueshëm dhe është në kundërshtim me politikat e inkurajimit të aktivitetit të ekonomisë private. Një shembull tjetër ka të bëjë me industrinë ndërtimore dhe shfrytëzimin e tokave. Edhe pse ligji i ri për ndërtimet ka paraqitur disa ndryshime pozitive në kuptim të reduktimit të procedurave për marrjen e lejeve ndërtimore, së bashku me kalkulimin transparent të tarifës për leje dhe përmirësimet tjera, autoritetet e nivelit komunal vazhdojnë të përballen me probleme në zbatimin e kërkesave të reja. Shumë komuna nuk kanë plane urbane rregullative për disa pjesë të tyre, prandaj në ato pjesë bizneset dhe qytetarët nuk mund të parashohin se si toka duhet apo mundet të shfrytëzohet. Natyrisht se këtu sfida është qartësimi i procedurave rregullative në nivel komunal ashtu që biznesi i ndërtimeve dhe zgjerimet të ndihmohen në mënyrë të organizuar. Natyrisht siguri i të drejtave pronësore është pjesë madhore në këtë pengesë.

Siç u tha më sipër, Kosova ka normë mesatare të papunësisë prej 45%. Papunësia e të rinjve sillet rreth 70%, që është recetë për trazira, në veçanti duke ditur se më shumë se gjysma e popullsisë është nën moshën 25 vjeçare dhe rreth 21% e tyre janë të moshës prej 15 gjer 25 vjeçare. Banka Botërore llogaritë se 34% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë (45€ apo 60\$ në muaj)<sup>10</sup>. Duke u përballur me këtë realitet të papunësisë dhe të varfërisë, nuk do t'ia tepronim po të themi se stabiliteti dhe perspektiva zhvillimore e Kosovës varen kryesisht nga krijimi i vendeve të punës.

Tani, mbi 98% e bizneseve janë biznese familjare, ndërmarrje mikro, të vogla apo të mesme (NMVM). Një raport i fundit i UNDP-së ka vënë në pah se tregu i Kosovës është i çekuilibruar. Raporti vuri theksin në krijimin e ndërmarrjeve në mjedis tanimë të ngopur me firma terciare të vlerës së ulët apo firma të sektorit të shërbimeve. Për të transformuar këtë trend të ulët të rritjes në sektor shumë më dinamik dhe gjithëpërfshirës privat, raporti rekomandon, në mes tjerash, shtytje në rritjen e bizneseve nga mikro dhe të vogla në ato të mesme, dhe të përfshihet përmirësimi i qasjes në financa për bizneset e reja dhe ato biznese që zgjerohen, në veçanti ato të udhëhequra nga gratë dhe të rinjtë<sup>11</sup>. Inkurajimi i shtimit të numrit të ndërmarrjeve të mesme, dhe ndërmarrjeve të vogla me potencial për rritje, do të jetë sfida madhore e cila ka ndikim për shembull në shtimin e vlerës, përmirësimin e qasjes në kredi, përvijimin e kornizave rregullative, dhe shtimin e efikasitetit në rrjedhën e tregtisë brenda dhe jashtë kufijve të Kosovës.

Gjatë adresimit të papunësisë dhe nevojës për ndërmarrje më të fuqishme dhe të qëndrueshme, duhet të ekzistojë theksi i veçantë në rritjen e prodhimtarisë bujqësore, duke ditur se 60% e popullsisë së Kosovës jeton në viset rurale dhe është kryesisht e varfër. Sfidat me të cilat duhet përballur dhe rrethanat që duhet tejkaluar përfshijnë qasjen e kufizuar në kredi dhe në tregje, serrat joadekuate, zinxhiri i dobët "prej fermës në tryezë", dhe cilësia e dobët e inputeve të fermës (farërat, plehrat dhe pesticidet) dhe e infrastrukturës së sigurisë së ushqimit. Shfrytëzimi i euros thjeshtëzon politikat monetare por edhe i mbyll

<sup>10</sup> Banka Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror 2012

<sup>11</sup> UNDP, Raport i Zhvillimit Njerëzor për Kosovë 2012.



rrugën rritjes së eksporteve të cilat bazohen në normat joshëse të këmbimit monetar. Thënë shkurt, bizneset e Kosovës duhet të konkurrojnë me produktet, shërbimet dhe përvojën afariste. Pengesat përfshijnë shkallën (që u diskutua më sipër), financimin, lidhjet me tregje, integrimin në nivel të firmës/industrisë/furnizimit/tregut, ngecjen historike/kulturore ndaj dinamikës moderne të biznesit, dhe bashkëpunimin e grupit të aktorëve/interesit. Raporti i sipërpërmendur i USAID-it konstaton se "*Kultura e ndërmarrësisë së Kosovës ka energji të paorganizuar. Bizneset shkojnë e vijnë, pa shfrytëzuar grupimet rajonale apo sektoriale*". Sfidë do të jetë kapitalizimi i sektorëve të gatshëm për rritje, ashtu që të rritet punësimi i nevojshëm për Kosovën<sup>12</sup>.

Përkundrejt përkrahjes së konsiderueshme nga USAID-i dhe komuniteti ndërkombëtar donator, si dhe përkundrejt bazës së gjerë të burimeve natyrore, Kosova ende sfidohet rëndë nga mungesa e energjisë që mbetet një nga barrierat më të mëdha ndaj rritjes ekonomike. Një studim i fundit i USAID-it ka llogaritur se kostoja e të bërit biznes është rreth 456 milionë \$ në vit, si rezultat i nevojës për të investuar në gjeneratorë, prishje të pajisjeve dhe kohën e kaluar bosh<sup>13</sup>. Një analizë tjetër e USAID-it karakterizon mungesën e furnizimit të vazhdueshëm me rrymë si "pengesë e obligueshme" ndaj rritjes<sup>14</sup>.

Që nga viti 2008 me asistencë të konsiderueshme nga USAID-i dhe donatorët tjerë, performanca e sektorit energjetik të Kosovës është përmirësuar vazhdimisht përderisa humbjet janë ulur. Megjithatë çështja kryesore është që kapaciteti prodhues i Kosovës nuk është adekuat për të plotësuar nevojat e tanishme, dhe është shumë i mangët për kërkesat në të ardhmen rritja e së cilave është projektuar të jetë 5% e BPV-së në vit. Qeveria e Kosovës, me asistencë nga shumë donatorë përfshirë edhe Bankën Botërore dhe USAID-in, është duke planifikuar ndërtimin e termocentralit të ri, por megjithatë prodhimi i rrymës elektrike nuk pritet të fillojë për disa vite.

Sfidë gjatë pesë viteve të ardhshme është përfshirja e suksesshme e donatorëve tjerë dhe subjekteve kosovare që kanë të bëjnë me energji, në hartimin e Strategjisë gjithëpërfshirëse energjetike dhe përforcimin e institucioneve kryesore, siç janë Zyra Rregullative e Energjisë (ZRRE), Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ashtu që Kosova, në pajtim me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe mjedisore, të shfrytëzojë mineralet e shumta të cilat shfrytëzohen për energji por edhe ato të cilat nuk shfrytëzohen për energji, resurset ujore dhe ato pyjore.

Sa i përket mineraleve që nuk shfrytëzohen për energji, një raport i fundit për industrinë e rëndë në Kosovë ka identifikuar mungesën e politikave dhe rregulloreve qeveritare, si dhe mungesën e koordinimit, konsistencës dhe transparencës, për shembull në vjeljen e tatimeve për resurset natyrore, si pengesë madhore ndaj zhvillimit të mëtejshëm të industrive kryesore. Përveç kësaj, raporti ka theksuar mungesën e kornizës ligjore dhe politikës që inkurajon shfrytëzimin e mbetjeve industriale nga industria lokale me qëllim të adresimit të brengave mjedisore, e kështu do të përkraheshin edhe tregjet lokale. Duke marrë parasysh këtë mjedis të pasigurt të punës, raporti tregon shembullin se si një impiant lokal i çelikut importon zink edhe pse zinku gjendet në Kosovë, së bashku me pajisjet e nevojshme për elektrolizë. Shmangia e humbjes së sfidave të tilla ekonomike duke krijuar politika më të favorshme dhe mjedis më të favorshëm rregullativ do të jetë sfidë e madhe. Sektori privat i Kosovës është i vetëdijshëm për potencialin e shtetit në këto fusha dhe ky sektor dëshiron të bëhet pjesë e tij. Ekziston rreziku se pa politika dhe rregullore të përshtatshme, zhvillimi do të bëhet pa i kushtuar vëmendje llojit të menaxhimit të qëndrueshëm që do të përkrahte stabilitetin ekonomik.

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> USAID, Studim i efekteve nga furnizimi i parregullt me rrymë elektrike mbi bizneset kosovare, nëntor 2012.

<sup>14</sup> USAID, diagnozë e rritjes në Kosovë: Analizë e pengesave, shtator 2012.

<sup>15</sup> STRAS, Qendra për hulumtime strategjike dhe sociale, Potenciali i industrisë së rëndë dhe kontributi i saj në zhvillim, nëntor 2012.

Përderisa ekziston mungesë e informatave rreth ndikimit të ndryshimeve klimatike, mund të thuhet se Kosova është e ndjeshme ndaj kërcënimeve klimatike sepse disa sektorë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, siç janë bujqësia dhe pylltaria, ndikohen rëndë nga klima. Kosova ka kapacitet shumë të kufizuar për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike në mënyrë sistematike. Në vitin 2012, një projekt i UNDP-së bëri Inventarizimin e Gazit Serrë që duhet të menaxhohet nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Gjatë këtij viti projekti dokumentoi për herë të parë emetimet e gazrave serrë nga viti 2008 dhe 2009. Kategoria më e madhe e emetimeve është Industria Energjetike e cila prodhon rreth 82% të emetimeve totale shtetërore të gazrave serrë (10,507.2 miliona tonelata CO<sub>2</sub>), kryesisht nga djegia e karburanteve me bazë karboni, siç është linjiti dhe druri. Emetimet relativisht të ulëta për kokë banori vijnë si rezultat i mungesës së industrive që shpenzojnë shumë energji siç është bujqësia intensive dhe menaxhimi i mbeturinave.

### Arsimi

Kosova vazhdon të lëngoje nga një sistem arsimor i cili në të gjitha nivelet dështon në adresimin e nevojave pedagogjike dhe të aftësisht të nxënësve për nevoja të ekonomisë. Sfidë për USAID-in është puna efektive në tandem me Qeverinë e Kosovës në adresimin e dobësive kryesore të këtij sistemi të ri ashtu që të gjitha këto përpjekje së bashku, që lidhen me Synimin Strategjik dhe me Objektivat Zhvillimore të misionit, të ndihmojnë në adresimin e mangësive në kualifikim të personelit gjë që mbetet pengesë serioze për rritjen ekonomike (*OZh3: Të forcohet kapitali njerëzor*).

Sistemi jozyrtar i arsimit parauniversitar i cili ekzistoi në Kosovë gjatë periudhës së konfliktit, tani është formalizuar. Megjithatë sistemi është i rënduar nga numri tepër i madh i popullsisë në viset urbane që rezultoi nga migrimi i shpejtë nga viset rurale në ato urbane. Qasja është e pabarabartë si rezultat i kontrastit të madh në mes të shkollave në kuptim të cilësisë, situatë e cila përkeqësohet tutje nga norma e ulët e përfundimit të shkollimit nga komunitetet pakicë. Përkundër përparimeve të fundit, zhvillimi profesional i mësimdhënësve është i dobët, kurrikulumi është joadekuat dhe i vjetruar, përderisa ka mungesë të pajisjeve dhe materialeve mësimore. Në menaxhimin arsimor ekziston hendeku i thellë gjinor. Edhe pse ka shumë mësimdhënëse femra në nivel fillor, ka shumë pak femra të emëruara si drejtoresha apo zyrtare arsimore në nivel komunal. Dhe sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), norma e braktisjes së shkollimit nga femrat në mes të klasave 9 dhe 10 ishte rreth 15% në vitin 2010. Sfidë për USAID-in është që me vëmendje të shënjestrojë resurset e veta në këtë fushë problematike, ashtu që Agjencia dhe Kosova të arrijnë ndikim maksimal në këtë sistem tepër të rëndësishëm por edhe shumë të brishtë.

Gjatë viteve të kaluara, USAID-i ka ndihmuar në rindërtimin e shkollave, në reformimin e sistemit arsimor në nivel fillor (klasat 1-5) dhe të mesëm të ulët (klasat 6-9), dhe në përvijimin e politikave të Qeverisë së Kosovës për decentralizim, në ndërtimin e kapacitetit të Drejtorive Komunale të Arsimit për të menaxhuar sistemin në nivel lokal. Megjithatë, përmirësimi i shkrim-leximit në klasë të hershme, ofrimi i mësimave cilësorë në matematikë, shkencë dhe teknologji, adresimi i normës së braktisjes së shkollimit në nivel të ulët, dhe ngritja e aftësive menaxhuese dhe përmirësimi i kualifikimeve të mësimdhënësve mbeten fusha me nevoja kritike. Është sfidë mbajtja dhe konsolidimi i përparimeve të arritura gjatë programimit të tashëm, i cili është i përvijuar me qasjet mbarësektoriale që përkrahen nga Qeveria e Kosovës dhe nga komuniteti donator, para se të adresohen sfidat tjera madhore.

Numri i stafi të nivelit universitar në Kosovë është i lartë, por cilësia e të diplomuarve është e dobët dhe nuk ndërlidhet me kërkesat për fuqi punëtore. Kjo së bashku me rritjen e ngadaltë të sektorit privat rezulton në normë të ulët të absorbimit të të diplomuarve nga tregu. Në Universitetin e Prishtinës ka mangësi në menaxhim, relevancë të kurrikulimit dhe të pedagogjisë. Detyrë e USAID-it do të jetë puna me menaxhmentin dhe me fakultetet kryesore të Universitetit për të korrigjuar këto mangësi, nëpërmjet përkrahjes së shënjestruar administrative dhe përmirësimeve pedagogjike, dhe nëpërmjet mundësive për trajnime të bazuara në ShBA (në koordinim me sektorët tjerë të shënjestruar).

Është me rëndësi madhore që USAID-i të përvijojë rritjen ekonomike dhe iniciativat e arsimit të lartë, përfshirë mundësitë arsimore jashtë Kosovës, ashtu që cilësia e të diplomuarve të jetë më e mirë dhe të ketë vende pune për ta në tregun e punës. Shënjestrimi i vëmendshëm i asistencës drejt fakulteteve kryesore të universitetit dhe menaxhmentit të universitetit do të jetë fokusi i kësaj pune.

Një sfidë e veçantë për Qeverinë e Kosovës ka të bëjë me përpjekjet e saj që të konsolidojë dhe të përmirësojë sistemin arsimor përdërisa Qeveria e Serbisë ka ndikim total mbi arsimin fillor dhe të lartë të serbëve të Kosovës. Përdërisa ky është problem që është përtej kontrollit të USAID-it, do të kërkojmë mundësinë për t'u përfshirë në përkrahjen e sistemit të integruar arsimor të Kosovës.

### **Mundësitë**

Qeveria e ShBA-së gëzon mjedis shumë pozitiv brenda të cilit i ndihmon qytetarëve të Kosovës në arritjen e aspiratave për një shtet të pavarur i cili gëzon të mirat e ekonomisë së fuqishme e cila u ofron mundësi të barabarta të gjithë qytetarëve të vet. Njëkohësisht lokacioni gjeografik i Kosovës ofron mundësi atraktive për zhvillimin ekonomik rajonal. Është e qartë se këto përparësi binjake do të kenë ndikim pozitiv në arritjen e të tri Objektivave Zhvillimore të USAID-it ashtu që *"Kosova të bëhet shtet gjithnjë e më i begatshëm, i cili në mënyrë progresive integrohet në komunitetin Euro-Atlantik, me qeverisje më efektive dhe më llogaridhënëse"*.

### ***Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja***

Në kuptim të efikasitetit, transparencës, pavarësisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor, Qeveria e Kosovës është zotuar se do të udhëheqë dhe do të zbatojë reformat, në veçanti në ristrukturimin e gjykatave. Kjo ofron një mundësi të qartë për hyrje në dialog politik rreth çështjeve kryesore që kanë të bëjnë me reformat dhe për t'u fokusuar në asistencën e mirëpritur rreth përfundimit të zbatimit të ligjeve, mbikëqyrjes, menaxhimit dhe aftësive profesionale. Këto mundësi ekzistojnë brenda Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) dhe brenda vet gjykatave. Përdërisa ekzistojnë disa mundësi për reforma ligjore, ligji për të drejtën komerciale, të drejtat pronësore dhe mekanizmat për zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) do të pranojnë vëmendje të veçantë me qëllim të shtytjes së zhvillimit ekonomik.

Kuvendi i Kosovës dhe kuvendet komunale mbesin të dobëta, në veçanti në kuptim të mbikëqyrjes. Ekziston një mundësi për të përfunduar njësitë kryesore brenda këtyre organeve për të përmirësuar komunikimin e tyre me qytetarë dhe për të përmirësuar përgjigjen ndaj brengave qytetare. Përkrahja e deklaruar e Qeverisë Qendrore për decentralizim paraqet mundësi për përfundimin e administratave komunale me qëllim të avancimit të llogaridhënies ndaj elektoratit të tyre në nivel më të lartë, në veçanti në lidhje me shqetësimet rreth menaxhimit financiar dhe zhvillimit të të hyrave vetanake. Megjithatë mbetet rrezik ndërrimi i mendjes së Qeverisë së Kosovës rreth decentralizimit.

Vlerësimi i sipërpërmendur i konfliktit nga USAID-i paraqet një mundësi, në të vërtetë një nevojë kritike, për të vazhduar me ndërtimin e kapacitetit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me qëllim të plotësimit të rolit vëzhgues të OSBE-së dhe përfundimit të kapacitetit të Kosovës për të mbajtur zgjedhje të lira dhe të drejta.

Qeveria e Kosovës nuk adreson çështjen e integritetit të pakicave, në veçanti të serbëve të Kosovës, dhe përdërisa çështjet rreth integritetit janë plotësisht politike dhe sensitive në nivel shtetëror dhe individual, USAID-i dhe pjesët tjera të Qeverisë së ShBA-së kanë mundësinë për të luajtur një rol të rëndësishëm në inkurajimin e integritetit. Kjo është veçanërisht e vërtetë duke ditur respektin që gëzon Qeveria e ShBA-së nga Qeveria e Kosovës dhe nga populli i Kosovës në përgjithësi.

Kosova ka lajme të mira në promovimin e barazisë gjinore, por zbatimi i njëtrajtshëm i këtyre ligjeve mbetet sfidë por edhe mundësi. Kjo kornizë ligjore jep mundësi të qartë për të bërë presion në lidhje me zbatimin rigoroz nëpërmjet dialogut me Qeverinë, për sigurimin e "vendit" të barabartë brenda të gjitha aktiviteteve të USAID-it, dhe për bashkëpunim të ngushtë me grupet e avokimit. Pozita e pafavorshme e grave në procedurat e trashëgimisë dhe të drejtave pronësore, përkundër mosdiskriminimit me ligj, paraqet problem të veçantë.

### *Rritja Ekonomike*

Kosova ka mundësi të qartë për të shkuar drejt rritjes më të shpejtë të udhëhequr nga sektori privat, duke ditur se produktet e saj kanë qasje të lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe në shtetet që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Zhblllokimi i këtij potenciali do të përfshijë tre faktorë të prodhimitarisë të cilët tani po qëndrojnë duke mos bërë gjë: puna, toka, si dhe energjia dhe mineralet. Mundësia për zhblllokim të këtij potenciali është në duart e vet shtetit, pasi që shumica e pengesave janë të natyrës së politikave<sup>16</sup>.

Siç u tha më sipër, gjatë disa viteve të kaluara është arritur mjaft shumë nga USAID-i dhe Qeveria e Kosovës në kuptim të reformave ekonomike. Asistenca e kaluar në ndërtimin e ministrive kryesore dhe të organeve qeveritare jo vetëm që ka lënë shenjë të dukshme në themelet për të vazhduar punën, por ka lënë edhe qasje pothuajse të pakufizuar të zyrtarët qeveritar dhe respekt për këshillat teknike që jepen nga Qeveria e ShBA-së.

Diversifikimi i ekonomisë dhe shtimi i kontributeve nga sektori privat është koncept i cili çdo ditë e më shumë po kuptohet nga vendimmarrësit në Prishtinë ("qeveritë nuk krijojnë rritje, ato krijojnë mjedisin për rritje"). Kjo i jep USAID-it mundësi për të ndërtuar kapacitetin për qeverisje të shëndoshë të ekonomisë, duke pasur parasysh jo vetëm zbatimin më të mirë të reformave (nëpërmjet ndihmës që korniza relativisht e mirë ligjore dhe rregullative në të vërtetë të aplikohet drejtë), por edhe përmirësimin në menaxhimin e financave publike, rritjen në qasjen në kredi, joshjen e investimeve të huaja, rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat në ndërtimin e infrastrukturës publike dhe ofrimin e shërbimeve publike, dhe adresimin e nevojave për aftësim në sektorët e caktuar.

Duke ditur se 60% e popullsisë jeton në zona rurale dhe është relativisht e varfër, USAID-i synon që të vazhdojë angazhimin e vet në sektorin e bujqësisë, në lidhje me iniciativat e programeve tjera siç janë përmirësimi i qasjes në kredi dhe përkrahja e NVM-ve (me përforsim gradual të theksit të ndërmarrjet e mesme). Rritja premtuese në përpunimin e ushqimit, p.sh. në produktet e qumështit dhe ato me vlerë të shtuar siç janë: llojet e xhemit, lëngjet dhe produktet e patates, tregon se ka mundësi për të përshpejtuar këtë tranzicion ashtu që Kosova të bëhet më pak e varur nga importi i ushqimit (pasi që tani importohet rreth 60-70% e ushqimit). Është aplikuar me sukses Autoriteti për Zhvillimin e Kredisë (DCA) me vlerë 10 milionë \$, dhe Qeveria e Kosovës tani i ka "dhuruar" 3.2 milionë \$ USAID-it për të ndihmuar në krijimin e një DCA-je prej 26 milionë \$ për t'i adresuar pengesat kreditore të fermerëve/përpunuesve nëpërmjet gjashtë bankave vendore, ashtu siç janë identifikuar në *Diagnozën e Kosovës për rritje 2012*. Kjo është mundësi unike e cila mund të përmirësojë dukshëm konkurrueshmërinë bujqësore, duke ditur afërsinë e tregjeve dhe mundësitë për të përmirësuar prodhimtarinë.

USAID-i gjithashtu gëzon reputacion të fuqishëm dhe përparësi krahasuese në mbështetje të konkurrueshmërisë dhe të zinxhirit të vlerave. Për shembull një projekt i mëhershëm i USAID-it ka ofruar trajnim për konsulentët e TI-së në shkrimin dhe tregtimin e aplikacioneve për Android. Një nga

<sup>16</sup> Banka Botërore, Njësia për ulje të varfërisë dhe menaxhim ekonomik, Kosova po zhbllokon potencialin për rritje: Strategjitë, politikat, veprimet; Memorandum ekonomik i shtetit, prill 2010.

aplikacionet provuese të krijuar gjatë trajnimit iu shit menjëherë një kompanie suedeze. (Instituti për Trajnim dhe Zhvillim i Universitetit Amerikan të Kosovës rishtazi në mënyrë të pavarur ka hapur një kurs të ri për Zhvillimin e Aplikacioneve për Android). Zyrtarët për kredi në bankat e ndryshme i kanë treguar stafit të USAID-it që posa kuptojnë se aplikuesit janë ndihmuar nga USAID-i në planet e tyre të biznesit, kërkesat e tyre shqyrtohen menjëherë si serioze. Përgjigjja e tillë ndaj përfshirjes së USAID-it i jep Agjencisë një bazë të fuqishme për të vendosur lidhje të reja dhe për të bërë programe provuese të cilat mund të merren nga sektori privat. Kjo arenë është veçanërisht premtuese si një shteg për krijimin e mundësive më të mëdha ekonomike për gratë, me asistencën e organizuar nëpërmjet organizate, d.m.th. Oda Ekonomike e Grave, e cila u themelua në fillim të vitit 2013 me qëllim të adresimit të pengesave ndaj pjesëmarrjes së plotë të femrave në të gjitha nivelet e ekonomisë. Kjo Odë ishte rezultat i Samitit të suksesshëm Ndërkombëtar të Gruas, ku mori pjesë edhe ish-Sekretarja e Shtetit, Madeline Albright, së bashku me Presidenten e Kosovës dhe Zëvendës-Kryeministren për Ekonomi. USAID-i do të koordinojë OZh-të e veta për të siguruar se kjo OJQ e porsaformuar të bëhet zë i fuqishëm për çështjet të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë te gratë.

Resursi më i madh natyror i Kosovës i jep USAID-it (dhe donatorëve tjerë) mundësinë për të ofruar ndihmë të madhe në përbushjen e nevojave të shtetit me energji dhe të arrijë synimet e rritjes ekonomike. Kjo është një mundësi, si dhe sfidë, që thjeshtë nuk mund të injorohet, duke ditur mungesën e vazhdueshme të energjisë që seriozisht kërcënon rritjen ekonomike. Banka Botërore identifikon resurset e mjaftueshme natyrore të Kosovës, në veçanti ato në sektorin energjetik, si burim kryesor të rritjes. *"Vënia në shfrytëzim e burimeve të shumta [natyrore] do të ndihmojë në largimin e një prej pengesave më të mëdha me të cilat përballen firmat e Kosovës dhe mund të krijojë të ardhura substanciale për buxhetin qendror dhe mundësi për eksportim të energjisë elektrike. Resurset e plumbit, zinkut dhe magnezit janë të bollshme, prandaj rifillimi i punës në këto miniera mund t'i japë kontribut të çmuar punësimit dhe rritjes"*<sup>17</sup>.

Mundësitë e Kosovës në industrinë e rëndë janë vërtetuar nga përvoja e kaluar në këtë sektor. Për dallim nga viti 1989, nxjerrja e xeheve metalike jo-ferrore kishte rënë 86,5%, prodhimi i metaleve jo-ferrore 86,5%, përpunimi i metaleve jo-ferrore 97,1%, fabrikimi i makinerisë dhe i pajisjeve elektrike 89,5%, etj. Kompleksi i minierave Trepça në vitin 2012 punonte në një të pestën e kapacitetit të vet. Fabrika e çimentos Sharrcem prodhoi 535,000 tonelata çimento në vitin 2012, nga kapaciteti i përgjithshëm prej 835,000 tonelata. Kompleksi Newco **Ferronikeli** tani punon me një nga dy furra, që kufizon potencialin për prodhimtari. Ky trend i de-industrializimit shënon rënie në përqindjen e industrisë në ekonominë totale nga 47% në vitin 1988 në vetëm 21% në vitin 1994<sup>18</sup>. Duke marrë parasysh këtë realitet dhe *"...duke ditur koston e lartë të neglizhencës mjedisore dhe nevojën për të ecur përpara më me shpejtësi në drejtim të përbushjes së standardeve dhe kërkesave mjedisore të BE-së"*<sup>19</sup>, ekziston mundësia e qartë dhe e rëndësishme për USAID-in që t'i ndihmojë Qeverisë së Kosovës në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për ringjalljen e këtyre industrive, gjë që do të mund të përmirësonte dukshëm mirëqenien e shtetit, dhe do të ndihmonte në mbrojtjen më të mirë të mjedisit.

Qeveria e Kosovës është zotuar se gjer në vitin 2020, 29.47% e bruto konsumit final të energjisë do të vjen nga burimet e ripërtërishme të energjisë. Zotimi është dëshmuar qartë nëpërmjet miratimit të Strategjisë për Energji të Republikës së Kosovës 2013-2020 dhe Planit të Veprimit për Efiçencë në Energji 2010-2018 pas miratimit të Ligjit për Efiçencën e Energjisë. Ekziston vullti nga qeveria dhe nga donatorët për të trajtuar këtë sfidë globale.

<sup>17</sup> Ibid.

<sup>18</sup> STRAS, Qendra për hulumtime strategjike dhe sociale, Potenciali i industrisë së rëndë dhe kontributi i saj në zhvillim, nëntor 2012

<sup>19</sup> Shoqata ndërkombëtare për zhvillim, Korporata ndërkombëtare për financa dhe Agjencia multilaterale për të garantuar investimet, Strategjia shtetërore për partneritet për Republikën e Kosovës për periudhën VF12-VF15, maj 2012.



### Arsimi

Duke ditur forcën relative dhe madhësinë "e menaxhueshme" të sektorit të arsimit në Kosovë, USAID-i ka mundësi unike që të ndihmojë në adresimin e pengesave në kapitalin njerëzor ndaj rritjes ekonomike dhe ndaj arritjeve personale. Agjencia rishtazi përfundoi *Vlerësimin e kapacitetit zhvillimor njerëzor dhe institucional: Kosovë* i cili vlerësim është së paku një udhërrëfyes i pjesshëm.

Edhe pse është arritur progres në infrastrukturën fizike dhe në përpilimin e kurrikulimit, me përkrahjen e USAID-it, sistemi i arsimit parauniversitar në Kosovë ende karakterizohet me brishtësi (klasat 1-12). Sistemet e menaxhimit, profesionalizmi, pedagogjia dhe zbatimi i reformave janë në nivel të ulët. Rezultatet e nxënësve janë shumë më të dobëta sesa që dëshirohet. Qasja në arsimin cilësor është shumë më e dobët për pakicat dhe për komunitetet rurale. Në barazinë gjinore ekzistojnë sfida më të mëdha në profilin e mësimdhënësve dhe administratorëve të shkollave. Tani USAID-i është i përfshirë në nivel qendror dhe lokal për të përmirësuar këto rrethana (Programi i Arsimit Themelor do të përfundojë në vitin 2015). Kjo përfshirje e vazhdueshme dhe e pranuar mirë tregon se përkundrejt sfidave, ekziston mundësia, në të vërtetë ekziston nevoja urgjente për të vazhduar me adresimin e këtyre mangësive për të siguruar themelet e arsimit parauniversitar. Pas adresimit të suksesshëm të sfidave në nivelin fillor (klasat 1-9), USAID-i do të kërkojë mundësi për të adresuar mangësitë në shkollimin e mesëm (klasat 10-12). Kjo do t'i përgatisë nxënësit që me sukses të përparojnë në sistemin arsimor, dhe duke pasur mundësi për arsim të lartë, ata nxënës do të bëhen qytetarë me njohuri të avancuara dhe aftësi tërë-jetësore.

Tani arsimi i lartë në Kosovë nuk siguron dijen dhe aftësitë praktike dhe nuk prodhon studentë të diplomuar të cilët janë të aftë për punësim. Megjithatë vlerësimi i sipërpërmendur HICD identifikon fushat prioritare për reforma, p.sh. brenda administratës publike, TI, bujqësi, dhe kështu i jep USAID-it mundësi për të ndihmuar në përmirësimin e profesionalizmit dhe pedagogjisë në fakultetet e përzgjedhura, përderisa sigurohet plotësimi me elementet tjera programore. Çdo përkrahje për fakultetet e përzgjedhura do të kombinohet me mundësitë e zgjedhura me vëmendje për trajnime afatshkurtra dhe afatgjata në nivel ndërkombëtar (kryesisht në ShBA). Pas kthimit, ata do të bëhen forcë e madhe për të vazhduar me përmirësimet në arsimin e lartë në Kosovë. Mund të ekzistojë mundësia për të adresuar çështjet e menaxhimit të universitetit në përgjithësi, pasi që rektori i ri i përkrahë ndryshimet dhe është duke punuar me USAID-in. Megjithatë përkrahja shtesë për Universitetin e Prishtinës, përtej asistencës teknike që është pjesë e partneritetit me shkollat amerikane, që përfshinë mundësitë mësimore jashtë vendit, do të varet nga arritja e parakushteve të caktuara, duke ditur numrin e madh të shqetësimeve serioze. Tanimë është duke u hartuar plani i veprimit në procesin pjesëmarrës me përfshirje të zyrtarëve të MASHT-it, administratorëve dhe dekanëve të universitetit, donatorëve dhe anëtarëve të komunitetit zhvillimor. Planin ka pranuar vëmendje dhe përkrahje të konsiderueshme dhe ekziston çdo indikacion për arritjen e progresit të pritur. Progresi në këtë plan të veprimit do të krijojë bazën për kushtet paraprake për çfarëdo asistence shtesë. Duke ditur nivelin e lartë të kontributeve nga Qeveria e Kosovës për programet arsimore të USAID-it në Kosovë, afro 50% në arsim fillor dhe të lartë, ekziston partneriteti i fuqishëm si dhe përkrahja për punë shtesë në të dyja rezultatet e ndërmjetme gjatë viteve të ardhshme. Përveç kësaj, Departamenti i Shtetit ka një program aktiv për diplomaci publike që gjithashtu ofron asistencë në gjuhën angleze, reforma në menaxhim dhe në kurrikulum të arsimit të lartë, bursa dhe programe të tjera të shkëmbimit.

## II. HIPOTEZAT ZHVILLIMORE

Premisa kryesore e kësaj strategjie është se arritja e Objektivave Zhvillimore që synojnë përmirësimin e sundimit të ligjit dhe të qeverisjes, rritjen ekonomike dhe arsimimin më të mirë të popullsisë, do të çojë në një Kosovë më të begatshme e cila i ofron të gjithë qytetarëve të vet mundësinë për jetë më të frytshme dhe të kënaqshme. USAID-i kupton se arritja e këtij qëllimi strategjik (*Kosova të bëhet shtet gjithnjë e më i begatshëm, i cili në mënyrë progresive integrohet në komunitetin Euro-Atlantik, me qeverisje më efektive dhe më llogaridhënëse*) do të varet shumë nga bashkëpunimi i ngushtë brenda vendit dhe nga përkrahja e donatorëve tjerë të mëdhenj. Megjithatë, në bazë të marrëdhënies në mes të këtyre blloqeve ndërtimore të zhvillimit dhe synimit gjithëpërfshirës për prosperitet për të gjithë qytetarët e Kosovës, Agjencia është e bindur se rezultatet e pritura, të përcjella nëpërmjet treguesve të zgjedhur, janë brenda interesave të menaxhueshme dhe të arritshme në kontekst të realiteteve buxhetore.

### *OZh1: Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja Ashtu që t'i Përmbushin Nevojat e Qytetarëve.*

Supozimi kryesor që ka të bëjë me këtë Objektiv Zhvillimor është se me arritjen e rezultateve specifike (rezultateve të ndërmjetme [RN] dhe të nën-rezultateve të ndërmjetme [nën-RN]), USAID-i do të përmirësojë kapacitetin institucional dhe njerëzor në subjektet e rëndësishme për demokratizim dhe për shoqëri më gjithëpërfshirëse, d.m.th. institucionet e sundimit të ligjit, organet e zgjedhura administrative të qeverisë, kuvendet e zgjedhura, dhe organizatat e shoqërisë civile. Strategjia e USAID-it do të konsolidojë investimet e kaluara duke u fokusuar në zhvillimin e mëtejshëm të këtyre institucioneve të përzgjedhura të cilat dihet se janë çelës për përmirësimin e sundimit të ligjit dhe të qeverisjes. Ndërtimi i kapacitetit në këto institucione do të ngërthejë më shumë se vetëm trajnim të thjeshtë, ai do të kërkojë një qasje gjithëpërfshirëse që analizon barrierat kryesore ndaj performancës dhe identifikon zgjidhjet në bazë të atyre mangësive<sup>20</sup>. Në promovimin e gjithëpërfshirjes dhe fuqizimit të pakicave kombëtare si dhe përmirësimin e kapacitetit të shoqërisë civile për të kryer mbikëqyrjen dhe për ta bërë avokimin më efektiv, USAID-i do të vazhdojë të adresojë fushat e mirënjohura të rëndësishme kritike për të siguruar arritje të qëndrueshme afatgjatë në sundimin e ligjit dhe në qeverisje.

Duke marrë parasysh RN1.1 (*Sektor më efikas, transparent, të pavarur dhe llogaridhënës të drejtësisë*), kushti është që sundimi i ligjit të përforcohet duke përmirësuar administrimin e gjykatave dhe kapacitetin e institucioneve kryesore në qendër, duke përforcuar aftësitë e profesionistëve të sektorit të drejtësisë, dhe duke përmirësuar e zbatuar ligjet dhe rregulloret e caktuara që lidhen me tregtinë, pronën dhe zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. RN1.2 (*Përforcimi i efektivitetit dhe llogaridhënies së kuvendeve, administratave dhe proceseve zgjedhore*) fokusohet në përmirësimin e kapaciteteve të organeve të zgjedhura, subjekteve lokale administrative dhe procedurave a praktikave zgjedhore që do të përmirësojë mundësinë për të ofruar përgjigje, dhe në rastin e subjekteve lokale, të veprojnë si kundërpeshë ndaj autoritetit qendror. Kuvendet janë institucionet kryesore të dizajnuara për të përfaqësuar brengat dhe hallet e qytetarëve, prandaj përmirësimi i punës së tyre është kritik për demokratizim më të madh. Decentralizimi është komponenti kryesor i strategjisë për të shpërndarë dhe për të kaluar pushtetin te autoritetet lokale të cilat janë më afër qytetarëve, i përgjigjen më mirë prioriteteve të tyre dhe mund të mbahen llogaridhënëse. Pushteti lokal megjithatë duhet të ketë kapacitetin përkatës për të ofruar shërbime efektive dhe për të ushtruar menaxhim të shëndoshë financiar.

<sup>20</sup> USAID, "Doracaku për zhvillimin e kapacitetit njerëzor dhe institucional", gusht 2011 dhe USAID, *Vlerësim i zhvillimit të kapacitetit institucional*: Kosovë, gusht 2012. Doracaku është model i USAID-it për proceset e integruara dhe të strukturuara të dizajnuara për të identifikuar shkaqet fundamentale të mungesës së performancës në institucionet partnere të shtetit nikoqir. Shfrytëzimi i këtij modeli gjithëpërfshirës do të jetë thelbësor në adresimin e ndërtimit të kapacitetit institucionale në mënyrë gjithëpërfshirëse, që shkon përtej konsiderimit të ndërtimit të kapacitetit vetëm si trajnim. Vlerësimi HICD i Kosovës bazohet në këtë model, dhe ka shërbyer si resurs madhor në artikullimin e këtij objektiv zhvillimor.

Në fund, zgjedhjet paraqesin vulën e procesit demokratik, të cilat i ofrojnë mundësi të rëndësishme qytetarëve të dëgjohet zëri i tyre. Supozimi zhvillimor i RN1.3 (*Përmirësimi i integritit të pakicave etnike*) është nevoja për të krijuar kushte proaktive të cilat mundësojnë angazhimin aktiv në ekonomi dhe shtimin e bashkëveprimit me institucionet kosovare në nivel lokal. Kjo do të mundësojë integrimin e gjerë në sistemet politike dhe ekonomike dhe do të adresojë shkakun e mundshëm të konfliktit. Së dyti, ai do të promovojë pjesëmarrjen aktive politike të pakicave, për të siguruar zërin e tyre në formësimin e të ardhmes së tyre dhe të shtetit të tyre. Kushti i RN1.4 (*Përforcimi i shoqërisë civile për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive me qeverinë*) është që qytetarët duhet të marrin pjesë në mënyrë efektive në qeverisje për të siguruar llogaridhënie më të madhe dhe përgjigje ndaj nevojave të tyre. Angazhimi i vazhdueshëm i qytetarëve gjithashtu i kontribuon qëndrueshmërisë së reformave demokratike, në veçanti aftësia e njerëzve për të kërkuar ndryshime kërkon që qytetarët të jenë të informuar dhe të fuqizuar, të aftë t'i kuptojnë çështjet dhe të avokojnë për prioritetet e tyre. Fuqizimi i zërit të grave, rinisë dhe grupeve tjera shpeshherë të marginalizuara është çelës për pjesëmarrjen më të madhe të qytetarëve. Në përmbledhje, të gjitha këto RN (dhe nën-RN) përqendrohen në arritjen e objektivit zhvillimor dhe ndërlidhen logjikisht me synimin e përgjithshëm strategjik të prosperitetit i cili përkrahet nga respektimi i qëndrueshëm i sundimit të ligjit dhe nga qeverisja e mirë.

### *OZh2: Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat*

Hipoteza kryesore e këtij objektivit zhvillimor është se ekonomia e diversifikuar e Kosovës, me përqindje më të vogël të sektorit publik dhe me përqindje më të madhe të sektorit privat, do të mundësojë rritje më të shpejtë dhe më të qëndrueshme sesa rritja e tanishme. Kjo është një premisë makro-ekonomike e përkrahur nga politikë bërësit anekënd botës të cilët me bindje thonë se diversifikimi ekonomik redukton ndikimin e ngjarjeve të jashtme dhe nxitë rritje më të fuqishme dhe elastike në periudhë të gjatë. BPV-ja e shtetit jo vetëm që duhet të jetë e baraspeshuar në mes të sektorëve, por elementet kryesore të ekonomisë duhet të jenë të ndryshme, fleksibile dhe lehtë të aplikueshme në mundësitë e ndryshme ekonomike<sup>21</sup>. Nëse ka diversifikim më të madh, të mbështetur nga mjedisi më i mirë dhe i favorshëm afarist, qasje më të mirë në kredi, fuqi punëtore më të kualifikuar dhe burime të qëndrueshme të energjisë, atëherë do të ketë rritje ekonomike më të shpejtë dhe më gjithëpërfshirëse. Kjo hipotezë përkrahet nga Diagnoza e Kosovës për Rritje, e cila si reagim ndaj rritjes së investimeve publike me investime private të nivelit të njëjtë apo më të ulët, deklaroi: "...Analiza jonë tregon se për të nxitur rritjen dhe punësimin, investimi i sektorit privat duhet të rritet"<sup>22</sup>. Ngjashëm, Banka Botërore pat deklaruar se "...në të ardhmen, rritja e qëndrueshme dhe e shpejtë ekonomike do të varet nga sektori privat më aktiv"<sup>23</sup>.

Premisa e RN2.1 (*Përmirësimi i qeverisjes ekonomike dhe i mjedisit afarist*) është që qeveritë mund të krijojnë një mjedis pozitiv për rritje gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme (e kështu të arrihen rezultatet e RN dhe nën-RN të cilat përkrahen drejtpërdrejtë OZh-në dhe arritjen e qëllimit strategjik). USAID-i ishte donatori kryesor në përpilimin dhe përforcimin e ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e këtyre institucioneve, p.sh. Ministria e Financave dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Tani sfida është sigurimi i zbatimit të njëtrajtshëm dhe realizimi i retorikës së mjedisit të fuqishëm e të favorshëm afarist. Sugjerimi në lidhje me RN2.2 (*Ngritja e konkurrueshmërisë dhe e lidhjeve tregtare në fushat e shënjestruar të sektorit privat*) është se rritja ekonomike mund të arrihet duke përmirësuar konkurrueshmërinë dhe lidhjet me të gjithë zinxhirët e vlerave dhe sektorët kryesor që funksionojnë si ngasës të ekonomisë dhe krijojnë vende pune. Sektorët për përkrahje nga USAID-i do të zgjidhen duke i

<sup>21</sup> Moujaes, Chadi N.; Najjar, Mazen Ramsay; Shediak, Richard; Ghaleb, Joey, *Elastik, stabil, i qëndrueshëm: Përfitimet nga diversifikimi ekonomik*, Booz & Company, maj 2011.

<sup>22</sup> USAID, diagnozë e rritjes në Kosovë: Analizë e pengesave, shtator 2012.

<sup>23</sup> Banka Botërore, Njësia për ulje të varfërisë dhe menaxhim ekonomik, *Kosova po zhbllokon potencialin për rritje: Strategjitë, politikat, veprimet; Memorandum ekonomik i shtetit*, prill 2010.

kushtuar vëmendje potencialit për punësim të rinisë dhe të femrave. Një nga sektorët e synuar me siguri se do të jetë bujqësia, me qëllim që t'i ndihmohet Kosovës në krijimin e vendeve të punës në viset rurale (ku jeton 60% e popullsisë), të kultivojë kultura bimore me potencial eksportimi dhe të shtojë prodhimtarinë vendore për konsum vendor. Kjo qasje pritet të rezultojë në rritjen e mundësive për punësim, zëvendësim të importeve, zgjerim të bazës së eksporteve dhe ndihmon në integrimet e mëtejshme rajonale dhe evropiane. Të gjitha këto janë përbërës thelbësor për sukses, nëse realizohet ky objektivi zhvillimor dhe synim strategjik. Në fund, dhe siç është dëshmuar shumë herë, zëri i qytetarëve të rëndomtë dhe i organizatave afariste do të jetë pjesë përbërëse në arritjen e këtij RN dhe nën-RN-ve të tij, përderisa përforcimi i aftësive të tyre për të avokuar për përmirësim të politikave do të jetë fokus shtesë i cili lidhet me RN1.4 (*Përforcimi i shoqërisë civile për t'u përfshirë në mënyrë konstruktive me qeverinë*) dhe kjo do të përkrahë drejtpërdrejtë gjithëpërfshirjen e kërkuar për arritjen e objektivit zhvillimor. RN2.3 (*Përmirësimi i menaxhimit të resurseve natyrore në fushat kryesore*) fokusohet në sigurimin e furnizimit me energji elektrike brenda kontekstit të zhvillimit të bazës së resurseve natyrore të Kosovës në mënyrë të qëndrueshme, duke përbushur obligimet nën Traktatin e Komunitetit për Energji. Hipoteza është se vetëm nëse vendosen politikat, ligjet dhe rregulloret efektive dhe ato të zbatohen, atëherë Kosova do të mund të shfrytëzojë në maksimum resurset minerale që shfrytëzohen për energji dhe ato që nuk shfrytëzohen për energji.

### *OZh3: Të Forcohet Kapitali Njerëzor*

Hipoteza kryesore e këtij objektivit zhvillimor është se arsimit cilësor dhe qasja e barabartë në sistemin arsimor të shtetit e mbështesin zhvillimin gjithëpërfshirës të vendit. Nëse Kosova ka popullsi më të arsimuar, të aftësuar në fushat përkatëse, atëherë nevojat e ekonomisë për burime njerëzore do të përbushen në mënyrë efektive, mirëqenia ekonomike e qytetarëve do të sigurohet, dhe qytetarët do të jenë më të përgatitur për t'u angazhuar me qeverinë në mënyrë efektive. Kjo premisë përkrahët nga kuptimi i përgjithshëm i cili është artikuluar rishtazi në *Vlerësimin e zhvillimit të kapacitetit njerëzor dhe institucional të Kosovës*<sup>24</sup>. Prandaj arritja e këtij qëllimi strategjik do të avancohet, ashtu që shteti prosperues të varet në mes tjerash nga popullsia e aftësuar dhe e arsimuar. Gjithashtu, lidhja në mes të këtij objektivit zhvillimor dhe OZh-ve tjera është e qartë, d.m.th. përmirësimi i mundësive arsimore do të përmirësojë aftësinë e qytetarëve që të angazhohen në mënyrë më konstruktive me qeverinë, elektorati në përgjithësi do të jetë më i informuar, pakicat do të kenë gjasa më të mira të integritit të suksesshëm ekonomik dhe shoqëror, dhe përmirësimi i mundësive për arsimim dhe aftësim do të rrisë gjasat që qytetarët të përfitojnë nga administratorët dhe përfaqësuesit më të kualifikuar (OZh1). Ngjashëm, mundësitë për aftësim dhe arsimim, në veçanti ato që fokusohen te ndërmarrësit, do të avancojnë arritjen e synimeve për investime dhe punësim (OZh2).


Premisa e RN3.1 (*Përmirësimi i arsimit parauniversitar*) është që përmirësimet në sistemin arsimor të brishtë të Kosovës duhet të fillojnë në nivelet filllore (klasat 1-9) dhe të mesme (klasat 10-12). Përderisa sistemi jozyrtar i arsimit i cili ekzistonte para pavarësisë është zyrtarizuar, sistemi i arsimit parauniversitar në Kosovë ende është inferior. Hipoteza është se me përmirësimin e kurrikulumit, metodologjive mësimdhënëse, materialeve dhe menaxhimit të shkollave në nivelin lokal, rezultatet mësimore do të përmirësohen, gjë që u mundëson nxënësve të vazhdojnë aftësimin dhe arsimin e tyre të lartë, e më pas të punësohen. RN3.2 (*Përmirësimi i bazës së aftësive profesionale*) fokusohet në premisën se mundësitë për arsimim të lartë dhe aftësim në Kosovë duhet të përmirësohen dhe të ndërlidhen me nevojat e ekonomisë nëse nxënësit do të kualifikohen për punësim dhe më pas të punësohen në sektorët kryesor të ekonomisë. Arsyeja prapa sigurimit të mundësive për studim jashtë vendit është që individët të cilët fitojnë mundësi të tilla, do t'i përkrahin "mënyrat e reja të mendimit dhe të punës". Gjatë shumë dekadave, vlerësimet e pjesëmarrësve në trajnimet e ofruara nga Agjencia e kanë përkrahur këtë perspektivë, dhe USAID-i beson se këto mundësi vazhdojnë të jenë të rëndësishme

<sup>24</sup> Odell, Malcolm J., et.al, *Vlerësimi i zhvillimit të kapacitetit njerëzor dhe institucional: Kosovë, raport i përgatitur për USAID-in nga Aguirre Division of JBS International, Inc., gusht 2012.*

në Kosovë, që është shtet i ri dhe i vogël me mundësi të kufizuara për nevojat teknike dhe të përparuara të një ekonomie e cila synon diversitetin dhe zgjerimin. Thënë më shkurt, përmirësimi i profesionalizmit, avansimi i sistemeve të menaxhimit, përmirësimi i mësimdhënies dhe zgjerimi i mundësive arsimore duhet të bëhen realitet në mënyrë që të mund të realizohen Objektivi Zhvillimor dhe Qëllimi Strategjik në fjalë.



### III. KORNIZA E REZULTATEVE



## A. Deklaratë e Synimit Strategjik

Qëllimi i Përgjithshëm Strategjik i SBZhV-së në fjalë është si vijon:

*Kosova të Bëhet Shtet Gjithnjë e më i Begatshëm, i cili në Mënyrë Progressive Integrohet në Komunitetin Euro-Atlantik, me Qeverisje më Efektive dhe më Llogaridhënëse.*

Ky qëllim strategjik rrjedh drejtpërdrejtë nga planet e Qeverisë së Kosovës të cilat synojnë avancimin e rritjes ekonomike dhe përfundimin e institucioneve në të mirë të të gjithë qytetarëve. Në veçanti kjo strategji do të përkrahë drejtpërdrejtë përpjekjet e Qeverisë së Kosovës në përfundimin e sistemeve gjyqësore, legjislative dhe administrative (përfshirë strukturat elektorale) dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së OShC-ve, grave, rinisë dhe pakicave (OZh1)<sup>25</sup>. Ai do të përkrahë prioritetet e zhvillimit ekonomik të Qeverisë së Kosovës që janë dhënë në *Vizionin dhe Planin e Veprimit për Zhvillimin Ekonomik (OZh2)*<sup>26</sup>. Dhe do të vazhdojë të ndihmojë përfundimin e sistemeve arsimore të Kosovës në vijë me politikatat dhe qasjet strategjike të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të shkruara në *Planin Strategjik të Arsimit për Kosovë 2011-2016 (OZh3)*.

Ky qëllim në pajtim me *Strategjinë e Integruar Shtetërore për Kosovën (Viti Fiskal 2014-2016)* e cila rishtazi u miratua nga Qeveria e ShBA-së, e cila synon angazhim të vazhdueshëm dhe asistencë zhvillimore për Kosovën, për t'u siguruar "*...se ky cep i Ballkanit, i trazuar për kohë të gjatë nga tensionet dhe dhuna ndëretnike, do t'i bashkohet Evropës në tërësi, në liri dhe në paqe*". Katër qëllimet specifike të strategjisë së integruar shtetërore që lidhen me rritjen ekonomike, sundimin e ligjit dhe qeverisjen, gjithëpërfshirjen dhe integrimet euro-atlantike janë të përkrahura drejtpërdrejt nga kjo strategji. Ky plan strategjik gjithashtu është i përvijuar me *Strategjinë e përbashkët rajonale të Departamentit të Shtetit/USAID-it*, e cila artikulon zotimin e Administratës "*...që të sheh Ballkanin plotësisht të integruar në institucionet Euro-Atlantike si pjesë e Evropës demokratike dhe prosperuese*"<sup>27</sup>.

Lidhjet me *USAID Forward* janë përmbledhur në tekstin e këtij dokumenti, së bashku me çështjet tjera të gërshetuara, dhe janë përshkruar më tutje në shtojcën 2. Qëllimi gjithashtu njihet dhe koordinon me kontributet dhe rezultatet e donatorëve tjerë të mëdhenj, siç është treguar në hollësi në seksionet e poshtme.

Ky qëllim është shumë i matshëm. Rritja e forcës së institucioneve në Kosovë monitorohet rregullisht nga Bashkimi Evropian (BE) dhe organizatat tjera ndërkombëtare, p.sh. nga Kombet e Bashkuara, OJQ-të ndërkombëtare monitoruese siç është *Freedom House* dhe nga raportimi i vet Qeverisë së ShBA-së. Rritja ekonomike përcillet rregullisht nga Banka Botërore dhe FMN dhe nga analizat e Qeverisë së ShBA-së.

USAID-i ka zgjedhur tri objektiva zhvillimore të cilat do të përshpejtojnë këtë tranzicion drejt prosperitetit më të madh dhe qeverisjes gjithëpërfshirëse e llogaridhënëse gjatë periudhës strategjike pesëvjeçare, dhe me një hap shumë më të përshpejtuar në krahasim me atë që do të ndodhte sikur USAID-i të mos angazhohej. Këto objektiva zhvillimore, që do të artikulohej tutje nëpërmjet

<sup>25</sup> Dokumentet përkatëse për Qeverinë e Kosovës, planet për përmirësim të sistemeve gjyqësore, legjislative dhe administrative përfshijnë: a) *Propozimi gjithëpërfshirës për statusin 2007 (Plani i Ahtisaarit)*, b) *Programi legjislativ 2013 (që prezantohet në bazë vjetore)*, c) *Plani i zbatimit të ligjit të ri për gjykatat 2011*, d) *Prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë 2011-2014*, e) *raport i QK-së për zbatimin e decentralizimit 2012*, f) *Strategjia e Kuvendit të Kosovës për marrëdhëniet me publikun 2012*, g) *Rezoluta që pranon parimet e Prishtinës që rrjedhin nga Samiti i Grave, tetor 2012*, dhe h) *Strategjia për vetëqeverisjen lokale 2012-2015*.

<sup>26</sup> Republika e Kosovës, *Vizioni dhe plani i veprimit për zhvillim ekonomik*, korrik 2011.

<sup>27</sup> Departamenti i Shtetit/Byroja për çështje evropiane dhe euro-aziatike dhe Byroja e USAID-it për Evropë dhe Euro-Azi, *Strategjia e përbashkët rajonale, VF2014-2016*.

Dokumenteve për Vlerësim të Projektit, do të dizajnohen për të kufizuar faktorët e rrezikut siç janë ato që lidhen me korrupsionin, planifikimin e dobët, menaxhimin e dobët dhe sistemet administrative në sektorët kryesor, dhe pengesat relative të Kosovës siç është situata gjeografike pa dalje në det, njohja e kufizuar ndërkombëtare dhe prezenca e strukturave ilegale të qeverisjes në komunat me shumicë serbe. OZh-të do të rrisin në maksimum inputet e konsiderueshme të financimit të Qeverisë së Kosovës, p.sh. në arsimin parauniversitar dhe të lartë dhe për DCA që demonstroi angazhim dhe përkrahje aktive në shtetin nikoqir. Do të kërkohen të dhënat gjinore dhe informatat e zbërthyer sipas gjinisë, aq sa ka mundësi, në vendosjen e bazës dhe treguesve përcjellës për të gjitha OZh-të dhe aktivitetet përkatëse<sup>28</sup>.

### **Marrëdhënia e OZh-ve me Qëllimin Strategjik**


**OZh1: Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja Ashtu që t'i Përmbushin Nevojat e Qytetarëve.** Ky OZh adreson drejtpërdrejtë një aspekt madhor të qëllimit strategjik, d.m.th. qeverisjen efektive dhe llogaridhënëse. Përderisa Kosova ka bërë progres në krijimin e politikave dhe ligjeve që do të çojnë kah arritja e këtij objekti, në sektor mbetet një dobësi madhore që duhet të adresohet, jo vetëm për të arritur këtë objekt, por si kërkesë themelore e domosdoshme për rritjen e përgjithshme ekonomike.

**OZh2: Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat.** I përkrahur nga progresi në kuptim të përfundimit të institucioneve (OZh1) dhe nga popullsia më e aftësuar dhe e arsimuar (OZh3), ky objektivi zhvillimor do të promovojë rritjen e duhur të ekonomisë, që është me rëndësi qendrore për arritjen e qëllimit strategjik. Kosova tani radhitet si shteti më i varfër në rajonin e Ballkanit, dhe pa rritje ekonomike dramatike, synimi për standard të jetesës të krahasueshëm me Evropën do të mbetet iluzion, përderisa stabiliteti do të rrezikohet.

**OZh3: Të Forcohet Kapitali Njerëzor.** Ky OZh do t'i kontribuojë drejtpërdrejtë krijimit të një Kosove më të begatshme dhe arritjes së OZh1, OZh2 dhe të qëllimit strategjik, duke siguruar se shteti ka popullsi më të arsimuar që siguron funksionimin efikas të institucioneve kryesore, se janë plotësuar nevojat e ekonomisë së ndryshme për kualifikime, se zëri i qytetarëve do të dëgjohet kur ata kërkojnë llogaridhënie dhe transparencë nga organet publike, dhe se individët mund t'i realizojnë më mirë dëshirat e tyre për karrierë të begatshme dhe jetë më të lumtur personale dhe më të sigurt në aspektin ekonomik.

Në kontekst të arritjes së këtyre objektivave zhvillimorë dhe të qëllimit strategjik, ekzistojnë disa prioritetë të gërshetuara të cilat do të adresohen në çdo nivel, do të thotë *USAID Forward* (shih shtojcën 2), fuqizimi i grave, zhvillimi njerëzor dhe institucional, anti-korrupsioni, rinia dhe integrimi i pakicave.

<sup>28</sup> Përveç atyre dokumenteve nga shtojca 3: Bibliografi, lista e përditësuar e të gjitha vlerësimeve dhe raporteve 2009 - shkurt 2013 që japin një pasqyrë dhe informata hyrëse për përgatitjen e këtij CDCS mund të merren nga USAID/Kosovë (kosovainfo@usaid.gov). Nuk janë publikuar të gjitha këto dokumente.



## B. Objektivi Zhvillimor 1

### *Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja Ashtu që t'i Përbushin Nevojat e Qytetarëve*

OZh e strategjisë së propozuar nga USAID-i do të fokusohet në ndihmën për Qeverinë e Kosovës për t'u bërë më efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në përgjigje ndaj nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Ky OZh pasqyron disa norma të rëndësishme: a) efektiviteti përkufizohet si aftësi e qeverisë për të ofruar shërbime cilësore në mënyrë efektive dhe me kohë; b) me qëllim që të bëhet llogaridhënëse dhe përgjegjëse, Qeveria duhet të vendosë mekanizma të hapur dhe transparent për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe për të siguruar se pikëpamjet e tyre ndikojnë në vendimmarrje; dhe c) gjithëpërfshirja, në veçanti në lidhje me serbët e Kosovës, gratë dhe të rinjtë, paraqet elementin e domosdoshëm të shtetit për të arritur sukses afatgjatë në demokracinë paqësore. Ky OZh do të konsolidojë investimet e kaluara duke u fokusuar në mënyrë tërësore në zhvillimin e institucioneve të synuara të cilat janë çelës i qëndrueshmërisë, dhe njëkohësisht do të promovojë integrimin e pakicave kombëtare dhe aftësinë e shoqërisë civile për të kryer mbikëqyrje dhe avokim në mënyrë më efektive.

Ky OZh përkrahë drejtpërdrejtë *Strategjinë e USAID-it për demokraci, të drejta të njeriut dhe qeverisje* të vitit 2012, veçanërisht qëllimet numër 2 dhe 3 të *Strategjisë së integruar shtetërore për Kosovën* nga Qeveria e ShBA-së<sup>29</sup>.

### **Supozimet Kyce dhe Rreziqet për OZh1**

Arritja e këtij Objektivit Zhvillimor do të varet nga zotimi i Qeverisë së Kosovës që në mënyrë aktive t'i zbatojë reformat në fusha të caktuara kritike. OZh e strategjisë supozon se Qeveria e Kosovës: a) do të vazhdojë zotimin për të udhëhequr dhe zbatuar reformat e sektorit të drejtësisë, në veçanti në ristrukturimin e gjykatave, b) do të vazhdojë të decentralizojë pushtetin financiar, administrativ dhe politik te komunat me qëllim të sigurimit të suksesit në kuptim të decentralizimit dhe transferimit të pushtetit dhe të përgjegjësisë në atë nivel ku nevojat e qytetarëve kuptohen dhe përmbushen më së miri; c) do të mbetet i palëkundur në zotimin e saj në lidhje me integrimin e pakicave në shoqëri dhe në politikë; dhe d) do të përfundojë reformat zgjedhore me qëllim të mbajtjes së suksesshme të zgjedhjeve të para të përgjithshme në pajtim me ligjin e rishikuar për zgjedhjet në vitin 2014, si dhe të mbajë zgjedhjet e para të drejtpërdrejta presidenciale në vitet e ardhshme.

Në lidhje me këtë pikë, kjo OZh e strategjisë supozon se USAID-i dhe subjektet tjera të Qeverisë së ShBA-së do të angazhohen çdo ditë e më shumë në përforcimin e aftësisë së Qeverisë së Kosovës në mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, në veçanti duke ditur se OSBE-ja po kalon në rolin ekskluziv si vëzhgues. Ky OZh i strategjisë gjithashtu supozon se USAID-i, në koordinim me agjencitë tjera të Qeverisë së ShBA-së, do të jetë në gjendje, dhe do të ketë buxhetin, për të ndihmuar komunat me shumicë të serbëve të Kosovës, pasi që të paraqiten mundësitë.

### **Donatorët Tjerë**

USAID-i do të vazhdojë të koordinojë ngushtë me Bashkimin Evropian (BE) dhe me disa donatorë bilateral. Duhet të theksohet se Qeveria e Norvegjisë dhe USAID-i do të përfundojnë bashkëfinancimin për renovimin e të gjitha gjykatave në Kosovë nëpërmjet projektit të USAID-it për Sundimin Efektiv të Ligjit (2011-2015). Pasi që Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX) po zvogëlohet, USAID-i do të punojë me BE-në, në veçanti në lidhje me reformat ligjore, për të siguruar se ligjet ekzistuese dhe të reja janë në pajtueshmëri me kërkesat e BE-së. Projekti i planifikuar për përmbardim dhe legjislacion komercial (2013-2016) dhe Projekti për të drejtat pronësore (2014-2016) do të kenë nevojë për koordinim të shtuar me BE-në dhe me Bankën Botërore.

Përveç donatorëve tjerë, USAID-i do të vazhdojë punën e ngushtë me Programin për asistencë ndërkombëtare në trajnime në hetuesinë penale (ICITAP) të Departamentit të Drejtësisë së ShBA-së, në ndihmën për përforcim institucional të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sa i përket komunave me shumicë serbe në veri, USAID-i do të punojë me ambasadën për të ofruar përkrahje në shtrirjen e sistemit gjyqësor të Kosovës në këtë pjesë, pasi që Qeveria e Serbisë të shpërbëjë strukturat paralele të qeverisë.

### **Cilat janë Dallimet në Krahasim me Portofolin e Tashëm?**

Reduktimi dramatik i fondeve paraqet dallim të dukshëm nga e kaluara. QZh i strategjisë nuk do të përkrahë më programin e veçuar për media të pavarura dhe shumica e punëve do të përfundojnë në projektet për infrastrukturë të ujësjellësit, spitaleve dhe klinikave shëndetësore, qendrave emergjente të pediatrikë dhe shkollave. Do të përfundojë asistencë për fakultetin juridik. Misioni ka ndërprerë

<sup>29</sup> Qëllimi i SISH numër 2: Shoqëria dhe qeveria e Kosovës bazohet më fuqishëm në sundimin e ligjit dhe promovojnë institucione më të forta transparente dhe llogaridhënese të shoqërisë demokratike, përfshirë shoqërinë civile. Qëllimi i SISH numër 3: Kosova është shtet ku populli i vet i larmishëm, në veçanti serbët e Kosovës, i kontribuojnë dhe përfitojnë nga institucionet demokratike të Kosovës dhe nga rritja ekonomike, duke qenë më të integruar dhe më të pranuar nga shoqëria në përgjithësi.



përkrahjen e strehimoreve për viktimat e dhunës në familje/trafikim me qenie njerëzore dhe tani do të kanalizojë asistencën nëpërmjet RN1.4.2 (*Përfaqësimi më i madh i grave, të rinjve dhe grupeve tjera të rrezikuara*). Do të përfundojë përkrahja për Presidencën. Për dallim nga vitet e mëhershme, asistencë relativisht e ulët do të jepet për hartimin e ligjeve dhe për themelimin e institucioneve të reja.

OZh1 paraqet një përmbledhje të investimeve të kaluara duke i bërë institucionet më efektive në zbatimin më të mirë të reformave. Ai përqendrohet në zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve dhe proceseve tanimë të vendosura në shumë institucione dhe sektorë në të cilat USAID-i ka investuar më parë, duke adresuar njëkohësisht fushat e reja të cilat konsiderohen thelbësore për arritjen e Qëllimit Strategjik të Misionit. Strategjia e re shton asistencën për "anën e kërkesës" duke shënjestruar OShC-të.

OZh1 e strategjisë do t'i bëjë më efektive institucionet e sektorit të drejtësisë të cilat janë ndihmuar nga Misioni, edhe pse përkrahja për "harduer" do të reduktohet pasi që shumica e punëve në infrastrukturë, pajisje dhe teknologji informative për gjykata ka përfunduar. Njëkohësisht ky OZh do të adresojë reformat e brezit të dytë në sundimin e ligjit siç janë e drejta komerciale dhe të drejtat pronësore, në kuptim të të drejtave (dhe trashëgimisë) të grave dhe në kuptim të çështjeve që ndikojnë efektivitetin e gjykatave në trajtimin e çështjeve që ndërlidhen me sektorin privat dhe me rritjen ekonomike (d.m.th. përmbartimi i aktgjykimeve). Puna në sundimin e ligjit do të kalojë nga perspektiva e gjerë e të drejtës civile në fokus më të ngushtë të së drejtës komerciale, gjë që do të përmirësojë klimën investive. Ky OZh gjithashtu do të inkorporojë një qasje më gjithëpërfshirëse dhe strategjike për zhvillimin e kapacitetit njerëzor dhe institucional nëpërmjet përkrahjes së Institutit Gjyqësor të Kosovës me qëllim të përforsimit të aftësive praktike për gjyqtarët dhe për stafin e gjykatave.

Fokusi i asistencës paksa të reduktuar për pushtetin lokal do të vihet mbi integrimin e komuniteteve pakicë në shoqërinë kosovare. Megjithatë përkrahja për komunat me shumicë shqiptare nuk do të përfundojë plotësisht pasi që ato komuna ende kanë nevojë për përmirësime, dhe duhet të shmangim situatën ku shqiptarët të mendojnë se po injorohen dhe se komunitetet tjera po pranojnë asistencë disproporcionale. Kjo situatë mund të jetë shkak për konflikt. Strategjia në veçanti do të fokusohet edhe në llogaridhënien e qeverisë. Kjo ndërthen llogaridhënien para elektoratit dhe llogaridhënien në menaxhimin financiar.

## **Rezultatet e Ndërmjetme**

***RN1.1: Sektor më Efikas, Transparent, të Pavarur dhe Llogaridhënës të Drejtësisë.*** Disa vlerësime, përfshirë edhe Raportin e Progresit të BE-së<sup>30</sup> dhe *Studimin e fizibilitetit për marrëveshjen e stabilizimit asociimit*<sup>31</sup> kanë identifikuar sundimin e ligjit si prioritetin kryesor për Kosovën. Ky RN kryesisht adreson "anën e furnizimit" të reformës në sektorin e drejtësisë, por edhe nismat e "anës së kërkesës". Institucionet efektive të drejtësisë janë thelbësore për përmirësimin e besimit publik ndaj qeverisë dhe për vendosjen e themelit për rritjen ekonomike dhe për një shoqëri demokratike, në veçanti në mjedis të pas konfliktit. Në Kosovë, gjyqësori mbetet dega më e dobët nga tri degët e Qeverisë. Që nga fillimi i vitit 2000, gjyqësori kontrollohej nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) e më pas nga EULEX-i, përderisa reformat në gjyqësi nuk filluan gjerë në fillim të vitit 2008. Strategjia e USAID-it do të përmirësojë: a) efikasitetin duke zbatuar një metodologji për reduktimin e lëndëve të vjetra dhe aplikimin e standardeve kohore; b) transparencën dhe llogaridhënien duke i bërë gjykatat më të hapura dhe më miqësore për popullin; dhe c) pavarësinë duke përforsuar profesionalizmin dhe duke reduktuar ndikimin politik. Është me rëndësi të theksohet se sektori i pavarur i drejtësisë nuk nënkupton sektor të drejtësisë që nuk i jep llogari askujt. Sektori mund të bëhet më llogaridhënës nëpërmjet mekanizmave formal që disjelojnë gjyqtarët, por edhe nëpërmjet mekanizmave joformal siç janë

<sup>30</sup> Bashkimi Evropian, *Raporti i progresit 2011 për Kosovën*.

<sup>31</sup> Bashkimi Evropian, *Studimi i fizibilitetit për marrëveshjen për stabilizim asociim në mes të BE-së dhe Kosovës*, Bruksel 2012.

organizatat vëzhguese dhe mediat. Sektori i drejtësisë që është më efikas, transparent, i pavarur dhe llogaridhënës do të ndihmojë në arritjen e qëllimit të misionit "...qeverisje më efektive dhe llogaridhënëse".

**Nën-RN1.1.1 (Përmirësimi i Administratës së Gjykatave dhe i Menaxhimit të Institucioneve Gjyqësore)** do të fokusohet në përforcimin e kapacitetit të epërm në institucionet kryesore shtetërore të cilat qeverisin me sistemin e drejtësisë. Në veçanti USAID-i do të përforcojë kapacitetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për të kryer rolin e mbikëqyrjes, disiplinës dhe menaxhimit; do të përkrahë zhvillimin institucional të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për të përmbushur mandatin e vet në administrim, disiplinë dhe menaxhim, do të përmirësojë kapacitetin e Ministrisë së Drejtësisë në asistencën juridike ndërkombëtare dhe në përfaqësimin e Qeverisë së Kosovës në procedura ligjore; do të përforcojë kapacitetin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) në procesin e aftësisë të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit të gjykatave; dhe në fund do të ndihmojë në përmirësimin e proceseve dhe procedurave në menaxhimin e gjykatave si dhe në menaxhimin e lëndëve në të gjitha gjykatat e Kosovës. Shembujt e përmirësimeve të pritura përfshijnë shfrytëzimin e teknologjisë informative për të menaxhuar më lehtë me lëndët, për qasje në të dhënat e sakta gjatë përgatitjes së buxheteve (e mos të varet nga dega e ekzekutivit), dhe për të përmirësuar transparencën duke i vënë lëndët në faqen në internet.

**Nën-RN1.1.2 (Ngritja e Kualifikimeve të Profesionistëve të Sektorit të Drejtësisë)** do të rrisë kapacitetin e profesionistëve të sektorit të drejtësisë në përmbushjen e roleve dhe përgjegjësi të tyre në mënyrë më efektive. USAID-i do të zbatojë edhe aktivitetet për institucionalizim të detyrueshëm të arsimit të vazhdueshëm juridik për një gamë të personelit të drejtësisë, përfshirë gjyqtarët, personelin e gjykatave, prokurorët dhe avokatët. Kjo asistencë do të përfshijë edhe studentët e fakultetit juridik. I tërë trajnimi do të përqendrohet në zhvillimin e aftësive praktike në fushat e përgjegjësi përkatëse të profesionistëve ligjor.

**Nën-RN1.1.3 (Përmirësimi i regjimeve ligjore në fushat kryesore me zbatim më të fuqishëm)** do të adresojë nevojën për ndryshim e plotësim të disa ligjeve të Kosovës ashtu që ato ligje të orientohen më shumë kah zbatimi dhe të harmonizohen me ligjet tjera. Edhe pse në përgjithësi Kosova ka shumë ligje moderne, ende mbizotërojnë problemet në lidhje me zbatimin e tyre, me mungesën e legjislacionit sekondar, udhëzimet për gjykata dhe rregulla praktike. Përveç kësaj, ndihma për zbatim do të kërkojë ngritjen e vetëdijes qytetare dhe avokimin e shoqërisë civile për monitorimin e zbatimit të drejtë të ligjeve (shih nën-RN1.4.1 (Ngritja e vetëdijes qytetare dhe e aftësisë së shoqërisë civile për të avokuar dhe monitoruar). Për shembull, disa ligje pronësore që kanë të bëjnë me çështje gjinore janë të mira në dukje, por tradita dhe praktikat zakonore i pengojnë gratë në ushtrimin e të drejtave të tyre trashëgimore (shih nën-RN1.4.2, *Përfaqësimi më i madh i grave, të rinjve dhe grupeve tjera të rrezikuara*). Ky është një shembull i mirë se si mund të ketë ndikim ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe udhëzimet e reja të gjykatave të cilat e ndryshojnë këtë supozim ligjor. Zbatimi i brezit të dytë të reformave ligjore, në veçanti në lidhje me përmbartimin e aktgjykimeve dhe të drejtave pronësore, do t'i adresojë pengesat ndaj zhvillimit ekonomik, investimeve dhe tregtisë (që lidhet fortë me OZh2, *Të shtohen investimet dhe të rritet punësimi në sektorin privat*), duke reduktuar njëkohësisht kategorinë me lëndët më të shumta të mbetura nëpër gjykata.

**RN1.1: Përforcimi i Efektivitetit dhe Llogaridhënies së Kuvendeve, Administratave dhe Proceseve Zgjedhore.** Ky RN do të promovojë efektivitet më të madh nëpër kuvende (përfshirë Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendet Komunale), pushtetet lokale dhe proceset zgjedhore. Në kuptim të Kuvendit të Kosovës dhe kuvendeve komunale, efektiviteti i referohet aftësisë së tyre për të përfaqësuar elektoratin e vet nëpërmjet miratimit të ligjeve të aplikueshme dhe në rolin e mbikëqyrësit efektiv. Në kuptim të qeverisjes komunale, efektiviteti i referohet aftësisë për të ofruar shërbime cilësore me kosto të arsyeshme. Zgjedhjet konsiderohen efektive kur mbahen në pajtim me standardet ndërkombëtare. Llogaridhënia i referohet elektoratit dhe përmirësimit të menaxhimit financiar.

**Nën-RN1.2.1 (Kuvendet dhe Administratat Komunale dhe Qendrore më Përgjegjëse)** do të fokusohet në ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese dhe operacionale të kuvendeve në nivel qendror dhe komunal për të luajtur rol më efektiv mbikëqyrës. USAID-i do të koncentrohet në përkrahjen e kuvendeve për të siguruar se përfaqësuesit e tyre dalin në terren dhe punojnë me elektoratin gjatë përmbushjes së nevojave të tyre. Përderisa ky RN do të fokusohet në aftësinë e qeverisë për të dëgjuar dhe përfaqësuar interesat qytetare, është me rëndësi që njëkohësisht të fokusohemi në RN1.4 (*Përforsimi i shoqërisë civile për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive me qeverinë*) në kuptim të angazhimit qytetar dhe zhvillim të partive politike. Përpjekjet për të arritur përmirësimet administrative do të koncentrohen në përkrahjen e ndërtimit të kapacitetit komunal, në veçanti në lidhje me menaxhimin financiar dhe konsolidimin e kontributeve të mëhershme të USAID-it me qëllim të përmirësimit të aftësisë së pushteteve lokale në adresimin e nevojave të qytetarëve të vet. Vazhdimi i këtyre përpjekjeve do të ketë rëndësi të veçantë, duke ditur se disa komuna të Kosovës janë relativisht të reja dhe janë themeluar pas pavarësisë në vitin 2008. Në lidhje me këtë, USAID-i do të përkrahë administratat komunale në: a) ngritjen e cilësisë së shërbimeve të veta dhe përmirësimin e qasjes në këto shërbime, p.sh. siguria në rrugë, kanalizimi, lëshimi i dokumenteve personale dhe i lejeve; b) përmirësimin e qëndrueshmërisë duke përmirësuar vjeljen e të hyrave vetanake, dhe c) zbatimin e nismave "për qeverisje llogaridhënëse" që do të shtojë transparencën dhe besimin në nivelin lokal.

Ky nën-RN lidhet fortë me RN2.1 (*Përmirësimi i Qeverisjes Ekonomike dhe i Mjedisit Afarist*) ashtu që i pari fokusohet në administratën e nivelit lokal kurse i dyti fokusohet kryesisht në institucionet e nivelit qendror dhe në politikat ekonomike në nivel shteti. Në thelb komunat efektive të cilat i përgjigjen qytetarëve shërbejnë si platformë e rëndësishme për rritje ekonomike të bazës së gjerë, ashtu që ekziston lidhja logjike në mes të të dyjave përderisa përparimi në të dyja arenat është tepër i rëndësishëm. Komunat duhet të fokusohet në zhvillimin ekonomik lokal, duke ngërthyer të gjitha çështjet siç është ulja e kërkesës së rentës (mundësisë për manipulim), zhvillimi i e-qeverisjes, krijimi i të hyrave vetanake dhe përmirësimi i menaxhimit financiar në të gjitha elementet e llogaridhënies. Tutje, fokusi në llogaridhënien financiare komunale do të përkrahë iniciativat e USAID-it *Forward G2G*.

**Nën-RN1.2.2 (Ngritja e Kapacitetit për të Mbajtur Zgjedhje Kredibile)** do të fokusohet në ofrimin e përkrahjes për përforsimin e vazhdueshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), gjë që plotëson përkrahjen e mëhershme të USAID-it për KQZ-në. USAID-i do të plotësojë hendekun që rezulton nga ndërrimi i rolit të OSBE-së nga "rol i këshillimor" në atë "monitorues" të proceseve politike pa monitorim të zgjedhjeve. Evropianët do të ofrojnë vetëm përkrahje politike, por jo përkrahje me projekt. Katër fushat e koncentrimin nga ana e USAID-it do të ngërthejnë hartimin e ligjeve të reja elektorale, përmirësimin e administratës zgjedhore, ndihmën në përcjelljen e ankesave dhe parashtrësive pas zgjedhjeve, dhe përfshirjen e rinisë në përgjegjësitë qytetare. Komponenti i fundit ka lidhje të fortë me OZh3 (*Të forcohet kapitali njerëzor*) dhe nën-RN1.4.1 (*Ngritja e vetëdijes qytetare dhe aftësisë së shoqërisë civile për të avokuar dhe monitoruar*).

**RN1.3: Përmirësimi i Integritit të Pakicave Etnike.** Duke ditur rëndësinë e integritit të pakicave, në veçanti të serbëve, në shoqërinë kosovare dhe në politikë, USAID-i do e trajtojë këtë çështje si RN të pavarur dhe si brengë e adresuar përgjatë tërë portofolit. Përderisa komponentët tjerë të OZh1 fokusohen në mënyrë të ekuilibruar në grupet dhe subjektet e synuara, ky element i strategjisë do të fokusohet kryesisht, por jo plotësisht, në integrimin e serbëve të Kosovës. Serbët e Kosovës duhet të përfshihen dhe të marrin pjesë në institucionet dhe në shoqërinë e Kosovës, në veçanti në komunat me shumicë serbe, ashtu siç është parashkruar në Kushtetutë dhe në Planin e Ahtisaarit<sup>32</sup>. Ky RN lidhet ngushtë me RN1.2 (*Përforsimi i efektivitetit dhe llogaridhënies së kuvendeve, administratave dhe proceseve zgjedhore*)

<sup>32</sup> Plani i Ahtisaarit, i njohur si Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, është propozim për zgjidhjen e statusit dhe mbulon çështje të një game të gjerë të cilat ndërlidhen me procesin e statusit të Kosovës. Plani në të vërtetë i përcakton strukturat e brendshme dhe shtetësinë e Kosovës.

ashtu që ai do të përmbajë iniciativa të administratës lokale, të cilat synojnë integrimin e komuniteteve të ndryshme etnike, pakicë e shumicë.

Nga pikëvështrimi politiko-ekonomik, integrimi dëshmohej nga numri i rritur i personave të regjistruar në shkollë dhe të punësuar, lidhja më e fortë në mes të tregjeve pakicë e shumicë, ngritja e zërit dhe pjesëmarrja politike. Realiteti nënvizon rëndësinë e ofrimit të asistencës për Qeverinë e Kosovës në përmirësimin e aftësive të saj në adresimin e çështjes së pakicave në mënyrë të qëndrueshme, prandaj USAID-i do të programojë përkrahjen jo vetëm në kontekst të këtij RN-je, por përgjatë tërë portofolit pasi që programet dhe projektet janë të dizajnuara për mundësitë që paraqiten në veri. Vëmendja që i kushtohet integritit të serbëve të Kosovës nuk do të ndikojë në vëmendjen që i kushtohet grupeve tjera të pakicave siç janë ashkallitë, boshnjakët, egjiptianët, goranët, romët dhe turqit. Tutje, nëse arrihet integrimi i serbëve të Kosovës, atëherë ky integrim do të "tërheqë" edhe integrimin e pakicave tjera.

**Nën-RN1.3.1 (Ngritja e Kapacitetit të Qeverisë për të Adresuar Çështjet e Pakicave)** do të koncentrohet në anën e furnizimit në ekuacionin e demokracisë. USAID-i do të përkrahë kapacitetin institucional të Qeverisë së Kosovës në adresimin e halleve dhe telasheve të pakicave në afat të gjatë. Siç thuhet në analizën e hollësishtme, kjo do të përfshijë përmirësimin e sistemeve dhe të proceseve ashtu që të vendosen mekanizmat nëpërmjet të cilave pakicat mund t'i kontribuojnë vendimmarrjes dhe ofrimit të shërbimeve<sup>33</sup>.

**Nën-RN1.3.2 (Rritja e Pjesëmarrjes Aktive të Popullsisë Pakicë)** paraqet anën e kërkesës në ekuacionin e demokracisë. Aktivitetet do të përmirësojnë aftësinë pjesëmarrëse të pakicave në pushtetin lokal dhe kështu mund të kërkojnë shërbime të cilat pasqyrojnë prioritetet e tyre. Këtu përfshihet përkrahja për nismat e komunitetit për të pasuruar cilësinë e jetesës në komunat e synuara nëpërmjet investimeve kapitale; përkrahja në rritjen e pjesëmarrjes së pakicave në sektorin publik të Kosovës; zbatimi i ligjit për shfrytëzimin e gjuhëve (mbrojtja e të drejtave gjuhësore) dhe funksionimi i Zyrës së komisionit të gjuhës; dhe kurdo që mundet, përkrahja për të adresuar çështjen e rinisë së papunë në komunitetet pakicë që gjithashtu ka nevojë për angazhim politik dhe në komunitet. Shkalla se sa mund të përkrahen këto aktivitete në veri do të varet nga tërheqja e strukturave paralele serbe.

**Nën-RN1.3.3 (Shtimi i Bashkëveprimit Ekonomik në mes të Komuniteteve Pakicë e Shumicë)** do të krijojë lidhjet në mes të tregjeve të komuniteteve shumicë e pakicë, për shembull nëpërmjet: a) zgjerimit të përparësive krahasuese në prodhimtarinë bujqësore dhe përforcimin e lidhjeve me shitësit me shumicë; b) promovimit të kredive dhe shërbimeve për zhvillimin afarist për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM); dhe c) përkrahjes për nismat lokale të udhëhequra nga sektori privat që fokusohen në mundësitë ekonomike dhe të punësimit brenda sektorëve ekonomik (përtej bujqësisë) të cilët krijojnë lidhje dhe kanë ndikim pozitiv te komuniteti pakicë. Këto lidhje do t'i ndihmojnë në veçanti serbëve në integrimin e bizneseve të tyre në tregje më të mëdha ku ka mundësi më të shumta për rritje dhe për zgjerim. Ky nën-RN do të operojë në "nivelin mikro", që synon pakicat specifike, për dallim nga OZh2 (*Të shtohen investimet dhe të rritet punësimi në sektorin privat*) i cili do të operojë kryesisht në "nivelin makro". Ky nën-RN ndërlidhet dhe përkrahë nën-RN2.2.2 (*Rritja e prodhimtarisë bujqësore dhe e mundësive për tregtim*).

#### **RN1.4: Përforcimi i Shoqërisë Civile për Angazhim më të Madh dhe Konstruktiv me Qeverinë.**

Përderisa USAID-i do të përkrahë përmirësimin e efektivitetit në institucionet kryesore qeveritare, USAID-i njëkohësisht do të përmirësojë aftësinë e qytetarëve për të ngrehur zërin në lidhje me brengat e tyre, dhe në angazhimin efektiv me strukturat vendimmarrëse ashtu që qeveria t'i përgjigjet më mirë nevojave të qytetarëve. Kjo paraqet anën e kërkesës së sundimit të ligjit dhe të qeverisjes. Përderisa ekzistojnë mekanizmat formal për pjesëmarrje publike në vendimmarrje qeveritare, ato nuk janë efektive

<sup>33</sup> Malazogu, Leon dhe Dusan Pavlovic, *komuniteti serb i Kosovës—Nga stabilizimi në qëndrueshmëri*, qershor 2012.

apo nuk shfrytëzohen. Gjatë kësaj periudhe të strategjisë, Misioni do të fokusohet në ndërtimin e kapacitetit të OShC-ve, përfshirë zhvillimin e sistemeve të brendshme menaxhuese të OShC-ve dhe në eksplorimin e mënyrave për të arritur stabilitet financiar, dhe në përmirësimin e aftësive të tyre për avokim dhe mbikëqyrje në lidhje me çështjet që mbuloohen nga platforma e tyre. Do të ekzistojë fokusi i veçantë në promovimin e përfaqësimit më të madh të grave, të të rinjve, të komunitetit gej, lesbian, biseksual dhe transseksual (LGBT), dhe të grupeve tjera të rrezikuara. Përderisa ky është objektivi diskret që i kontribuon tërë OZh1, ai gjithashtu është objektivi i rëndësishëm i gërshetuar jo vetëm me Sundimin e Ligjit dhe të Qeverisjes, por edhe me Rritjen Ekonomike (OZh2) dhe me Arsimin (OZh3). Përveç përkrahjes për OShC-të që jepet nën këtë RN, RN-të tjera të OZh1 përkrahin OShC-të në aspektin e kërkesave nëpërmjet nismave të *USAID Forward*.

Një komponent kyç i **Nën-RN1.4.1 (Ngritja e Vetëdijes Qytetare dhe Aftësisë së Shoqërisë Civile për të Avokuar dhe Monitoruar)** do të fokusohet në përforcimin e kapacitetit për avokim dhe mbikëqyrje, për dalje në terren dhe takim me komunitetet dhe për ndërtim të vetëdijes së tyre me qëllim të përkrahjes së reformave. Në vend të shfrytëzimit të qasjes në ndërtim të kapacitetit, USAID-i do ta fokusojë asistencën te OShC-të të cilat janë më relevante me institucionet me të cilat punojnë, dhe ato mbulojnë temat me prioritet të lartë, nëpërmjet portofolit për Demokraci dhe Qeverisje si dhe Rritje Ekonomike.

**Nën-RN1.4.2 (Rritja e Përfaqësimit të Grave, të të Rinjve dhe Grupeve tjera të Rrezikuara)** do të shënjestrojë veçanërisht këto grupe të cilat shpeshherë janë të marginalizuara dhe janë jashtë strukturave të pushtetit në Kosovë. Do të bëhen përpjekje për të siguruar përfaqësimin më të mirë në sferën publike të çështjeve të cilat kanë ndikim te këto grupe, përfshirë përfaqësimin e tyre brenda partive politike dhe institucioneve qeveritare, dhe natyrisht brenda organizatave të shoqërisë civile të cilat mund të avokojnë më zëshëm në emër të vet. Edhe pse është fokus i këtij nën-RN-je, d.m.th. përforcimi i këtyre grupeve, kjo gjithashtu është temë e gërshetuar që përkrahet nga i tërë portofoli, në veçanti nga RN3.1 pasi që ai ka të bëjë me rininë (*Përmirësimi i Arsimit Parauniversitar*).

## OZh1: NISMAT E GËRSHETUARA

Prioritetet e **USAID FORWARD** do të përkrahen nga OZh1 me theks të veçantë në diversifikimin e bazës së partnerëve zbatues, në përforcimin e zbatimit nëpërmes organizatave lokale dhe në shfrytëzimin e sistemeve të Qeverisë së Kosovës në masë më të madhe. Ky theks i ripërtëritur do të përkrahë drejtpërdrejtë Objektivin numër 1 të *USAID Forward* për zbatim të reformave në prokurim (përforcimi i kapacitetit të shtetit partner në përmirësimin e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së ndihmave) dhe me Objektivin numër 2 (përforcimi i shoqërisë civile lokale dhe i kapacitetit të sektorit privat me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të ndihmave). USAID-i do të fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve lokale duke bashkëpunuar me subjektet lokale në zbatimin e projekteve të financuara nga USAID-i, dhe gjithashtu nëpërmes shfrytëzimit të përvojës vendore në hulumtim dhe zhvillim të politikave. Këto përpjekje do të përmirësojnë mjedisin e favorshëm, do të ofrojnë ndërtim të kapacitetit për OJQ-të dhe shoqatat, dhe do të përforcjnë subjektet qeveritare siç janë komunat, Kuvendi i Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Komisioni Qendror Zgjedhor. Do të aplikohet inovacioni dhe nismat në teknologji kurdoherë që është e mundur për gjatë portofolit të OZh1.

**FUQIZIMI I GRAVE** është adresuar në nivele të shumta dhe është raportuar nga studimi i fundit për çështjet gjinore i kryer nga USAID-i<sup>34</sup>. Programet e sundimit të ligjit do të fokusohen në zbatimin e ligjeve dhe të rregulloreve që lidhen me barazinë gjinore. USAID-i do të punojë me OShC-të e udhëhequra nga gratë në monitorimin e çështjeve me rëndësi të veçantë për gratë, siç janë shkurorëzimi

<sup>34</sup>Cozzarelli, Catherine, 2012 *Vlerësimi shtetëror i çështjeve gjinore për USAID/Kosovë*, gusht, 2012.




dhe trashëgimia. Ky OZh do të fokusohet në përmirësimin e zbatimit të ligjeve për të drejtat pronësore të cilat pengojnë gratë në trashëgimi apo në marrjen e pronave në të cilat gëzojnë të drejtë. Kuotat në kuvendet komunale dhe në Kuvendin e Kosovës kërkojnë që 30% e deputetëve të jenë nga radhët e grave, prandaj USAID-i do të ndërtojë aftësitë e këtyre grave që të funksionojnë në mënyrë më efektive. USAID-i do të vazhdojë fokusin edhe në përkrahjen e grupeve të grave të cilat funksionojnë me pjesëmarrje të grave nga të gjitha kombësitë që kanë për qëllim trajtimin e çështjeve të grave. Përkrahja e grupeve të grave në nivel komunal do të përfshijë shfrytëzimin e grupit ekzistues të grave deputete të Kuvendit të Kosovës si model. Aktivitetet do të përkrahin edhe rritjen e numrit të grave në partitë politike dhe në organizatat e shoqërisë civile, inkurajimin e përfshirjes më të madhe politike dhe me fokus të veçantë te gratë rurale, të reja dhe nga komunitetet pakicë (të cilat janë më të marginalizuarat).

Faza e përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur në Kosovë paraqet një mundësi të mirë për **ZHVILLIM TË KAPACITETIT NJERËZOR DHE INSTITUCIONAL (HICD)**. Aktivitetet nën këtë OZh do të përkrahin përfundimin e liderimit teknik dhe të kapacitetit njerëzor në sektorët e synuar teknik dhe të qeverisjes siç janë administratat publike dhe të sundimit të ligjit në bashkëpunim të ngushtë me objektivat tjera të misionit për HICD. Sa i përket ndërtimit të kapacitetit të administratës publike, Misioni do të përkrahë drejtpërdrejtë organizatat lokale të cilat ofrojnë trajnim të këtillë. Instituti Gjyqësor i Kosovës përbën homologun kryesor të trajnimit në sektorin e drejtësisë (d.m.th. i trajnon gjyqtarët, prokurorët dhe personelin e gjykatave). Programi i detyrueshëm për arsimin e vazhdueshëm ligjor dhe klinikat juridike të fakultetit juridik do të pranojnë asistencë të kufizuar që fokusohet në përfundimin e aftësive ligjore praktike.

**ANTI-KORRUPSIONI** adresohet në mënyrë të shumëfishtë. Së pari, programi për të adresuar zhvillimin e kapacitetit njerëzor e institucional do të përfshijë vëmendjen ndaj etikës dhe sistemeve e proceseve të mira të menaxhimit me qëllim të reduktimit të korrupsionit. Së dyti, asistencë do të përkrahë e-qeverisjen, ngritjen e transparencës brenda gjykatave, pushteteve lokale dhe institucioneve tjera. Së treti, shtimi i përpjekjeve në vetëdijësim do të përfshijë theksin te qytetarët dhe OShC-të që kryejnë mbikëqyrje efektive të aktiviteteve të ashtuquajtura të kërkimit të qirasë (manipulimit). Asistencë për të përfunduar sistemin transparent dhe të shëndoshë të menaxhimit financiar do të përkrahë nismën *USAID Forward G2G* dhe nismat për zhvillimin e kapacitetit lokal.

USAID-i do të vazhdojë të përkrahë kapacitetin e OShC-ve dhe të partive politike për t'u shtrirë te rinia dhe për ta përfaqësuar më mirë rininë dhe çështjet e tyre specifike, me theks të veçantë në programet e edukimit qytetar dhe në mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve komunale. Në Kuvendin e Kosovës, USAID-i do të vazhdojë përkrahjen e trajnimit dhe ndërtimit të kapacitetit të grupit të të rinjve.

Mënyra se si USAID-i do të përkrahë **INTEGRIMIN E PAKICAVE** nëpërmjet OZh1 është përshkruar në RN1.3 (*Përmirësimi i integritetit të pakicave etnike*). Thënë shkurt, përpjekjet për integrimin e pakicave do të përfshijnë programet për dhënie të bursave, asistencë për bizneset fillestare dhe për sport. Natyrisht se kjo është çështje e gërshtuar prandaj duhet dhe do të adresohet (dhe koordinohet) përgjatë tërë portofolit të Misionit, çdo herë e më shumë me hapjen e mundësive në veri.



## C. Objektivi Zhvillimor 2

### *Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat*

Objektivi zhvillimor 2 i cili fokusohet në diversifikimin e ekonomisë dhe në rritjen e kontributeve të sektorit privat në rritjen ekonomike, përvijohet me tri parimet thelbësore të politikës së Agjencisë për rritjen ekonomike si vijon: a) programet duhet të synojnë ndikim më të madh dhe sistemik (siç janë përpjekjet e RN2.1 dhe RN2.3 për reforma ligjore dhe politike); b) kur nuk arrihen reformat sistemike, kërkohet arritja e ndikimit katalizator (i ilustruar në qasjen gjithëpërfshirëse të RN2.2); dhe c) vëmendje e afërt për politikatat e ndryshimit ekonomik të cilat janë të rëndësishme për rezultatet (RN2.3). Tutje, ky OZh përkrahë dy qasjet e para nga tri sa janë rekomanduar për rritjen me bazë të gjerë, që përfshinë gratë, pakicat dhe popullsinë tjetër të pambuluar me shërbime: a) zhvillimi i tregjeve që funksionojnë mirë, dhe b) rritja e qasjes në mundësitë produktive për të varfërit, gratë dhe grupet tjera të personave pafavorizuar<sup>35</sup>.

<sup>35</sup> USAID, Sigurojmë të ardhmen: Strategji për rritjen ekonomike, prill 2008.

Në punën me institucionet kryesore qeveritare rreth ndërtimit të mjedisit më të fuqishëm të favorshëm për bizneset që orientohet kah zhvillimi, ashtu që sektori privat të bëhet më konkurrues dhe i orientuar kah tregu, USAID-i do të aplikojë aspektet kryesore të këtyre qasjeve dhe parimeve.

### Supozimet Kyçe dhe Rreziqet për OZh2

Arritja e këtij objektivit zhvillimor do të varet nga ajo nëse Qeveria e Kosovës do të ruajë stabilitetin financiar dhe politik. Në të vërtetë USAID-i beson se qeveria zotohet për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale. Qeveria e Kosovës ka kryer vlerësimet e ndikimit fiskal, ka punuar brenda kufizimeve buxhetore dhe ka inkorporuar kriteret e stimulimeve ekonomike në vendimmarrje<sup>36</sup>, dhe ky OZh do të përkrahë vazhdimin e stabilitetit financiar. Sigurimi i stabilitetit politik natyrisht se ndërlidhet ngushtë me stabilitetin financiar. 47% e qytetarëve të anketuar në studimin e fundit radhitën papunësinë si problemin parësor brenda vendit<sup>37</sup>, ashtu që mundësia për rritje ekonomike dhe krijim të punësimit gjithashtu do të adresojë një prioritet të rëndësishëm politik. Me qëllim të arritjes së stabilitetit afatgjatë, vullneti për reforma në mesin e vendimmarrësve mbetet i fuqishëm.

### Donatorët Tjerë

Aktivitetet nën OZh2 do të koordinohen ngushtë me projektet dhe aktivitetet tjera donatore të cilat kanë objektiva dhe interesa plotësuese të cilat lehtësojnë arritjen e këtij OZh-je dhe të qëllimit strategjik. Me rëndësi të veçantë do të jetë koordinimi me projektet e Bankës Botërore dhe të Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar (IFC) të cilat synojnë përmirësimin dhe modernizimin e sektorit publik të Kosovës, përmirësimin e menaxhimit financiar në ministritë e linjës, dhe me aktivitetet tjera të cilat synojnë përmirësimin e mjedisit afarist në Kosovë, në veçanti në tregti. Do të synohet koordinimi dhe bashkëpunimi me FMN-në me qëllim të ruajtjes së stabilitetit fiskal dhe përfundimit të institucioneve dhe sistemeve të cilat krijojnë të hyra. Koordinimi me Zyrën e Bashkimit Evropian (ish-Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë [ZNKE]) do të fokusohet në prokurimin publik, tregtinë dhe doganat, kurse sa i përket kornizës ligjore, do të fokusohet në pajtueshmërinë me direktivat e BE-së. Koordinimi me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) pritet të përmirësojë dukshëm sistemin e tatimeve në pronë dhe të zgjerojë bazën tatimore. Përveç kësaj, në lidhje me konkurrueshmërinë me sektorin privat, USAID-i do të vazhdojë të koordinojë ngushtë me një numër të donatorëve të interesuar ndërkombëtarë, akterë dhe institucione multilaterale, në veçanti me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), UNDP-në, Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), GIZ (Organizatën Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar, ish-GTZ), Institutin për Kredi për Rindërtim (KfW, *Kreditanstalt für Wiederaufbau*) dhe me Bashkimin Evropian. BERZh dhe SDC në veçanti i janë afruar USAID-it në lidhje me bashkëpunimin në aktivitetet të cilat adresojnë konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e fuqisë punëtore.

Në lidhje me RN2.3 (*Përmirësimi i Menaxhimit të Resurseve Natyrore në Fushat Kryesore*), Banka Botërore ka identifikuar disa fusha të përkrahjes në vitet e ardhshme, siç janë: pastrimi dhe bonifikimi i tokave nga sektori i energjisë, përkrahja me kredi për efikasitet në energji dhe energji nga burimet e ripërtërishme, dhe projektet për ujësjellës. Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë do të përfshihet në ujësjellës/trajtim të ujërave, menaxhim të mbeturinave, monitorim të cilësisë së ajrit anekënd shtetit (do të thotë nuk është specifik për ndonjë termocentral), efikasitet të energjisë, çaktivizim të termocentralit Kosova A, dhe reforma institucionale të menaxhimit pyjor. KfW do të vazhdojë përfshirjen në përkrahje të operatorit për transmetim të energjisë, në veçanti në lidhje me linjën e planifikuar 400 kV me Shqipërinë. Përgjatë periudhës së SBZhV-së, këta donatorë tjerë ende nuk kanë treguar interesim në ndonjë qasje gjithëpërfshirëse në përkrahjen e zhvillimit të sektorit për menaxhim të resurseve natyrore në përgjithësi, dhe në veçanti të mineraleve energjetike dhe jo-energjetike, që synon furnizim të qëndrueshëm dhe financiarisht të pranueshëm me energji elektrike në Kosovë. Kjo rrjedh pjesërisht si

<sup>36</sup> Banka Botërore, Strategji shtetërore për partneritet, maj 2012.

<sup>37</sup> UNDP dhe USAID, Raporti *Pulsi Publik*, 5 shkurt 2013.

rezultat i vëmendjes më të fokusuar në projektet specifike, e jo në qasjen për reforma sistemike të cilat propozohen nga USAID-i, me qëllim që të rrënjosen praktikat më të mira në këta sektorë para se ata të zhvillohen (dhe kështu praktikat e këqija të mos zënë vend). Natyrisht se USAID-i mbetet i zotuar në punën me të gjithë akterët për të siguruar harmonizim në shtegun e tij drejt arritjes së OZh-së në fjalë.

### **Cilat janë Dallimet në Krahasim me Portofolin e Tashëm?**

Kjo strategji do të fokusohet në konsolidimin e investimeve të mëhershme dhe në zbatimin efikas të reformave. Si qasje e gërshetuar në tërë Misionin, do të ketë fokus më të madh në adresimin e pabarazive në mes të grave dhe burrave dhe në shtrirjen te grupet e pambuluara me shërbime. Do të ketë më pak fokus në bizneset fillestare të nivelit mikro, përveç ndoshta ato të pakicave, grave dhe rinjve, dhe asistencë të përgjithësuar që nuk ka të bëjë vetëm me një sektor, me theks më të madh korrespondues në inkurajimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilat mund të rriten dhe të krijojnë vende pune. (Ka edhe donatorë tjerë të përfshirë në bizneset fillestare siç është Qendra për Inovacione e financuar nga Norvegjezët dhe Fondacioni Syri që është krijuar nga diaspora e kthyer). Duke ruajtur rolin udhëheqës në nismat energjetike, USAID-i do të zgjerojë fokusin për të përfshirë menaxhim më efikas të burimeve natyrore për resurset e zgjedhura.

Qasja e USAID-it për rritje ekonomike është fokusuar në përkrahjen e blloqeve themelore ndërtimore të Kosovës së pavarur. Agjencia ka qenë donatori kryesor i cili ka ndihmuar në vendosjen e institucioneve kryesore, ligjeve dhe rregulloreve dhe në vendosjen e sistemit të shëndoshë fiskal dhe financiar, dhe kështu është arritur progres i madh në ndërtimin e kapacitetit të institucioneve siç është Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) dhe Agjencioni për Privatizim i Kosovës (APK). Këto tani funksionojnë në nivel profesional dhe kanë nevojë shumë të kufizuar për përkrahje të vazhdueshme donatore.

Në portofolin e mëhershëm, USAID-i në Kosovë kishte një program të fuqishëm për politikat ekonomike, menaxhim të financave publike dhe administratë tatimore. Duke ditur kapacitetin e fuqishëm të ndërtuar nëpërmjet asistencës nga Qeveria e ShBA-së brenda Ministrisë së Financave dhe Administratës Tatimore të Kosovës, asistencë e ardhshme do të ngushtohet dukshëm dhe do të koncentrohet në menaxhimin e financave publike dhe në decentralizim, përfshirë menaxhimin financiar në nivel komunal. Do të ketë koncentrim më të madh në krijimin e ndikimit katalizator nëpërmjet ndihmës për tërë zinxhirin e vlerave për të arritur nivelin e ardhshëm të produktivitetit. Këto përpjekje do të fokusohen në veçanti në angazhimin e grave, pakicave dhe të popullsisë së përjashtuar (nga kornizat shoqërore).

Sa i përket gjërave që USAID-i *nuk* do t'i bëjë gjatë kësaj periudhe të strategjisë në kuptim të investimeve dhe rritjes së sektorit privat, nënvizojmë të mëposhtmet: a) natyrisht se USAID-i nuk do të angazhohet drejtpërdrejtë në ato aktivitete të cilat udhëhiqen nga donatorët tjerë (shih seksionin e sipërm), edhe pse Agjencia do të luajë rol koordinues, në veçanti në sektorin e energjisë; b) nuk do të ofrohet përkrahje e drejtpërdrejtë operacionale për Sistemin e Privatizuar të Distribucionit të Energjisë (KEDS), përveç si asistencë të nevojshme për subjektet e Qeverisë së Kosovës në mbikëqyrjen e kësaj kontrata madhore, dhe c) në kontekst të përkrahjes për menaxhimin e përmirësuar të resurseve natyrore, ku është me rëndësi të thuhet se përfshirja e USAID-it në pylltari do të bëhet vetëm nëpërmjet sektorit privat për të siguruar pajtueshmërinë me kornizën rregullative tanimë të fuqishme, pasi që donatorët tjerë po ofrojnë përkrahje të rëndësishme. Nuk do të ofrohet asistencë për zhvillimin e eksportit të thëngjillit.

### **Rezultatet e Ndërmjetme**

**RN2.1: Përmirësimi i Qeverisjes Ekonomike dhe i Mjedisit Afarist.** Duke marrë parasysh atë çka u tha më sipër se institucionet kryesore tani mund të funksionojnë pa përkrahje të mëtejme donatore, USAID-i do të fokusohet në mënyrë më të drejtpërdrejtë gjatë kësaj periudhe të strategjisë në përforsimin e mjedisit të favorshëm afarist për sektorin privat. Rritja maksimale ekonomike dhe prosperiteti kërkon që

ndërmarrjet të operojnë brenda kornizës ligjore të qartë me pengesa minimale. Në bashkërendim me Qeverinë, sektorin privat dhe donatorët partnerë, USAID-i do të koncentrohet në promovimin e reformave të tregut të lirë dhe largimin e barrierave ndaj krijimit dhe operimit të bizneseve.

Ky RN do të përkrahë drejtpërdrejtë arritjen e tri nga pesë prioritetet për zhvillim ekonomik të Qeverisë së Kosovës të cilat janë paraqitur në *Vizionin dhe planin e veprimit për zhvillimin ekonomik (VPVZhE)*: a) ruajtja e stabilitetit makro-ekonomik; b) krijimi i një mjedisi më të fuqishëm afarist të fokusuar në rritjen e investimeve dhe përkrahjen e sektorit privat, dhe c) zhvillimi infrastrukturës publike<sup>38</sup>. Pritet që homologë kryesor të jenë Zyra e Kryeministrit, Ministria e Tregtisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave (përfshirë Administratën Tatimore dhe Doganat), komunat, organizatat e ndryshme të sektorit privat, shoqatat dhe institucionet hulumtuese. Tutje, aktivitetet që duhet të zbatohen nën këtë RN do të përfitojnë nga avokimi që bëhet nga Departamenti i Shtetit për politika më të mira ekonomike dhe asistencë teknike nga Departamenti i Thesarit të ShBA-së në tregjet financiare, reforma në sigurime dhe politikat për vendbanime. Trajnimi i ofruar nga Programi për zhvillimin e të drejtës komerciale, nga Departamenti i Tregtisë së ShBA-së, do të plotësojë përpjekjet e USAID-it në përmbartim të kontratave dhe lehtësim të tregtisë. Në fund, ekziston lidhje e rëndësishme në mes të këtij RN dhe nën-RN1.2.1 (*Kuvendet dhe administratat komunale dhe qendrore më përgjegjëse*) në përmirësimin e sistemeve dhe proceseve të cilat mbështesin administratën e mirë publike dhe do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në synimet afariste.

Duke u lidhur me hipotezën zhvillimore se qeveritë mund të krijojnë mjedis pozitiv për rritje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme (shih seksionin 2, Hipotezat Zhvillimore), ndikimi i synuar i RN-së në fjalë është përmirësimi i mjedisit afarist të Kosovës, që pasqyrohet në punën e përditshme të bizneseve dhe tregohet edhe nga hulumtimet ndërkombëtare, p.sh. *Indeksi i të Bërit Biznes* i Bankës Botërore. Ky RN në mes tjerash do të ndihmojë në vendosjen e: a) një sistemi modern mos-pengues i cili kufizon veprimet rregullative vetëm brenda shqetësimeve legjitime të sigurisë dhe shëndetit publik; b) një sistemi të inspektimeve që shfrytëzon qasjen e bazuar në rrezik me theks në sigurimin e pajtueshmërisë, e jo në shqiptimin e sanksioneve; c) një lidhjeje efikase të regjistrimit të bizneseve në mes të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës (përfshirë edhe eliminimin e lejeve të biznesit në komunat të cilat ende lëshojnë leje të tilla me pagesë); d) një mekanizmi të thjeshtëzuar të regjistrimit të pronave; e) përmirësimi i menaxhimit të financave publike në nivel komunal dhe qendror; dhe me rëndësi të veçantë, f) aftësia e qëndrueshme për të menaxhuar me sukses tensionet në ekonomi të cilat rezultojnë nga çfarëdo tronditje financiare e jashtme apo nga çekuilibrimet strukture/makro-ekonomike.

**Nën-RN2.1.1 (*Përmirësimi i Kornizës Fiskale dhe i Menaxhimit të Financave Publike*)** do të ndërtojë kapacitetin e institucioneve kryesore në zbatimin e politikave të mira dhe në menaxhimin financiar në nivel komunal dhe atë qendror. USAID-i do të punojë me institucionet e synuara, kryesisht me komunat dhe me Ministrinë e Financave, për të vazhduar me zhvillimin e një kornize efikase institucionale dhe politike në përkrahje të rritjes së sektorit privat. Partneritetet publiko-private (PPP) do të promovohen për infrastrukturë dhe shërbime tjera publike (siç janë menaxhimi me mbeturina, shërbime të transportit urban dhe parking publik) jo vetëm për të siguruar më shumë hapësirë për zgjerim të biznesit privat por edhe për të zbutur presionin ndaj buxhetit publik.

**Nën-RN2.1.2 (*Zbatimi i Reformave Kryesore Ekonomike në Nivel Qendror dhe Lokal*)** do të zgjerojë përparësitë e krijuara në mjedisin e favorshëm afarist. Kjo do të përfshijë promovimin e reformave kryesore të të bërit biznes siç janë largimi i pengesave të panevojshme qeveritare ndaj aktivitetit

<sup>38</sup> Qeveria e Kosovës, Vizioni dhe plani i veprimit për zhvillim ekonomik (VPVZhE), prill 2011.



ekonomik, eliminimi i kërkesave të shumta për leje dhe licenca, dhe zhvillimi i sistemit modern të inspektimit.

**RN2.2: Rritja e Konkurrueshmërisë dhe Zgjerimi i Lidhjeve Tregtare në Fushat e Synuara të Sektorit Privat.** Duke kapitalizuar përparësitë e mirënjohura krahasuese të USAID-it në këtë sektor, ky RN do të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat në fushat e synuara me potencial të lartë për rritje nëpërmjet përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të firmave lokale, duke përmirësuar lidhjet tregtare, duke harmonizuar kualifikimet e fuqisë punëtore me nevojat e sektorit privat dhe duke përmirësuar qasjen në financa që janë të nevojshme për rritjen e biznesit. Duke ditur madhësinë e problemit me papunësi në Kosovë, fokusimi në krijimin e vendeve të punës është çështje thelbësore. Me këtë nënkuptojmë përmirësimin e konkurrueshmërisë brenda sektorëve kryesorë të cilët do të funksionojnë si shtytës të ekonomisë dhe do të krijojnë punësim, duke shënjestruar fushat në të cilat mund të angazhohen gratë dhe të rinjtë. Aktivitetet do të ndihmojnë bizneset që të shfrytëzojnë përparësinë e reformave të vendosura nën RN2.1 (*Përmirësimi i Qeverisjes Ekonomike dhe i Mjedisit Afarist*) dhe natyrisht se ekzistojnë lidhjet e qarta këtu me OZh3 (*Forcimi i Kapitalit Njerëzor*).

Ky RN do të përkrahë një nga pesë prioritetet ekonomike zhvillimore, do të thotë investimet, mjedisin investiv dhe përkrahjen për sektorin privat<sup>39</sup>. Homologë kryesorë pritet të jenë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përfshirë Agjencinë për NVM, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Amerikane e Kosovës dhe organizatat afariste, siç janë Qendra për Përkrahje të Biznesit të Kosovës, Shoqatat e Përpunuesve të Drurit të Kosovës, Fondi për Zhvillim të Komunitetit dhe Oda Ekonomike e Grave. Seksioni ekonomik i Ambasadës është partneri kryesor në identifikimin e mundësive afariste dhe për krijimin e lidhjeve në mes të kompanive amerikane dhe kosovare. Përderisa USAID-i do të vazhdojë marrëdhënien e vet me këto subjekte, Seksioni Ekonomik ka përfaqësim të veçantë nga Bordin e Odës Ekonomike Amerikane dhe ka lidhje të forta me Odën Ekonomike të Kosovës.

Ky RN bazohet në hipotezën e paraqitur më sipër (shih seksionin 2. Hipotezat Zhvillimore) se përmirësimi i konkurrueshmërisë së tërë zinxhirit të vlerave do të çojë në rritje transformuese. Përvoja e mëhershme tregon se qasja e integruar dhe multi-dimensionale, e tillë që përqendrohet në përmirësimin e nevojave të vërteta të bizneseve dhe që mund të shtrihet te industria masive/sektorët e industrisë, nxitë rezultate më të shpejta ekonomike. Asistenca do të fokusohet më shumë në këtë qasje të gjerë sesa në mundësi tjera më të vogla individuale. Pritet që kjo qasje të rezultojë në rritje të mundësive për punësim, por edhe për zëvendësim të importeve dhe rritje të eksporteve, përderisa ndihmon edhe në integrimin e mëtejshëm rajonal dhe evropian. Këta sektorë do të përfshijnë vazhdimin e promovimit të bujqësisë së qëndrueshme ashtu që Kosova të përmirësojë më mirë nevojat për konsum përmes prodhimitarëve vendore, e jo përmes importeve, të krijojnë vende pune në viset rurale, dhe të zhvillojë kultura bimore me vlerë të lartë me potencial për eksport. Aktivitetet do të përforcojnë kapacitetin e institucioneve lokale financiare në identifikimin e mundësive të mira për investime dhe do të shtojnë diversitetin e instrumenteve kreditore dhe asistencën financiare që nxitë rritjen e ndërmarrjeve. Aktivitetet do të adresojnë nevojën e grave, pakicave dhe grupeve tjera të përjashtuara nëpërmes përmirësimit të qasjes në financa dhe në asistencë financiare të përshtatur në veçanti për nevojat e tyre. Të gjitha aktivitetet do të dizajnohen për të përmirësuar Kërkesat e FAA (Ligji për Asistencë të Jashtme), Neni 119 Konservimi i Biodiversitetit<sup>40</sup>.

**Nën-RN2.2.1 (NVM-të më të Qëndrueshme dhe që i Përgjigjen më Mirë Tregut)** do t'i ndihmojë sektorëve dhe bizneseve kosovare me mundësi të mira tregtare nëpërmjet nismave të cilat u ndihmojnë në rritjen e shitjeve, eksporteve dhe punësimit, në joshjen e investimeve të huaja direkte, dhe në përvijimin e produkteve me standardet evropiane. Kjo do t'i kontribuojë konkurrueshmërisë, përshtetimit të krijimit të

<sup>39</sup> Ibid.

<sup>40</sup> USAID Kosovë: FAA, neni 119, Analizë e biodiversitetit, Pjesa e dytë: Përmirësimi i nevojave për konservim të biodiversitetit në vitet 2013-2018, tetor 2012.

punësimin dhe rritjes së shitjeve të ndërmarrjeve nëpërmjet shtimit të financimit dhe investimeve, së bashku me shfaqjen e grupeve të forta industriale. Një kontribut madhor është punësimi, prandaj USAID-i do të punojë me qendrat lokale të arsimit profesional, kompanitë, OJQ-të dhe subjektet tjera për të zhvilluar aftësitë e fuqisë punëtore në sektorët e shënjestruar. Kjo punë do të përfshijë bursat dhe punën si praktikantë, programet e trajnimit në sektorët e ndërlidhur dhe aktivitetet tjera për ngritje të kualifikimeve me qëllim të përmirësimit të mundësive për punësim, në koordinim me OZh3 (*Të Forcohet Kapitali Njerëzor*).

**Nën-RN2.2.2 (Rritja e Prodhimtarisë Bujqësore dhe e Mundësive për të Bërë Tregti)** do të përshpejtojë rritjen ekonomike nëpërmjet zgjerimit të prodhimtarisë së qëndrueshme nga aspekti mjedisor, si dhe shitjeve të produkteve bujqësore me vlerë të shtuar duke i mundësuar prodhuesve dhe përpunuesve që të konkurrojnë në tregje rajonale dhe botërore. Kjo do të arrihet duke i krijuar lidhjet në mes të produkteve e fermerëve dhe tregjeve, duke diversifikuar dhe shtuar prodhimtarinë bujqësore, duke përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, duke lehtësuar qasjen në kredi dhe duke përmirësuar koordinimin dhe komercializimin brenda sektorit të bujqësisë. Duke ditur përqindjen e madhe e popullsisë (60%) që jeton në viset rurale, këtij sektori do t'i garantohet vëmendje e veçantë.

**Nën-RN2.2.3 (Përmirësimi i Qasjes në Financa)** do të adresojë dobësitë e sektorit financiar. Sektori financiar në Kosovë ofron gamë të kufizuar të produkteve për klientët. Normat e kamatës dhe kërkesat për kolateral janë më të larta sesa në shtetet fqinje, gjë që vë firmat vendore në situatë të pafavorshme të konkurrencës. Ekziston mungesa e instrumenteve financiare në dispozicion, siç janë lizingu dhe financimi nëpërmjet mandatit për blerje. Ekziston nevoja për të adresuar kërkesat financiare të huamarrësve të pranueshëm, por të cilët duken si të rrezikshëm, d.m.th. ndërmarrësve, fermerëve, përpunuesve dhe grave e pakicave me më pak përvojë, me madhësi të vogël dhe pa kolateral në asete fikse. Duke vazhduar suksesin në shfrytëzimin e dobishëm të Autoritetit për Kredi Zhvillimore, që u theksua më sipër, USAID-i do të vazhdojë të identifikojë mundësitë tjera me qëllim të ndërtimit të kapacitetit permanent vendor dhe të ndihmojë në gjetjen e opsioneve të reja për financim dhe për garanci të kredive, gjë që siguron stimulime shtesë për sektorin bankar në kredidhënie për sektorin privat. Tutje, USAID-i do të ofrojë asistencë teknike nëpërmjet partnerëve vendorë si ndihmë për bizneset private që të marrin kredi më me lehtësi.

**RN2.3: Përmirësimi i Menaxhimit të Resurseve Natyrore në Fushat Kryesore:** Kosova ka mungesë të madhe të energjisë, që është problem madhor ekonomik i cili duhet të adresohet po që se shteti dëshiron të shënojë progres ekonomik. Njëkohësisht zhvillimi i përgjithshëm i resurseve natyrore paraqet mundësi të madhe ekonomike për Kosovën e pasur me resurse. Furnizimi stabil me energji natyrisht se paraqet një faktor të rëndësishëm për bizneset, dhe kështu mbështetë edhe RN2.2 (*Ngritja e konkurrueshmërisë dhe e lidhjeve tregtare në fushat e shënjestruara të sektorit privat*). Menaxhimi më i mirë i taksave dhe të hyrave të krijuara nga ky sektor do të mbështesë menaxhimin financiar në përkrahje të RN2.1 (*Përmirësimi i qeverisjes ekonomike dhe i mjedisit afarist*). Nëpërmjet këtij RN-je, dhe duke përmblusur synimin e përgjithshëm të FAA 119 Biodiversiteti, USAID-i do të ndihmojë zhvillimin e qëndrueshëm për sektorët e përzgjedhur të resurseve natyrore duke punuar në përmirësimin e kornizave ligjore, politike dhe rregullative që do të adresojë pajtueshmërinë me normat e pranueshme ndërkombëtarisht në lidhje me ndotjen dhe aspektet mjedisore, p.sh. shqetësimet me ndryshimet klimatike. Ky RN do të fokusohet në përmirësimin e mjedisit të favorshëm për investime në energji të ripërtërishme dhe eficientë në energji, me asistencë rregullative, legjislativë dhe në politika me qëllim të vendosjes së themelit për sistemet me nivel të ulët të karbonit.

Aktivitetet nën këtë RN natyrisht se do të përfitojnë nga marrëdhëniet shumë pozitive që ka USAID-i me Qeverinë e Kosovës. Marrëdhënia e USAID-it me homologët vendorë mbështetë edhe nga angazhimi i Ambasadës në diskutimet e rëndësishme të politikave energjetike, përderisa USAID-i e koordinon punën e vet pothuajse në bazë të përditshme me Seksionin Politik dhe Ekonomik dhe me asistencën teknike të

Departamenti Amerikan të Thesarit. Departamenti i Thesarit në Uashington gjithashtu përcjellë me vëmendje sektorin energjetik të Kosovës për shkak të implikimeve shumë të mëdha financiare. USAID-i koordinon dhe përfiton nga këshillat eksperte nga Departamenti i Punëve të Brendshme, Asociacioni për Energji i Shteteve të Bashkuara (USEA), dhe Shoqata Kombëtare e Komisionarëve Rregullator për Shërbime Komunale (NARUC). Këto marrëdhënie të punës do të vazhdojnë gjatë periudhës së Strategjisë.

Gjithashtu duke u ndërlidhur (si RN2.1) me hipotezën zhvillimore se qeveritë mund të krijojnë një mjedis pozitiv për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ky RN paraqet hapin e radhës të asistencës pas suksesit të dukshëm në sektorin energjetik. Përkrahja e USAID-it (në pajtueshmëri me FAA 119 Biodiversiteti) ka ndihmuar në rritjen e kapaciteteve të Qeverisë për të monitoruar ndotjen (pajisje dhe trajnim në mbledhjen dhe analizën e të dhënave për monitorim të ajrit në Institutin Hidrometeorologjik). Përmirësimi i faturimit dhe arkëtimit të shpenzimeve të rrymës, gjithashtu nëpërmjet përkrahjes nga USAID-i, nënkupton që korporata energjetike shtetërore do të mbledhë më shumë të hyra për investim në filtrat e ri elektrostatik për bllokun Kosova B, që përmirëson dukshëm cilësinë e ajrit. Dhe çka është me rëndësi, ky sektor pret privatizimin e suksesshëm të distribucionit – KEDS. Me këtë sukses, nuk do të ketë më nevojë për kontratat menaxhuese të përkrahura nga Qeveria e ShBA-së si asistencë të drejtpërdrejtë operacionale për KEDS-in. (Në të vërtetë pjesërisht si rezultat i kësaj arritjeje të pritur, USAID-i në Kosovë ka reduktuar buxhetin e vet në këtë fushë).

Fokusi i USAID-it në kornizat ligjore, rregullative dhe në politika do të përfshijë jo vetëm vëmendjen në sektorin energjetik, por edhe të mineralet jo-energjetike dhe në burime ujore. Angazhimi në këtë lloj të politikave dhe në punë rregullative është me rëndësi të madhe në këtë moment kur Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) po fillon të përgatisë përditësimin e Strategjisë Mjedisore të Kosovës (SMK) dhe të Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin (PKVM) në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë tjera, OJQ-të dhe donatorët. Duke marrë parasysh këtë burim të rëndësishëm natyror të Kosovës, dhe potencialin për "vrull në mihje të arit" apo eksploatim të parregulluar, kjo është periudhë kohore me mjaft mundësi për USAID-in që të shfrytëzojë ndikimin dhe ekspertizën e vet në nivel më të gjerë. USAID-i kupton se ka interesa në sektorin privat dhe në investimet e mundshme në energji, të cilat janë konfirmuar në raportimin nga Departamenti i Shtetit. Në kuptim të ndikimit ekonomik, eksportet vjetore të Kosovës nga industria minerale mund të arrijnë 300-500 miliona € (\$420-700 miliona), kurse industria e minierave do të krijonte mbi 7,000 vende pune të drejtpërdrejta dhe 14,000-21,000 vende pune indirekte<sup>41</sup>.

Duhet të ceket se USAID-i në Kosovë nuk pret përfshirje të madhe në sektorin e pylltarisë nën RN2.3 për disa arsye. Së pari, pylltaria tanimë ka kornizë të fuqishme ligjore dhe sukses të dukshëm, siç është kodë i mirësjelljes, standardet dhe procedurat ndërkombëtarisht të njohura për prerje të qëndrueshme dhe të certifikuar të drurit. Së dyti, ekzistojnë edhe donatorë tjerë të respektuar të cilët e udhëheqin punën në këtë sektor. Për shembull Qeveria Suedeze është e angazhuar mjaft shumë dhe bashkë-kryeson grupin koordinues të donatorëve në sektorin e pylltarisë, së bashku me Qeverinë e Kosovës. Edhe Qeveria Norvegjeze ka projekte në këtë sektor. Çështja më e madhe në pylltari është përmbartimi/zbatimi dhe shtytësi më i madh është shfrytëzimi i drurit për ngrohje, si rezultat i furnizimit të paqëndrueshëm me energji. Duke e pasur parasysh këtë fakt, angazhimi i USAID-it në pylltari do të bëhet nëpërmjet sektorit privat (që diskutohet nën RN2.2) që synon të sigurojë se bizneset në industrinë e përpunimit të drurit i shfrytëzojnë praktikën që janë në pajtueshmëri me procesin e certifikimit dhe me ligjet e rregulloret tjera. Kosova varet nga konsumi i biomasës si karburant druri me qëllim të përmbushjes së synimit të vet 2020 sa i përket konsumit të energjisë së ripërtërishme. Me qëllim të realizimit të këtij caku, masa drunore

<sup>41</sup>Shyqyri Kelmendi, Resurset Natyrore, Baza për Zhvillimin Ekonomik Kombëtar, 2012.

duhet të sigurohet nga prerjet legale kurse për momentin, prerjet legale janë në nivel shumë më të ulët sesa masa drunore që vjen nga prerjet ilegale.

Puna në dizajn do të nënvizojë bilancin në mes të këtyre nën-RN-ve dhe do të sigurojë asistencën e mjaftueshme për furnizim të sigurt me energji, kurse fushëveprimi i punës rregullative/ligjore/politike do të përkufizohet në mënyrë të atillë që të jetë i arritshëm dhe t'i përkrahë përparësitë krahasuese të USAID-it dhe të kontributeve të donatorëve të tjerë dhe të Qeverisë së ShBA-së.

**Nën-RN2.3.1 (Furnizimi më i Sigurt me Energji)** do të adresojë nevojën për furnizim të vazhdueshëm dhe të besueshëm me energji që është absolutisht e rëndësishme për cilësinë e përgjithshme të jetesës në Kosovë dhe për rritjen ekonomike. Kjo do të përbëhet nga asistencë teknike e shënjestruar për të zhvilluar sektorin energjetik efikas dhe financiarisht stabil që mund të joshë investimet nga sektori privat për të përkrahur themelimin e sistemit energjetik me nivel të ulët të karbonit. Ai do të fokusohet në "reformat politike të cilat e tërheqin vëmendjen rreth dëmeve nga ndotja, ndikimi ekonomik negativ nga importimi i energjisë, dhe efektet negative të subvencioneve dhe çmimit të importit, dhe kështu të krijohen mundësitë për shfrytëzim maksimal të resurseve vendore energjetike" si pjesë e përkrahjes së Misionit për Strategjinë Zhvillimore dhe për Ndryshime Klimatike të Agjencisë 2012 RN1.1. Një studim i bërë në mars të vitit 2013<sup>42</sup> identifikoi mjedisin e favorshëm si pengesën më të madhe ndaj zhvillimit të energjisë së ripërtërishme në Kosovë duke theksuar mungesën e kornizës ligjore të qartë, të harmonizuara dhe gjithëpërfshirëse, mungesën e proceseve të institucionalizuara, aplikimin arbitrar të rishikimeve, proceset e vështira për marrjen e lejeve, dhe mungesën e planifikimit hapësinor për qëllime energjetike. Këto aktivitete do t'i përkrahin objektivat e Nismës Presidenciale për Ndryshimet Klimatike Globale (GCC), edhe pse Kosova nuk është shtet i përcaktuar si GCC për USAID-in.

Do të vazhdojë asistencë në lidhje me krijimin e kapacitetit tanimë të planifikuar gjenerues, Kosova C. Përderisa USAID-i nuk do të mbështesë këshilltarin për transaksione, pasiqë donatorët tjerë janë zotuar ta bëjnë këtë gjë; USAID-i do të vazhdojë të ofrojë asistencë teknike për subjektet e përfshira të Qeverisë së Kosovës për të siguruar një transaksion të lehtë. Kur të fillojë periudha e SBZhV-së në fjalë, në fillim të vitit fiskal 2014, sistemi i distribucionit të Kosovës me siguri se do të ketë kaluar 6 muaj nga privatizimi, pas përfshirjes së suksesshme në privatizim nga USAID-i dhe donatorët tjerë. Gjatë kësaj periudhe të strategjisë, USAID-i do të vazhdojë të ofrojë asistencë teknike për organet qeveritare përkatëse për të siguruar menaxhim dhe zbatim të drejtë të kësaj kontrate, dhe do të angazhohet me subjektet e njëjta për transaksionin e termocentralit Kosova C. USAID-i po planifikon të ofrojë përkrahje për Qeverinë e Kosovës në menaxhimin e prodhimit të tashëm të energjisë, d.m.th. Kosova A dhe B, kryesisht nëpërmjet përkrahjes për një "Këshilltar të Strategjisë" që do t'i ndihmojë Qeverisë për koncesionin apo shitjen e Kosovës B apo të Kosovës A dhe B. Megjithatë USAID-i nuk do të ofrojë më asistencë për punën e përditshme të subjekteve prodhuese apo distribuuese. Në perspektivë, Misioni, në koordinim me projektin rajonal për energji të USAID/W, do të ndihmojë integrimin në tregun rajonal energjetik dhe zhvillimin e vazhdueshëm të Strategjisë Energjetike për të zgjeruar dhe diversifikuar furnizimin, përfshirë prodhimin e energjisë së ripërtërishme. Do të vazhdojë puna e USAID-it në sektorin energjetik për të siguruar se furnizimi adekuat energjetik i përgjigjet rekomandimeve të analizës së FAA 119 Biodiversiteti, për zhvillimin e burimeve alternative për ngrohje me qëllim të uljes së kërkesës për dru zjarri.

**Nën-RN2.3.2 (Politikat, Ligjet dhe Rregulloret që Mundësojnë Praktikën më të Mira në Menaxhimin e Resurseve Natyrore)** do të ndihmojë Qeverinë e Kosovës në hapat e parë të vendosjes së kornizës së duhur për zhvillim përgjegjës dhe të përshtatshëm mjedisor të këtij sektori. Kapaciteti i organeve rregullative do të jetë fokusi kryesor. Kjo lidhet qartë me nën-RN2.3.1. Në mënyrë që Kosova t'i zhvillojë resurset e veta natyrore në mënyrë strategjike dhe transparente, Ministrinë e ndryshme dhe autoritetet rregullative, siç janë Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

<sup>42</sup>USAID Kosovë, *Analizë e stimulimeve financiare dhe e barrierave jo-financiare ndaj zhvillimit të energjisë së ripërtërishme në Kosovë (draft i prezantimit)*, 29 mars 2013.

– do të kenë nevojë për përforsim të legjislacionit primar dhe sekondar si dhe të procedurave të licencimit. Aktivitetet do të zhvillojnë mjedisin afarist, e kështu do të ndihmohet krijimi i qëndrueshëm i pasurisë dhe i vendeve të punës, e kjo do të forcojë buxhetin shtetëror dhe do të reduktojë deficitin tregtar.

## OZh2: NISMAT E GËRSHETUARA

Nisma **USAID FORWARD**, në veçanti Zgjidhjet Lokale, do të aplikohet në të gjitha aktivitetet e OZh2 si një element i rëndësishëm për arritjen e objektivit të përgjithshëm të përforsimit të kapaciteteve të Qeverisë së Kosovës për ofrimin e asistencës zhvillimore nëpërmjet sistemit të vet të prokurimit, dhe në përkrahjen e organizatave joqeveritare vendore dhe të institucioneve tjera. Aktivitetet nën këtë OZh përfshijnë punën e drejtpërdrejtë me ministritë e Qeverisë së Kosovës dhe me organet komunale, me një numër të shoqatave afariste, OJQ-ve, grupeve për avokim dhe me disa kompani vendore private të konsulencës për të përforsuar kapacitetet e tyre, nëpërmjet vendosjes së marrëdhënieve të drejtpërdrejta me USAID-in, në ofrimin e asistencës së Qeverisë së ShBA-së brenda kornizës legjislative të Kosovës. Me qëllim të realizimit të këtij treguesi dhe të "treguesve tjerë kryesorë" të USAID *Forward*-it, vëmendje do t'i kushtohet edhe punës së drejtpërdrejtë me subjektet me kombësi të përziera, me bizneset dhe organizatat që janë pronë e grave dhe e pakicave, si dhe me grupet tjera të rrezikuara. (Shih shtojcën 2 për më shumë hollësi).

**FUQIZIMI I GRAVE** do të theksohet përgjatë tërë Objektivit Zhvillimor. Vlerësimi i fundit i çështjeve gjinore i bërë nga Misioni<sup>43</sup> thekson deklaratën e pothuajse të gjithë të anketuarve të cilët përmendën mungesën e fuqizimit ekonomik si çështjen më të rëndësishme në lidhje me barazinë gjinore me të cilën përballen gratë e Kosovës. Kjo shihet si arsye pse gratë kanë autoritet të ulët në vendimmarrje brenda familjes, kanë varësi ekonomike, përballen me pamundësi për t'i ikur dhunës në familje dhe paraqet pengesë ndaj pjesëmarrjes politike dhe qytetare, në mes tjerash. Si reagim, të gjitha aktivitetet që lidhen me rritjen ekonomike duhet dhe do të synojnë sigurimin e pjesëmarrjes së dukshme të grave.

Duket qartë se gratë në Kosovë kanë pozita shumë të pakta në menaxhmentin e lartë. USAID-i do të punojë me "Odën Ekonomike të Grave" për të rrënjosur efektivitetin në rritjen e grave në biznes, dhe do të ndërlihdë të gjitha aktivitetet dhe të gjithë aktorët nga shoqëria civile dhe donatorët. Kjo organizatë synon zhvillimin e mundësive për të krijuar programe mentorimi për udhëheqëse dhe menaxhere të mundshme afariste, dhe ato të vihen në kontakt me udhëheqëset dhe menaxheret tanimë të suksesshme.

Përveç kësaj, RN2.2 (*Ngritja e Konkurrueshmërisë dhe e Lidhjeve Tregtare në Fushat e Shënjestruara të Sektorit Privat*) do të fokusohet në një apo më shumë sektorë që punësojnë numër të madh të grave dhe kanë potencial të lartë që gratë të zënë pozita vendimmarrëse apo udhëheqëse. Numri i femrave ndërmarrëse në Kosovë është më i vogli në rajon. Bizneset që janë pronë e grave gjithashtu janë biznese mikro, të cilat në përgjithësi operojnë me margjina të vogla të profitit, punësojnë pak persona, dhe kanë nivel të ulët të kapitalizimit në krahasim me bizneset që janë pronë e burrave. Njëkohësisht femrat ndërmarrëse në Kosovë përballen me barriera shumë të mëdha ndaj qasjes në kredi pasi që nuk posedojnë kolateralin e nevojshëm. USAID-i do të zbatojë mekanizmat për dhënie të kredisë për gratë të cilat dëshirojnë të nisnin apo të zgjerojnë biznesin e tyre. Kjo mund të përfshijë ndarjen e një shume të caktuar për të garantuar kreditë specifike vetëm për bizneset në pronësi të grave.

Ky Objektiv Zhvillimor vë theks më të madh në adresimin e **ZHVILLIMIT TË KAPACITETIT NJERËZOR DHE INSTITUCIONAL (HICD)** sesa strategjitë e kaluara për rritje ekonomike. Në bashkëpunim me objektiva më të gjera të misionit për HICD, ky OZh do t'i kontribuojë përforsimit të

<sup>43</sup>Cozzarelli, Catherine, 2012 *Vlerësimi shtetëror i çështjeve gjinore për USAID/Kosovë*, gusht 2012.




sistemeve të shtetit të cilat kanë të bëjnë me rritjen ekonomike, duke mbyllur në mënyrë permanente hendekun ndaj performancës brenda institucioneve partnere me prioritet të lartë sipas SBZhV-së.

**ANTI-KORRUPSIONI** do të adresohet nëpërmjet disa aktiviteteve. RN2.1 (*Përmirësimi i Qeverisjes Ekonomike dhe i Mjedisit Afarist*) do të ofrojë asistencë për menaxhimin e financave publike për të përmirësuar aftësinë e Qeverisë së Kosovës në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit në mënyrë transparente, gjë që ulë mundësitë për keqpërdorime. Përkrahja për përmirësimin e mjedisit të favorshëm afarist do të shtojë transparencën. Ndërtimi i kapacitetit në prokurimet në partneritetet publiko-private (PPP) do të mbështesë konkurrencën, transparencën dhe trajtimin e drejtë të të gjithë aplikuesve. Aftësia e sektorit privat për të avokuar për trajtim të drejtë do të përkrahet nën RN2.2 (*Ngritja e Konkurrueshmërisë dhe e Lidhjeve Tregtare në Fushat e Shënjestruara të Sektorit Privat*). RN2.3 (*Përmirësimi i Menaxhimit të Resurseve Natyrore në Fushat Kryesore*) do të ulë shkallën e abuzimeve në sektorin e resurseve natyrore që vjen si rezultat i politikave dhe i rregulloreve të dobëta, dhe do të përmirësojë menaxhimin financiar të të hyrave nga resurset e begatshme natyrore të Kosovës.

Kosova ka **RINI** të madhe e cila është e papunë, e paangazhuar dhe e papërfshirë. Shteti ka popullsinë më të re në Evropë ku 25% e saj është nën moshën 25 vjeçare. Kjo lidhet me aktivitetet e OZh3 që synon përgatitjen e rinisë për punësim duke ofruar arsimim përkatës, ku USAID-i do të punojë nën këtë OZh me institucionet lokale dhe të sektorit privat për të nxitur zgjerimin e fushave të cilat shfrytëzojnë punonjës të rinj, që shoqërohet me trajnim përkatës me qëllim të zhvillimit të aftësive specifike të nevojshme për punëdhënësit potencial.

Sa i përket **INTEGRIMIT TË PAKICAVE**, menaxhimi i OZh2 do të sigurojë se të gjithë qytetarët përfitojnë nga nismat për rritje ekonomike. Të gjitha aktivitetet do të përfshijnë shtrirje dhe informim në terren për të siguruar pjesëmarrjen e grupeve të cilat tradicionalisht kanë qenë të përjashtuara. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me RN1.3 (*Përmirësimi i Integrimit të Pakicave Etnike*) dhe në veçanti me nën-RN1.3.3 (*Shtimi i Bashkëveprimet Ekonomik në mes të Komuniteteve Pakicë e Shumicë*).



## D. Objektivi Zhvillimor 3

### *Të Forcohet Kapitali Njerëzor*

OZh3 e strategjisë së propozuar nga USAID-i bazohet në parimin se kapitali njerëzor është themeli i rritjes ekonomike dhe i zhvillimit, dhe se kështu lidhet ngushtë dhe përkrahë të gjitha objektivat e misionit si dhe synimin strategjik, d.m.th. rritja e prosperitetit nuk mund të arrihet pa përmirësime në arsim. Ky OZh do të fokusohet në përforsimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor parauniversitar i cili është prekur shumë rëndë nga konflikti, dhe në ofrimin e mundësive arsimore në nivel ndërkombëtar (kryesisht në ShBA) si dhe arsim e aftësim post-diplomik që do të rezultojë në numër më të madh të personelit të talentuar, të gatshëm dhe të aftë për të adresuar në mënyrë efektive prioritetet zhvillimore të Kosovës. Varësisht nga arritja e etapave të caktuara, asistenca e synuar për përmirësime pedagogjike dhe në menaxhment mund t'i jepet edhe Universitetit të Prishtinës.

Ky OZh drejtpërdrejtë përkrahë vizionin e Qeverisë së Kosovës për arsimim, siç është theksuar në *Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016 (PSAK)* "të krijohet një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe t'i sigurohet të gjithë qytetarëve qasje e barabartë në arsim cilësor në të gjitha nivelet". Aktivitetet e vazhdueshme në arsimin fillor përvijohen me synimin e parë të Strategjisë së USAID-it për arsim, që është "Përmirësimi i aftësive në lexim për 100 miliona fëmijë në shkollat fillore gjer në vitin 2015". Nëpërmjet përmirësimit të metodologjive në mësimdhënie dhe vlerësim, dhe me futjen e "leximit në klasa të hershme" në gjuhën shqipe, aktivitetet do të vazhdojnë gjatë periudhës së strategjisë për t'i kontribuar drejtpërdrejtë përmirësimit të aftësive në lexim në klasat e para të fillores. Ndërhyrjet e mundshme në nivel të mesëm do të adresojnë normat e larta të braktisjes së shkollimit në mesin e vajzave, gjë që i kontribuon strategjisë së agjencisë e cila inkurajon arsimimin gjithëpërfshirës dhe të barabartë. Kjo do të vazhdojë me krijimin e themeleve të forta që rrjedhin nga reformat në arsimin fillor, gjë që u siguron atyre bazë të mirë në lëndët siç janë shkenca, matematika dhe gjuha angleze, të cilat janë të nevojshme për të përgatitur të rinjtë për punësim. Aktivitetet e propozuara për arsimin e lartë përkrahin qëllimin e dytë të Strategjisë për arsim, që është "Përmirësimi i kapacitetit të programeve terciare dhe për zhvillim të fuqisë punëtore për të ngritur një fuqi punëtore e cila ndërlidhet me qëllimet zhvillimore të shtetit". Duke përforsuar kapacitetin lokal nëpërmjet bursave, shkëmbimeve dhe partneritetit me institucionet rajonale, lokale dhe të ShBA-së, këto aktivitete do të rezultojnë në nivel më të lartë të kapitalit njerëzor, gjë që përkrahë rritjen ekonomike dhe reformat në Kosovë<sup>44</sup>.

### Supozimet Kyçe dhe Rreziqet për OZh3

Arritja e këtij Objektivi Zhvillimor do të varet nga niveli i absorbimit nga ana e Qeverisë së Kosovës, në veçanti në lidhje me nivelin e ngritur të autonomisë. Sa i përket arsimit parauniversitar, vazhdimisht ekzistojnë shqetësime në lidhje me vendimet për emërimet në nivel të menaxhmentit të shkollës të cilat bëhen në nivel lokal apo nuk marrin parasysh kandidatët më të mirë. Problemi i ngjashëm ekziston edhe në nivel universitar ku vendimet për menaxhmentin shpeshherë merren nga zyrtarët jashtë universitetit dhe nuk marrin parasysh objektivitetin dhe ekselencën akademike. Me qëllim të përmirësimit të kësaj situatë, duhet të ekzistojë vullneti për përgatitje të politikave, rregulloreve dhe procedurave më të fuqishme që kanë të bëjnë me resurset njerëzore. Kjo do të thotë se të gjeturat e vlerësimit të fundit HICD nga USAID-i nënvizojnë disa fusha tjera me prioritet për reforma të cilat, po që se realizohen, duhet të gëzojnë përkrahje të fuqishme nga Qeveria e Kosovës dhe nga Universiteti i Prishtinës<sup>45</sup>.

<sup>44</sup> USAID, Strategjia për arsim: Mundësitë arsimore nëpërmjet mësimnxënies, 2011.

<sup>45</sup> Odell, Malcolm J., etj., *Vlerësimi i zhvillimit të kapacitetit njerëzor dhe institucional: Kosovë*, raport i përgatitur për USAID-in nga Aguirre Division of JBS International, Inc., gusht 2012.

## Donatorët Tjerë

Qeveria e Kosovës dhe në veçanti Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë varet shumë nga komuniteti ndërkombëtar kur kemi të bëjmë me asistencën e vazhdueshme financiare dhe teknike. Banka Botërore synon përforcimin e sistemeve dhe të kapaciteteve institucionale e menaxhuese të cilat janë të nevojshme për përmirësim të cilësisë së arsimit, kurse BE-ja po ofron mbështetje për përgatitje të kurrikulumit, aftësimin të mësimdhënësve dhe për zbatim të masave për siguri të cilësisë. Të gjitha punët në arsimin e lartë do të zbatohen brenda kornizës së Procesit të Bolonjës, e cila nënkupton një gamë marrëveshjesh nga shtetet evropiane të dizajnuara për të arritur krahasueshmëri në standarde dhe në cilësi të arsimit të lartë. Suedia dhe Austria janë donatorët tjerë më të mëdhenj bilateral. Janë formuar dhe sponsorizuar partneritetet e shumta me universitetet dhe partneritetet tjera institucionale. Janë dhënë shumë bursa për studime jashtë vendit për çdo vit nga donatorët. Dyfishimi po shmanget dhe bashkëpunimi po sigurohet nëpërmjet koordinimit të ngushtë në lidhje me planet vjetore të punës së donatorëve dhe nëpërmjet punëtorive për monitorim që mbahen dy herë në vit.

## Cilat janë Dallimet në Krahasim me Portofolin e Tashëm?

Ky OZh fokusohet shumë në ndihmën që Kosova të ketë punëtorë më të arsimuar dhe të aftësuar, gjë që përkrahë forcimin e ekonomisë dhe të institucioneve demokratike, madje ofron edhe mundësi më të mira për punësim, në veçanti për të rinjtë, gratë dhe pakicat. Duke vazhduar punën nga strategjitë dhe arritjet e kaluara, ky OZh aplikon një qasje më gjithëpërfshirëse HICD sesa që është artikuluar në të kaluarën, dhe shënjestron më me vëmendje institucionet të cilat ndërlidhen me objektivat zhvillimore, dhe bazohet në vlerësimin e sipërpërmendur.

Pas reduktimit të numrit të ndërrimeve të punës nëpër shkolla nga tri në dy ndërrime, dhe pasi që Ministria e Arsimit buxhetoi planet për të reduktuar punën në vetëm një ndërrim, USAID-i nuk do të përfshihet më në ndërtimin apo rehabilitimin e objekteve shkollore. USAID-i gjithashtu nuk do të përfshihet në reforma të shkallës së gjerë në sistemin e arsimit të lartë. Po që se jepet asistencë, ajo do t'i dedikohet fakulteteve brenda Universitetit të Prishtinës. Nuk ka plane për të punuar me universitetet private apo për certifikim e monitorim të përgjithshëm të universiteteve nga Ministria e Arsimit. Si bartësi kryesor i arsimit të lartë, Universiteti i Prishtinës (UP) paraqet partnerin më të përshtatshëm për qëndrueshmëri afatgjatë. Përderisa numri i institucioneve private po rritet, ato nuk janë të ndërlidhura, kurse oferta e tyre kap përqindje të ulët. Janë planifikuar dhe janë duke u hapur institucione të reja publike, por ato janë ende të papërvojë.

## Rezultatet e Ndërmjetme

**RN3.1: Përmirësimi i Arsimit Parauniversitar.** Ky RN do të vazhdojë me arritjet e realizuara nga Programi i USAID-it për arsimin themelor, dhe do të vazhdojë marrëdhënien dhe lidhshërinë e fuqishëm të USAID-it në përkrahje të arsimit fillor. Sa i përket sistemit të arsimit parauniversitar, Kosova është në një gjendje e cila është e pazakontë në kontekst evropian. Edhe pse ka pasur komprometime të rënda të sistemit gjatë viteve të konfliktit, tani po bëhen përpjekje për të ndërtuar një sistem pothuajse plotësisht të ri, përkundërt shqetësimeve të shumta në këtë proces. Përmes këtij RN-je, dhe duke u bazuar në përvojën e gjerë mbarëbotërore të USAID-it në arsim, do të ofrohet asistencë me qëllim që të vazhdohet përmirësimi i menaxhimit, i metodologjive dhe i materialeve mësimore. Kjo do të bëhet duke ditur qartë se arsimi parauniversitar është blloku i parë dhe më esencial i zhvillimit.

**Nën-RN3.1.1 (Përmirësimi i Kurrikulumit, i Metodologjive dhe Materialeve Mësimore në Lëndët e Zgjedhura)** do të fokusohet në përmirësimin e planprogrameve lëndore, aftësive pedagogjike dhe materialeve mësimore në disa lëndë kryesore, përfshirë matematikën, shkencën, leximin dhe teknologjinë informative. Këto ndërhyrje të projektit do të përmirësojnë rezultatet mësimore, dhe kështu do të përgatisin më mirë nxënësit, të cilët tani janë të frustruar së bashku me prindërit e tyre rreth cilësisë së arsimit fillor, regjistrimit në sistemin arsimor, në programet e aftësimin për punë apo për hyrje të

drejtpërdrejtë në tregun e punës. Pasi që Programi për Arsimin Themelor përmyllet në vitin 2015, asistencë për arsimin fillor mund të vazhdojë në shumë fusha specifike të identifikuara në vlerësimin që bëhet në fund të projektit, por theksi do të zhvendoset gjatë periudhës së strategjisë ashtu që fokusi më i madh do të vihet te arsimi i mesëm (klasat 10-12) dhe në mundësitë për aftësim profesional.

**Nën-RN3.1.2 (Përmirësimi i Menaxhimit të Sistemeve Shkollore në Nivel Lokal)** do të adresojë kapacitetin institucional dhe menaxhues në sektorin arsimor, përfshirë edhe atë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), në përvijim me trendët global në arsim dhe me standardet e BE-së. USAID-i do të luajë rolin e vet së bashku me donatorët tjerë të reformave madhore arsimore të Qeverisë së Kosovës për të shtyrë përpara vizionin e shprehur në *Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës 2011 - 2016* (PSAK). USAID-i do të synojë përforcimin e transparencës dhe të sistemeve për menaxhim efikas në nivel lokal, që ndihmon angazhimin e komunitetit në vendimmarrje nëpërmjet shoqatave prindër-mësimdhënës, bordeve lokale të shkollave dhe këshillave të nxënësve. Kjo e fundit lidhet ngushtë me RN1.4 (*Përforcimi i Shoqërisë Civile për t'u Angazhuar në Mënyrë Konstruktive me Qeverinë*).

**RN3.2: Përmirësimi i Bazës së Aftësive Profesionale.** Ky RN do të shtojë mundësitë për bursa afatshkurtra dhe afatmesme për nxënësit që të studiojnë jashtë vendit në universitetet e ndryshme të mirënjohura ndërkombëtare, në veçanti në Shtetet e Bashkuara. Të gjithë pjesëmarrësit do të obligohen që të nënshkruajnë marrëveshjen para nisjes për kthimin e tyre në Kosovë për të punuar në vendet e punës që përputhen me studimet e ndjekura. Trajnimet në gjuhën angleze dhe orët përgatitore për kolegji do të ofrohen për personat të cilët kanë pasur qasje të kufizuar në studimet cilësore Bachelori, ashtu që të zgjerohet baza e kandidatëve të pranueshëm për studime jashtë vendit. Këto mundësi për bursa do të lidhen drejtpërdrejtë me ndërhyrjet e shënjestruara të projektit të tri Objektivave Zhvillimore dhe vëmendje të veçantë do t'i kushtohet mundësive për bursa për gratë dhe pakicat. Ky RN ndërtohet mbi përvojën e Qeverisë së ShBA-së dhe bazohet në hipotezat zhvillimore sipas së cilave studentët të cilët i ekspozohen mundësive jashtë vendit do të përkrahin "mënyra të reja të të menduarit dhe të bërit". Ndikimi që pritet mund të tregohet me numrin e shtuar të qytetarëve kosovar me kualifikime të larta të cilët i kontribuojnë të ardhmes së Kosovës. Këto aktivitete do të koordinohen me programet e trajnimit të Zyrës për Diplomaci Publike (PD) të Ambasadës, i cili përkrahë mesatarisht tre kandidatë në vit për studimet Master, kurse programet afatshkurtra të trajnimit dhe të shkëmbimit përkrahin 15 individë në vit. (Qëllimi dhe kriteret e përzgjedhjes dallojnë në çdo program të PD-së, kurse përfitues mund të jenë nxënësit nga shkolla e mesme dhe studentët e studimeve post-diplomike).

**Nën-RN3.2.1 (Më shumë Individë të Aftësuar në Shkolla Profesionale dhe Studentë të Studimeve Post-Diplomike në ShBA të Angazhohen në Sektorët dhe Institucionet Kryesore)** do të ofrojë bursa për afat të mesëm (zakonisht dyvjeçare) për studime në Master dhe për kurset teknike afatshkurtra ndërkombëtare. Do të jepet përkrahje për kurset të cilat drejtpërdrejtë lidhen me punën e pjesëmarrësve të propozuar. Këto oferta do të koordinohen me aktivitetet tjera të USAID-it, kurse përfituesit do të përzgjidhen kryesisht nga institucionet apo sektorët e njëjtë (publik apo privat) të cilët gjithashtu mbështeten nga Qeveria e ShBA-së nëpërmjet projekteve tjera. Ky koordinim do të ndihmojë për t'u siguruar që të gjithë pjesëmarrësit do të kthehen në një mjedis pune të favorshëm dhe të përmirësuar, gjë që përmirëson ndikimin dhe zvogëlon barrën për monitorim.

**Nën-RN3.2.2 (Përmirësimi i Menaxhimit të Universitetit dhe Pedagogjisë në Fakultetet e Përzgjedhura)** do të ofrojë përkrahje për forcimin e menaxhimit në fakultetet e përzgjedhura në nivel universitar. Politizimi dhe mungesa e pavarësisë së Universitetit të Prishtinës është sfida më e madhe. Përkundër disa ndryshimeve të reja pozitive në leadership, situata mbetet e paqartë, të cilën USAID-i vazhdon ta vëzhgojë. Aktivitetet në këtë nën-RN do të përfshihen në partneritet me institucionet arsimore amerikane të cilat pranojnë bursistët nga nën-RN3.2.1, dhe ato aktivitete do të jenë shumë të fokusuar. Asistencë plotësuese do të varet nga progresi në reformim të universitetit. Gjer në kohën kur fillon periudha e kësaj SBZhV-je, në fillim të vitit fiskal 2014, USAID-i do të ketë kryer një vlerësim të administratës së Universitetit të



Prishtinës, përfshirë planin e veprimit për reforma. Asistenca nën këtë RN do të lidhet me arritjen e etapave të treguara në planin e veprimit. Nëse Universiteti i Prishtinës bën progres, ky RN do të zgjerojë aftësinë e Universitetit për të menaxhuar partneritetet në mënyrë të drejtpërdrejtë, që rezultojnë në punë shtesë me fakultetet e përzgjedhura në përpilimin e kurrikulumeve inovative të cilat përmirësojnë gjasat e të diplomuarve për punësim. Përveç kësaj, do të përmirësohen metodat mësimore dhe do të futen programet e aftësimin të mësimdhënësve të cilat fokusohen në mundësitë për punësim.

### OZh3: NISMAT E GËRSHETUARA

**USAID FORWARD** me sukses është trajtuar nga Programi për Arsimin Themelor (që zgjat gjer në vitin 2015) i cili është menaxhuar së bashku me Qeverinë e Kosovës nëpërmjet një fondi të mirëbesimit me paratë e Qeverisë së Kosovës. Planet e punës për këtë fond janë miratuar në bazë vjetore dhe ka pasur monitorim të përbashkët të zbatimit. Kjo i paraprin ndërtimit të kapacitetit të shtetit nikoqir nga USAID *Forward*, përderisa punët e ngjashme bashkëpunuese do të ndërmerren edhe gjatë periudhës së strategjisë. (Shih shtojcën 2 për më shumë hollësi).

**FUQIZIMI I GRAVE** po arrihet gradualisht ashtu që gratë kanë krijuar shumicë brenda organeve studentore në kuadër të institucioneve kosovare të arsimit të lartë dhe dalëngadalë po fillojnë marrjen e rolit udhëheqës. Megjithatë vetëm 29% e grave janë aktive në tregun e punës, që është norma më e ulët në rajonin e Evropës dhe të Euro-Azisë. Ky OZh do të adresojë çështjet e pabarazisë gjinore në arsim nëpërmjet reformave në kurrikulum dhe menaxhim në kontekst të përkrahjes për *Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016*, që parasheh një sistem arsimor gjithëpërfshirës i cili i siguron të gjithë qytetarëve qasje të barabartë në arsim cilësor në të gjitha nivelet. Në koordinim me Objektivat tjera zhvillimore të Misionit, OZh3 do të përkrahë dhe do të nxitë pjesëmarrjen më të madhe të femrave, për të siguruar se gratë çdo herë e më shumë fusin në punë arsimimin dhe aftësimin e tyre në nivele të larta të vendimmarrjes. Për shembull, TIK është një fushë ku USAID-i mund të shtojë mundësitë arsimore për të siguruar pjesëmarrjen e femrave. USAID-i gjithashtu do të përkrahë përfshirjen e studenteve në bursa jashtë vendit për inxhinieri kompjuterike, shkenca kompjuterike, biznes dhe matematikë.

Misioni do të shfrytëzojë kornizën e **ZHVILLIMIT TË KAPACITETIT NJERËZOR DHE INSTITUCIONAL** të Agjencisë për të punuar me Objektivat Zhvillimore dhe me institucionet e synuara me qëllim të përmirësimit të kapacitetit në mënyrë më gjithëpërfshirëse dhe më të qëndrueshme. Sa i përket OZh3, ky model është aplikuar në dizajnimin e aktiviteteve të arsimit fillor të cilat po reformojnë sistemin arsimor nga Ministria e Arsimit, e gjer te shoqatat prindër-mësimdhënës dhe bordet e shkollave. Në sektorin e arsimit të lartë mund të kryhen disa reforma institucionale brenda fakulteteve të zgjedhura të Universitetit të Prishtinës. Nëse jepet asistenca e tillë, ajo do të bazohet në Planin e Veprimit që është në pajtim me teorinë e HICD-së dhe në pajtim me rekomandimet e analizës së HICD-së të ndërmarrë rishtazi nga USAID-i në Kosovë.

Puna në **ANTI-KORRUPSION** fokusohet në përgatitjen e kuadrit me aftësi të forta profesionale dhe etike. Duke pasur parasysh OZh3, përmirësimet në administratë dhe menaxhim të arsimit do të mundësojnë më pak keqpërdorime (manipulime) dhe favorizime gjatë punësimit. Përmirësimi i angazhimit dhe mbikëqyrjes së qytetarëve, nëpërmjet shoqatave prindër-mësimdhënës, bordeve të shkollave dhe përfshirjes së studentëve, do të rezultojë në llogaridhënie më të madhe.

**RINIA** natyrisht se është pikë qendrore e këtij Objektivi Zhvillimor. Përmirësimet në sistemet universitare dhe në institucionet parauniversitare në Kosovë do të përgatisin më mirë të rinjtë që të përmbushin nevojat e tregut dhe u ndihmojnë atyre në arritjen e ambicieve personale.

Rritja e **INTEGRIMIT TË PAKICAVE** është objektiv kryesor i këtij Objektivit Zhvillimor dhe i *Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2011-2016* (PSAK). Së bashku, Qeveria e Kosovës dhe USAID-i do të punojnë në drejtim të qasjes së barabartë në mundësi për arsim cilësor, dhe në veçanti do të synojë integrim më të madh të serbëve të Kosovës kudo dhe kurdoherë që është e mundshme. Kjo punë natyrisht se lidhet me punët tjera të Objektivit Zhvillimor në promovimin e përfshirjes më të madhe.

## IV. MONITORIMI, VLERËSIMI DHE MËSIMI

### Pasqyrë

Misioni do të zbatohet një proces gjithëpërfshirës për Monitorim, Vlerësim dhe Mësim (MVM) me qëllim të përcjelljes së rezultateve dhe të progresit në drejtim të arritjes së Qëllimit Strategjik dhe të tri Objektivave Zhvillimore, dhe të sigurojë informata esenciale dhe me kohë për Misionin dhe partnerët e tij për qëllim të menaxhimit dhe vendimmarrjes.

Monitorimi i performancës do të vazhdojë si proces i vazhdueshëm i cili do të ndihmojë në qartësimin dhe fokusimin e OZH-ve, që shërben si sistem i paralajmërimit të hershëm, po që se progresi nuk rrjedh ashtu siç pritet, gjë që mundëson raportimin e besueshëm, promovimin e mësimin të vazhdueshëm, si dhe mundëson adaptimin dhe përshtatjen gjatë zbatimit. Në pajtim me politikën e Agjencisë, vlerësimi do të fokusohet në llogaridhënien para akterëve dhe mësimin për të përmirësuar efektivitetin dhe për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë. Llogaridhënia do të matë efektivitetin e projektit, relevancën dhe efikasitetin, dhe ato të gjetura do të shpalosen para akterëve, përderisa të gjeturat do të përdoren për ndarjen e resurseve dhe për marrjen e vendimeve tjera programore dhe menaxhuese. Mësimi nga projektet e vlerësuara të cilat janë dizajnuar mirë dhe janë ekzekutuar me efektivitet, do të nxitë njohuri rreth madhësisë dhe përcaktuesve të performancës së projektit, gjë që u mundëson personave të cilët merren me dizajnimin dhe zbatimin e projekteve, të programeve dhe të strategjive, siç janë stafi i USAID-it, qeveritë nikoqire dhe partnerët, që të rafinojnë dizajnet dhe të bëjnë përmirësimet në punët e ardhshme.

Kështu proceset e monitorimit dhe të vlerësimit do të identifikojnë çështjet që merren parasysh për marrjen e vendimeve në lidhje me zbrazëtitë që mund të gjenden gjatë zbatimit, si dhe në supozimet dhe analizat të cilat mbështesin OZh-të dhe hipotezat zhvillimore. Ky "proces i mësimin" do të realizohet në bashkëpunim me partnerët zhvillimor për t'u siguruar se ajo çka funksionon do të theksohet, kurse ajo çka nuk funksionon do të ripunohet apo ndërpritet.

### *Sistemi i Menaxhimit në Bazë të Performancës*

Procesi i Misionit për Monitorim, Vlerësim dhe Nxjerrje të Mësimeve, do të zbatohet për të matur arritjet e rezultateve të dhëna në Kornizën e Rezultateve dhe kështu do të qartësohet dhe do të vihet fokusi në realizimin e atyre rezultateve. Të gjithë anëtarët teknik të Misionit do të përfshihen në procesin MVM, si dhe akterët tjerë përkatës (homologët vendor, përfituesit dhe partnerët zbatues) pjesëmarrja e të cilëve do të sigurojë qasje në dijen e dorës së parë, do të promovojë "pronësinë" e procesit, do të përshtatë dhe udhëzojë zbatimin, dhe do të ndërtojë aftësitë për monitorim dhe vlerësim në mesin e homologëve. Do të përfshihet një kërkesë specifike në të gjitha deklaratat e vlerësimit të punës që kërkon nga vlerësuesit të rishikojnë, dhe gjatë raportimit, të komentojnë rreth progresit të arritur në ndërtimin e kapacitetit lokal për monitorim dhe vlerësim.

### *Monitorimi në Bazë të Performancës*

Dizajni i sistemit MVM do të përfshijë Planin për Menaxhim të Performancës (PMP) që vlen për tërë misionin me qëllim të monitorimit të rezultateve dhe të progresit gjatë kohëzgjatjes së kësaj Strategjie. PMP do të finalizojë treguesit, do të vendosë caqet dhe do të caktojë mjetet e monitorimit, përfshirë regjimin dhe shpeshësinë e mbledhjes së të dhënave në lidhje me progresin e gjithëmbarshtëm në lidhje me OZh-të. Në nivel të OZh-së, PMP do të vendosë një proces të formalizuar dhe konsistent të monitorimit shumëvjeçar i cili do të zgjerohet tutje sa i përket përkufizimit të secilit tregues, do të përshkruajë shfrytëzimin e tyre për përcjellje të informatave, dhe do të përcaktojë njësinë e matjes, burimin dhe metodën e grumbullimit/analizimit të informatave, shpeshësinë e mbledhjes së informatave bazë dhe të synuara, si dhe planet për vlerësim cilësor të të dhënave. Duke specifikuar secilin tregues kështu në hollësi, Misioni do të sigurojë se të dhënat mbledhen dhe raportohen njëtrajtësisht gjatë tërë kohëzgjatjes së kësaj Strategjie.

Siç kërkohet nga ADS 203.3.4.3, PMP do të zërthejë të dhënat për kah gjinia dhe do të përfshijë treguesit gjinor të cilët janë të dizajnuar për të treguar mënyrën se si programi i ka kontribuar barazisë gjinore apo si ka ndihmuar në tejkalimin e barrierave ndaj fuqizimit të grave në çdo sektor. Njësoj do të përcillet edhe integrimi i pakicave. Do të tregohet se kush është përgjegjës në mesin e anëtarëve të ekipit teknik për mbledhjen e të dhënave.

Me qëllim që të sigurohet mbulesa gjithëpërfshirëse e nevojshme për rishikimin e progresit të programit, procesi i paralajmërimit/korrigjimit të hershëm, i menaxhimit dhe MVM, do t'i përcjellë këto lloje të performancës: a) *Treguesit e Kontekstit Shtetëror* do të shfrytëzohen për të monitoruar ndryshimet, "ndryshuesit e lojës", në Kosovë dhe brenda rajonit të Ballkanit, të cilat do të ndikojnë në zbatimin e OZh-së, dhe do të shërbejnë për informim nëse kërkohen përshtatje/korrigjime të OZh-së. Këto janë kushtet e përgjithësuara të cilat janë përtej kontrollit të Misionit por mund të zhvillohen dhe të pengojnë zbatimin e strategjisë. b) *Treguesit Kryesorë të Performancës* do të masin efektet e të dalave dhe rezultateve të programit. Kjo shërben si koment kthyes për vendimmarrësit brenda USAID-it, si dhe për homologët vendor, rreth performancës dhe ndikimit të OZh-së, gjë që u ndihmon atyre në identifikimin e fushave ku strategjitë e zbatimit mund të përshtaten. Siç u tha më sipër, kurdoherë që është e mundshme, treguesit do të zërthehen për kah gjinia dhe faktorët tjerë. Proceset MVM dhe PMP do të mbulojnë tërë kohëzgjatjen e kësaj Strategjie. Përshtatjet e planit do të dokumentohen plotësisht.

### ***Burimet e të Dhënave, Metodat e Mbledhjes dhe Kontrolli i Cilësisë***

Misioni do të mbledhë të dhënat, së paku sipas vitit fiskal, për të ndihmuar raportimin nga ana e USAID-it. Të dhënat mbi të gjithë treguesit do të mbledhen nga burimet e ndryshme, përfshirë partnerët (kontraktuesit) zbatues, homologët vendor dhe organizatat tjera zhvillimore. Nga partnerët zbatues do të kërkohet që të raportojnë të dhënat e zërthyera sipas gjinisë dhe të shfrytëzojnë treguesit gjinor në të gjitha projektet ku telashet gjinore janë paraqitur gjatë analizës gjinore të mandatuar nga ADS. Në rast të paraqitjes së mospërputhjeve në të dhëna, do të kërkohet verifikimi i tyre duke i krahasuar ato me të burimet origjinale.

Instrumentet/matjet që do të shfrytëzohen për të përcjellë progresin e treguesve, do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen vetëm në faktorët në vijim:

*OZh1: Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja Ashtu që t'i Përmëshin Nevojat e Qytetarëve*

- *Raporti Vjetor i Progresit, BE*
- *Freedom House, Shtetet në Tranzit*
- *Indeksi i Qëndrueshmërisë së OJQ-ve*

*OZh2: Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat*

- *Rritja në Investimet e Huaja Direkte*
- *Përqindja e Sektorit Privat Brenda BPV-së*
- *Raporti i Punësimit në Sektorin Publik dhe Privat*

*OZh3: Të Forcohet Kapitali Njerëzor*

- *Përmirësimi i nivelit të aftësive të të diplomuarve të punësuar dhe të përkrahur nga USAID-i*
- *Rritja e Poenëve në Arritshmërinë Kombëtare (pas klasës 9)*

### ***Vlerësimet***

Në pajtim me politikat e Agjencisë për vlerësim, gjatë kohëzgjatjes së periudhës së Strategjisë, Misioni do të respektojë kërkesat e projekteve madhore dhe provuese.

Misioni ka identifikuar një mundësi për kryerjen e një vlerësimi të ndikimit brenda çdo OZh-je. Për OZh1, Misioni do të shqyrtojë mundësinë që të kryejë një vlerësim të ndikimit në Sundimin e Ligjit për të

testuar efektin e ndërhyrjeve të USAID-it në reduktimin e lëndëve, që do të shërbejë si themel i rezultateve që janë të domosdoshme për të arritur OZh-në, dhe si pjesë kryesore e vendosjes së qeverisjes efektive. Në OZh2, USAID-i do të shqyrtojë mundësinë për kryerjen e një vlerësimi të ndikimit nga aktiviteti i vet në lidhje me konkurrueshmërinë e sektorit privat. Ky aktivitet do të vë themelin për arritjen e Objektivit të përgjithshëm zhvillimor. Për OZh3, USAID-i do të shqyrtojë mundësinë për kryerjen e një vlerësimi të ndikimit të arritur nga aktiviteti i tij për arsimin e lartë, me qëllim të vlerësimit të progresit të arritur nga USAID/Kosovë në përfundimin e kapacitetit njerëzor dhe institucional të Kosovës, si dhe të vlerësojë se si projekti ka përmirësuar gjendjen në punësim në fushat prioritare, dhe si ka rezultuar në rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit.

Vlerësimet e performancës të cilat do të bëhen në mes dhe në përmbyllje të periudhës së zbatimit do të masin arritjet e disa aktiviteteve apo projekteve të kryera gjatë kohëzgjatjes së Strategjisë. Pyetjet e poshtme janë ilustruese dhe do të rishikohen pas diskutimit në mes të kontraktuesit dhe ekipit të USAID-it. Pyetjet e fundit për çdo performancë dhe vlerësim të ndikimit do të analizohen dhe shtjellohen në thellësi më të madhe gjatë vlerësimeve përkatëse. Pyetjet kryesore do të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

#### *OZh1: Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja Ashtu që t'i Përmbushin Nevojat e Qytetarëve*

1. A ka pasur programi ndikim substancial në procesin e përmirësimit, në transparencë dhe besim në sistemin e drejtësisë dhe të qeverisjes? Në ç' masë ndërlidhet ky proces me poenët e ngritur të indekseve të lirisë demokratike dhe raporteve të progresit të BE-së?
2. Si ndërlidhet përmirësimi i perceptimit publik rreth sundimit të ligjit dhe qeverisjes përgjegjëse me: a) perceptimet e sektorit të drejtësisë më efikas, transparent, të pavarur dhe llogaridhënës; b) perceptimet rreth përfundimit të efektivitetit dhe llogaridhënies së kuvendeve, administratave dhe proceseve zgjedhore; c) perceptimet rreth përmirësimit në integrim të pakicave kombëtare; dhe d) perceptimet rreth shtimit të angazhimit konstruktiv të shoqërisë civile me Qeverinë?
3. Çfarë efekti ka pasur zotimi i Qeverisë së Kosovës (supozim kyç) në arritjen e ndikimit nën këtë Objektiv Zhvillimor? (Kjo vlen për të gjithë OZh-të).

#### *OZh2: Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat*

1. Sa kanë ndikuar përpjekjet për përmirësimin e mjedisit afarist në nivelin e konkurrueshmërisë së sektorit privat në Kosovë? A e kanë përmirësuar partneritetet publiko-private cilësinë e shërbimeve për publikun, duke zvogëluar barrën ndaj buxhetit qeveritar?
2. Sa është përmirësuar zbatimi i reformave dhe a ka sjellë rezultate në kuptim të rritjes së përgjithshme ekonomike?
3. A po ndikojnë rezultatet e programit në rritje të të ardhurave individuale për të gjithë qytetarët, përfshirë gratë dhe personat që bëjnë pjesë në grupet e rrezikuara?

#### *OZh3: Të Forcohet Kapitali Njerëzor*

1. Sa kanë ndikuar përmirësimet në kurrikulume dhe në menaxhim në arritjen e rezultateve më të mira mësimore të nxënësit e nivelit parauniversitar?
2. Sa është përqindja e të diplomuarve nga programet e arsimit terciar, të përkrahura nga Qeveria e ShBA-së, të cilët kanë raportuar se kanë gjetur punë? A po gjejnë këta pjesëmarrës të kthyer nga ShBA-ja mundësi për punësim në mjedis të favorshëm, ku mund t'i shfrytëzojnë shkathtësitë/mësimin e përvetësuar?



3. A kanë ndikuar përmirësimet e realizuara në fakultetet e caktuara të Universitetit të Prishtinës në rritjen e gjasave për punësim të të diplomuarve në këtë Universitet?

#### *Plani Mësimor*

Vlerësimet mund të sigurojnë dëshmi për vendimmarrje vetëm nëse ato janë të dizajnuara mirë dhe ekzekutohen në mënyrë sistematike. Arsyeja kryesore për kryerjen e vlerësimit është krijimi i dijes rreth madhësisë dhe përcaktuesve të performancës së projektit apo ndikimit që ka pasur projekti. Mësimi nga projektet e vlerësuara do të konfirmojë lidhjet në mes të Qëllimit Strategjik, OZh-ve dhe RN-ve dhe programeve e projekteve të tyre përkrahëse, dhe nëse kjo nuk konfirmohet, atëherë mësimi do të ofrojë rekomandime për ndryshime të projektit/programit.

Prandaj pas përfundimit të çdo vlerësimi, Misioni do të:

- Ndihmojë dhe koordinojë shkëmbimin e dijes së fituar nga përvoja me akterët e brendshëm dhe të jashtëm;
- Sigurojë që mësimet e sapomësuara dhe informatat rreth performancës, të cilat janë marrë nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit, do të shfrytëzohen si informatë për zbatim të Strategjisë dhe vendimmarrje nga ana e Misionit, dhe
- Identifikojnë faktorët dhe kushtet të cilat janë përtej kontrollit të saj, por të cilat mund të zhvillohen dhe të pengojnë zbatimin e Strategjinë në nivel të Qëllimit, OZh-së dhe RN-së.

## Shtojca 1: Treguesit e Performancës (ilustrim)

**Qëllimi:** Kosova të bëhet Shtet Gjithnjë e më i Begatshëm, i cili në Mënyrë Progressive Integrohet në Komunitetin Euro-Atlantik, me Qeverisje më Efektive dhe më Llogaridhënëse

1. Raporti Vjetor i Progresit, BE
2. Freedom House, Shtetet në Tranzit
3. Rritja në Bruto Prodhimin real Vendor (BPV) për Kokë Banori

**OZh1: Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja Ashtu që t'i Përbushin Nevojat e Qytetarëve**

1. Përqindja e qytetarëve në zonat e synuara të cilët mendojnë se institucionet e synuara qeveritare po i trajtojnë prioritetet e tyre
2. Numri i ndryshimeve/veprimeve të cilat kanë rezultuar nga avokimi i OShC-ve apo nga aktivitetet e monitorimit/mbikëqyrjes
3. Progresi në *Indeksin e Demokratizimit dhe Pjesëmarrjes*

**RN1.1: Sektor më Efikas, Transparent, të Pavarur dhe Llogaridhënës të Drejtësisë**

1. Përqindja e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës të cilët besojnë se gjykata do të zgjidhë lëndët e tyre me drejtësi
2. Numri dhe përqindja e lëndëve civile të përmbuaruara si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së
3. Përparimi i arritur në zbatimin e rekomandimeve nga *Raporti i Progresit nga BE për Sundimin e Ligjit* (në nivel etape)

**Nën-RN1.1.1: Përmirësimi i Administratës së Gjykatave dhe i Menaxhimit të Institucioneve Gjyqësore**

1. Numri i gjykatave të asistuar nga Qeveria e ShBA-së që kanë përmirësuar menaxhimin e lëndëve
2. Numri i lëndëve të shqyrtuara dhe të zgjidhura brenda 24 muajve

**Nën-RN1.1.2: Ngritja e Kualifikimeve të Profesionistëve të Sektorit të Drejtësisë**

1. Numri i personave të trajnuar apo numri i ditëve të mbajtura të trajnimit
2. Përqindja e gjyqtarëve, avokatëve dhe e stafit të gjykatave të trajnuar me asistencë të Qeverisë së ShBA-së
3. Numri i kurseve ligjore apo kurrikulumeve të përpiluara/përmirësuara me asistencë të Qeverisë së ShBA-së

**Nën-RN1.1.3: Përmirësimi i Regjimeve Ligjore në Fushat Kryesore me Zbatim më të Fuqishëm**

1. Numri i ligjeve, i legjislacionit sekondar, planeve strategjike dhe procedurave që përmirësojnë të drejtat kontraktuale dhe sistemin e të drejtave pronësore të miratuara me asistencë të Qeverisë së ShBA-së
2. Numri i marrëveshjeve të arritura dhe të përmbuaruara për zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM)
3. Numri i lëndëve të zgjidhura përmes procedurave të hartuara me asistencë të Qeverisë së ShBA-së (d.m.th. sistemi privat i përmbarimit, mosmarrëveshjet)

## **RN1.2: Përforcimi i Efektivitetit dhe Llogaridhënies së Kuvendeve, Administratave dhe Proceseve Zgjedhore**

1. Numri i qytetarëve të cilët janë të kënaqur me shërbimet e zgjedhura
2. Përqindja e rritjes së të hyrave vetanake të parashkruara me ligj në fushat kryesore
3. Përparimi në drejtim të mbikëqyrjes më efektive dhe llogaridhënese (në nivel etape)

### **Nën-RN1.2.1: Kuvendet dhe Administratat Komunale dhe Qendrore më Përgjegjëse**

1. Vlerësimi indeks i korrektësisë dhe transparencës së Kuvendeve Komunale dhe të Kuvendit të Kosovës
2. Numri i subjekteve në nivel komunal të cilët pranojnë asistencë nga Qeveria e ShBA-së në përmirësimin e performancës së tyre
3. Vlerësimi indeks i kapacitetit të administratave komunale

### **Nën-RN1.2.2: Ngritja e Kapacitetit për të Mbajtur Zgjedhje Kredibile**

1. Vlerësimi indeks i shkallës në të cilën monitoruesit e zgjedhjeve e vlerësojnë procesin zgjedhor si kredibil dhe korrekt
2. Vlerësimi indeks i kapacitetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
3. Numri i njerëzve të cilët kanë vijuar edukimin qytetar dhe edukimin për votues

## **RN1.3: Përmirësimi i Integritit të Pakicave Etnike**

1. Numri i pakicave të cilët i besojnë institucioneve kryesore qeveritare
2. Vlera e shitjes së NVM-ve që janë pronë e pakicave
3. Numri i vendeve afatgjata dhe afatshkurtra të punës që janë krijuar në viset me popullsinë e synuar pakicë

### **Nën-RN1.3.1: Ngritja e Kapacitetit të Qeverisë për të Adresuar Çështjet e Pakicave**

1. Përqindja e të anketuarve nga komunitetit pakicë që merr pjesë në organizatat e bazuara në komunitet të cilat kanë raportuar se në mënyrë efektive i qasen institucioneve të Qeverisë së Kosovës
2. Numri i çështjeve prioritare të pakicave të cilat janë trajtuar nga pushtetet lokale

### **Nën-RN1.3.2: Rritja e Pjesëmarrjes Aktive të Popullsisë Pakicë**

1. Numri i njerëzve të cilët marrin pjesë në organizimet e ndihmuara nga Qeveria e ShBA-së të cilat synojnë përgatitjen në drejtim të kuptimit më të mirë dhe zbutjes së konfliktit në mes të grupeve
2. Numri i projekteve të zbatuara së bashku nga OJQ-të e komunitetit pakicë dhe shumicë
3. Numri i qytetarëve të përfshirë në monitorimin e shërbimeve që ofrohen nga komunitetet partnere (mesatarja për komunë)

### **Nën-RN1.3.3: Shtimi i Bashkëveprimit Ekonomik në mes të Komuniteteve Pakicë e Shumicë**

1. Numri i anëtarëve të ri nga pakicat të përfshirë në shoqatat e bizneseve private si rezultat i trajnimeve nga Qeveria e ShBA-së
2. Numri i mikro-ndërmarrjeve të pakicave të lidhura me tregjet e shumicës dhe me firmat e shkallës së gjerë (zinxhiri i vlerave)
3. Numri i vendeve të reja të punës të krijuara si rezultat i asistencës së Qeverisë së ShBA-së

**RN1.4: Përforcimi i Shoqërisë Civile për Angazhim më të Madh dhe Konstruktiv me Qeverinë**

1. Progresi i matur në shkallë etape në drejtim të angazhimit më efektiv të qytetarëve në qeveri (në bazë të kritereve specifike)
2. Indeksi i qëndrueshmërisë së OJQ-ve (rezultati i avokimit)

**Nën-RN1.4.1:****Ngritja e Vetëdijes Qytetare dhe Aftësisë së Shoqërisë Civile për të Avokuar dhe Monitoruar**

1. Numri i çështjeve të avokimit të ndihmuara nga Qeveria e ShBA-së të cilave po u kushtohet vëmendje e shtuar publike
2. Numri i nismave të shoqërisë civile për mbikëqyrje të cilat i identifikojnë mangësitë kryesore në mes të dispozitave rregullative dhe praktikës reale të ekzekutivit dhe gjyqësorit
3. Numri i partive politike të ndihmuara nga Qeveria e ShBA-së me platforma të bazuara në çështjet e caktuara

**Nën-RN1.4.2: Përfaqësimi më i Madh i Grave, të Rinjve dhe Grupeve tjera të Rrezikuara**

1. Numri i grave me kapacitetit të rritur në leadership si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së
2. Numri i veprimeve që synojnë ndikimin e politikave qeveritare të cilat janë ndërmarrë nga grupet e ndihmuara nga Qeveria e ShBA-së të cilat përfaqësojnë grupet e komuniteteve të marginalizuara dhe të rrezikuara

**OZh2: Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat**

1. Rritja në investimet e huaja direkte
2. Përqindja e sektorit privat brenda BPV-së
3. Raporti i punësimit në sektorin publik dhe privat

**RN2.1: Përmirësimi i Qeverisjes Ekonomike dhe i Mjedisit Afarist**

1. Përpunimi në *Indeksin e të Bërit Biznes* të Bankës Botërore
2. Punësimi i sektorit formal si përqindje e punësimit total
3. Numri i bizneseve të regjistruara të cilat deklarojnë tatimet

**Nën-RN2.1.1: Përmirësimi i Kornizës Fiskale dhe i Menaxhimit të Financave Publike**

1. Të hyrat qeveritare (nga tatimet dhe jashtë tatimeve), me përjashtim të granteve të huaja, si përqindje e BPV-së
2. Numri i orëve të trajnimit të kryer në politikat fiskale dhe në administratë fiskale si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së

**Nën-RN2.1.2: Zbatimi i Reformave Kryesore Ekonomike në Nivel Qendror dhe Lokal**

1. Numri i rregulloreve dhe i procedurave administrative komunale të thjeshtëzuara si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së
2. Zbatimi i politikave, legjislacionit dhe i reformave strukturore në nivelin qendror (tregues i etapës)
3. Numri i orëve të trajnimit të kryer për mjedisin e favorshëm afarist të përkrahur me asistencë nga Qeveria e ShBA-së

**RN2.2: Rritja e Konkurrueshmërisë dhe Zgjerimi i Lidhjeve Tregtare në Fushat e Synuara të Sektorit Privat**

1. Rritja e rrogave në sektorët e synuar

2. Rritja e investimeve në sektorin privat brenda sektorëve të synuar

#### **Nën-RN2.2.1: NVM-të më të Qëndrueshme dhe që i Përgjigjen më Mirë Tregut**

1. Shuma e investimeve për përmirësim të teknologjisë si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së
2. Numri i vendeve të punës të krijuara si rezultat i asistencës së Qeverisë së ShBA-së

#### **Nën-RN2.2.2: Rritja e Prodhimtarisë Bujqësore dhe e Mundësive për Të Bërë Tregti**

1. Vlera totale e shitjeve në sektorin e bujqësisë si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së
2. Numri i tregjeve të reja të depërtuara nga produktet e synuara në zinxhirin e vlerave

#### **Nën-RN2.2.3: Përmirësimi i Qasjes në Financa**

1. Kreditë vendore për sektorin privat si përqindje e BPV-së
2. Shpërndarja e normës së kamatës (pikë të përqindjes)

### **RN2.3: Përmirësimi i Menaxhimit të Resurseve Natyrore në Fushat Kryesore**

1. Pikët nga vlerësimi i kapacitetit organizativ të subjekteve të synuara qeveritare që punojnë me çështjet që kanë të bëjnë me resurset natyrore
2. Përmirësimi i lidhjeve në mesin e seksioneve të ndryshme të ministrive të cilat janë të përfshira në menaxhimin e resurseve natyrore (etapat duhet të përcaktohen)

#### **Nën-RN2.3.1: Furnizimi më i Sigurt me Energji**

1. Numri i procedurave të thjeshtëzuara për licencimin e projekteve energjetike
2. Numri i megavateve të licencuara nga rregullatori
3. Numri i ligjeve, politikave, strategjive, planeve, marrëveshjeve apo rregulloreve të cilat i adresojnë ndryshimet klimatike (zbutjen apo adaptimin) apo konservimin e biodiversitetit të propozuar zyrtarisht, të miratuar apo të zbatuar si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së

#### **Nën-RN2.3.2: Politikat, Ligjet dhe Rregulloret që Mundësojnë Praktikën më të Mira në Menaxhimin e Resurseve Natyrore**

1. Numri i reformave politike, ligjore dhe rregullative të cilat përkrahin praktikën më të mira në NRM të përpiluar dhe të prezantuar para akterëve për konsultim si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së
2. Numri i reformave politike, ligjore dhe rregullative të cilat i përkrahin praktikën më të mira në NRM të miratuara si rezultat i asistencës nga Qeveria e ShBA-së
3. Numri i personave që i vijnë trajnimet e përkrahura nga Qeveria e ShBA-së për menaxhimin e resurseve natyrore dhe konservim të biodiversitetit

### **OZh3: Të Forcohet Kapitali Njerëzor**

1. Rritja e numrit të pikëve në arritshmërinë kombëtare (pas klasës 9)
2. Përqindja e përfituesve të cilët pranojnë bursa të përkrahura nga Qeveria e ShBA-së (përfshirë ato për certifikatë) të cilët shfrytëzojnë dijen/kualifikimet e ngritura (në bazë të anketës së punëdhënësve)
3. Përqindja e përfituesve të cilët kanë vijuar trajnime afatshkurtra brenda shërbimit publik të vendit, dhe të cilët tani po e shfrytëzojnë atë dije dhe kualifikim të përmirësuar (në bazë të anketës së punëdhënësve [shëfave të departamenteve në Qeverinë e Kosovës])



### **RN3.1: Përmirësimi i Arsimit Parauniversitar**

1. Numri dhe përqindja e nxënësve të shkollës fillore të cilët pas dy vitesh tregojnë aftësi të përmirësuara në lexim

#### **Nën-RN3.1.1: Përmirësimi i Kurrikulimit, i Metodologjive dhe Materialeve Mësimore në Lëndët e Zgjedhura**

1. Përqindja e shkollave fillore që shfrytëzojnë metodologjinë për vlerësim të mësimnxënies si rezultat i përkrahjes nga Qeveria e ShBA-së
2. Numri i mësimdhënësve të certifikuar në pajtim me standardet kombëtare të vlerësimit

#### **Nën-RN3.1.2: Përmirësimi i Menaxhimit të Sistemeve Shkollore në Nivel Lokal**

1. Numri i bordeve të shkollave të cilat funksionojnë me standardet e MASHT-it
2. Numri i mësimdhënësve/edukatorëve të aftësuar me përkrahje nga Qeveria e ShBA-së

### **Përmirësimi i Bazës së Aftësive Profesionale**

1. Përqindja e të diplomuarve nga programet e arsimit terciar të përkrahura nga Qeveria e ShBA-së të cilët vetë kanë raportuar se kanë gjetur punë (përfshirë trajnimin brenda shërbimit publik të vendit)

#### **Nën-RN3.2.1: Më shumë Individë të Aftësuar në Shkolla Profesionale dhe Studentë të Studimeve Post-diplomike në ShBA të angazhohen në Sektorët dhe Institucionet Kryesore**

1. Përqindja e të diplomuarve nga programet e bursave të përkrahura nga Qeveria e ShBA-së të cilët e kanë plotësuar kushtin për përfundimin e shërbimit dyvjeçar në komunitet
2. Numri i ditëve të trajnimeve afatshkurtra në shërbimin publik të vendit

#### **Nën-RN3.2.2: Përmirësimi i Menaxhimit të Universitetit dhe Pedagogjisë në Fakultetet e Përzgjedhura**

1. Numri i mësimdhënësve të arsimit terciar universitar, të cilët i kanë avansuar shkathësitë e tyre përmes programeve për arsim terciar të përkrahura nga Qeveria e ShBA-së
2. Përmirësimet e dukshme në menaxhim të Universitetit të Prishtinës si rezultat i ndërhyrjeve nga Qeveria e ShBA-së (tregues i etapës)

## Shtojca 2: USAID Forward

### **OZh1: Të Përmirësohet Sundimi i Ligjit dhe Qeverisja Ashtu që t'i Përbushin Nevojat e Qytetarëve**

Ende ekzistojnë mundësi të shumta në nivel qendror e lokal për partnerët që të ofrojnë asistencë të drejtpërdrejtë për institucionet e Qeverisë së Kosovës, OJQ-të, organizatat vëzhguese të shoqërisë civile, mediet, shoqatat profesionale dhe afariste, dhe institucionet hulumtuese. Përfundimi i ndihmave dhe i nën-granteve të USAID-it për këta pranues historik të ndihmave, nëpërmjet ndërtimit të kapacitetit të tyre do të ketë ndikim të rëndësishëm, në veçanti në kuptim të qëndrueshmërisë dhe të “pjekurisë”.

Që nga shtatori i vitit 2012, Misioni ka nisur me punët e USAID *Forward* të cilat përfshijnë zbatimin e drejtpërdrejtë nëpërmjet sistemeve të shtetit nikoqir në nivel komunal dhe zgjerim të portofolit ekzistues me përkrahje të drejtpërdrejte për organizatat lokale. Këto aktivitete fillestare përkrahën komunën me performancë më të mirë, e cila ishte Istogu, dhe dy OShC lokale që bëjnë monitorimin e gjykatave nga niveli lokal dhe kryejnë punët në ngritje të vetëdijes për sundimin e ligjit.

Gjatë periudhës fillestare të strategjisë (VF 2014 - VF 2016), USAID-i do të vazhdojë ndërtimin e kapacitetit të pushteteve lokale, OShC-ve lokale dhe shoqatave të sektorit privat me qëllim të zgjerimit të portofolit ekzistues të granteve të drejtpërdrejta. Këto përpjekje do të shtojnë vetëdijen publike dhe do të nxisin llogaridhënien qeveritare ashtu që qytetarët të mund të angazhohen në mënyrë proaktive me degët e ndryshme të qeverisë. Përveç kësaj, ky partneritet i zgjeruar do të përfshijë ndihmën e drejtpërdrejtë për koalicionet e OShC-ve siç janë Demokracia në Veprim (DIA) për të përkrahur monitorimin e pavarur dhe të paanshëm të zgjedhjeve, ndihmën e drejtpërdrejtë për organizatat hulumtuese të cilat bëjnë hulumtime parlamentare, dhe përkrahje të drejtpërdrejtë për shoqatat udhëheqëse afariste siç janë Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës me qëllim të përforcimit të tribunaleve të arbitrazhit nëpërmjet trajnimeve profesionale, sistemeve për menaxhim të lëndëve dhe informim në terren për komunitetin afarist. Organizatat të cilat përkrahin popullsinë më të rrezikuar (gratë, invalidët, rininë dhe LGBT) dhe pakicat do të pranojnë vëmendje të veçantë, në veçanti në lidhje me nismat e tyre për avokim dhe nismat të cilat përmirësojnë pozitën e tyre në shoqëri.

Gjatë tërë periudhës së strategjisë dhe nën këtë OZh, Misioni do t'i japë prioritet shfrytëzimit të sistemeve të Qeverisë së Kosovës për zbatim të drejtpërdrejtë të pjesës më të madhe të portofolit të vet, kurdoherë që është e mundshme. Kjo do të përfshijë asistencën e drejtpërdrejtë për institucionet qendrore, për shembull për Ministrinë e Drejtësisë për të udhëhequr me procesin përpilimit të strategjisë për të drejtat pronësore, përfshirë politikat, ligjet dhe rregulloret prioritare. Asistenca mund t'i ofrohet pushteteve lokale/komunave për t'i përbushur detyrat e përgatitura individualisht me qëllim të demonstrimit të praktikave të qeverisjes së mirë, menaxhimit të shëndoshë financiar, llogaridhënies, si dhe tolerancës e bashkëpunimit të shtuar ndëretnik. Sistemi i pushtetit lokal gjithashtu do të merret parasysh për krijimin dhe zbatimin e sistemit provues të përbashkët për informim në mesin e gjykatave, regjistrave civil, autoriteteve tatimore dhe kadastrave komunal të cilët do t'u mundësojnë qytetarëve kryerjen e të gjitha transaksioneve pronësore në një vend të vetëm.

OZh1 do të avancojë qëllimet e USAID *Forward* në lidhje me vlerësimin, menaxhimin e talenteve dhe inovacionit, si dhe në shkencë e teknologji. Sa i përket inovacionit, e-qeverisja në nivel lokal do të zgjerohet dhe do të përkrahet.

### **OZh2: Të Shtohen Investimet dhe të Rritet Punësimi në Sektorin Privat**

Asistenca e drejtpërdrejtë për institucionet e Qeverisë së Kosovës në nivel të ministrive qendror dhe në nivel komunal (lokal), si dhe asistencë direkte për OJQ-të vendore profitabile apo joprofitabile,

kompanitë private, dhe mundësisht institucionet akademike dhe bartësit e aftësimit, do të jenë një nga karakteristikat kryesore të zbatimit të OZh2 të cilat synojnë përfundimin e kapaciteteve ashtu që organizatat kryesore të qeverisë dhe të sektorit privat të mund të ofrojnë shërbime cilësore në mënyrë të qëndrueshme. Kjo gradualisht do të zvogëlojë varësinë nga asistenca teknike ndërkombëtare, dhe do të mundësojë kufizimin e asistencës donatore, gjatë periudhës së strategjisë së USAID-it, për ato fusha ku ende kërkohet përkrahje për politikën dhe për legjislacionin kompleks si dhe për transaksione.

Të gjitha aktivitetet nën këtë OZh do të përfshijnë asistencën Qeveria-Qeverisë (G2G) që do të shtojë përgjegjësitë (dhe kapacitetin) e Qeverisë së Kosovës në menaxhimin e fondeve të asistencës teknike nga Qeveria e ShBA-së të cilat synojnë ta bëjnë Kosovën më joshëse për investime të huaja direkte nëpërmes përmirësimit të mjedisit të favorshëm afarist dhe krijimit të një gjendje më stabile dhe më të qëndrueshme makro-ekonomike dhe fiskale. Përveç kësaj, marrëveshjet G2G me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të përkrahin përpilimin dhe zbatimin e politikave bujqësore të cilat përmirësojnë konkurrueshmërinë e produkteve dhe punësimin në këtë sektor. Institucionet tjera që mund të bëhen homologe të G2G përfshijnë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Administratën Tatimore të Kosovës, dhe komunat e zgjedhura.

Në fushën e ngritjes së konkurrueshmërisë së sektorit privat, asistenca direkte për institucionet këshillimore joqeveritare do të përforcojë kapacitetin e tyre në ofrimin e shërbimeve këshillimore të cilat nxisin rritjen e sektorit privat. Këto institucione joqeveritare do të përfshijnë institucionet financiare jo-bankare të cilat ndihmojnë në shtimin e kredive për sektorin privat nëpërmes mekanizmave të ndryshëm, përfshirë edhe garancinë e pjesshme të kredisë. Një konsideratë e rëndësishme në lidhje me këtë është inkurajimi dhe përkrahja e organizatave lokale të cilat nxisin krijimin e bizneseve dhe të organizatave të cilat janë pronë/udhëhiqen nga gratë dhe pakicat.

Përveç G2G, objektivat e USAID *Forward*, siç janë monitorimi dhe vlerësimi, menaxhimi i talenteve, si dhe inovacioni, shkenca dhe teknologjia, do të përfshihen sa më shumë që mundën në të gjitha aktivitetet e OZh2. Në veçanti ekziston fokusi më i fortë në matjen e ndikimit të asistencës së USAID-it në përgjithësi, përfshirë ndikimin e aktivitetëve të G2G në nivel qendror dhe lokal.

### **OZh3: Të Forcohet Kapitali Njerëzor**

Edhe pse OZh3 nuk ka të planifikuar kurrfarë nisme të drejtpërdrejtë për reforma në prokurim nga USAID *Forward*, ajo reformë është e rrënjësuar mirë në parimet bazë të *Forward*-it, do të thotë zhvillimi afatgjatë i kapacitetit lokal me objektivin e deklaruar të 'Forcimit të Kapitalit Njerëzor'. Përfituesit e mundësive arsimore të ofruara nga USAID-i do të bëhen individë të aftësuar vendor, të cilët do ta çojnë Kosovën kah e ardhmja. Me progresin e kënaqshëm të planit të veprimit për reforma, asistenca mund t'i ofrohet drejtpërdrejtë Universitetit të Prishtinës, si një organizatë publike vendore, ashtu siç është përshkruar në përmbledhjen e Objektivit Zhvillimor.

## Shtojca 3: Bibliografia

- Departamenti i Shtetit/Byroja për Çështje Evropiane dhe Euro-Aziate dhe Byroja e USAID-it për Evropë dhe Euro-Azi, *Strategjia e Përbashkët Rajonale, VF 2014 - VF 2016*.
- Bashkimi Evropian, *Raporti i Progresit për Kosovën 2010*
- Bashkimi Evropian, *Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen për Stabilizim Asociim në mes të BE-së dhe Kosovës*, Bruksel, 2012
- Qeveria e Kosovës, *Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit 2007 (Plani i Ahtisaarit)*
- Qeveria e Kosovës, *Vizioni dhe Plani i Veprimit për Zhvillim Ekonomik (VPVZhE)*, prill 2011
- Qeveria e Kosovës, *Plani i Zbatimit për Ligjin e Ri për Gjykatat 2011*
- Qeveria e Kosovës, *Strategjia e Kuvendit të Kosovës për Marrëdhëniet me Publikun 2012*
- Qeveria e Kosovës, *Programi Legjislativ 2013*
- Qeveria e Kosovës, *Prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë 2011-2014*
- Qeveria e Kosovës, *Raport për Zbatimin e Decentralizimit 2012*
- Qeveria e Kosovës, *Rezoluta që Miraton Parimet e Prishtinës që Rrjedhin nga Samiti i Grave*, tetor 2012
- Qeveria e Kosovës, *Strategjia e Vetëqeverisjes Lokale 2012-2015*
- Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim, Korporata Ndërkombëtare për Financa dhe Agjencia Multilaterale për të Garantuar Investimet, *Strategjia Shtetërore për Partneritet për Republikën e Kosovës për Periudhën VF12-VF15*, Maj 2012
- Shyqyri Kelmendi, *Resurset Natyrore, Baza për Zhvillimin Ekonomik Kombëtar*, 2012
- Malazogu, Leon dhe Dusan Pavlovic, *Komuniteti Serb i Kosovës—Nga Stabilizimi në Qëndrueshmëri*, Qershor 2012
- Moujaes, Chadi N.; Najjar, Mazen Ramsay; Shediak, Richard; Ghaleb, Joey, *Elastik, Stabil, i Qëndrueshëm: Përfitimet nga Diversifikimi Ekonomik*, Booz & Company, Maj 2011
- Naim Rashiti, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, *Serbia dhe Kosova: Shtegu drejt Normalizimit*, Shkurt 2013
- STRAS, *Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Sociale, Potenciali i Industrisë së Rëndë dhe Kontributi i saj në Zhvillim*, Nëntor 2012
- USAID 2012, *Vlerësimi Shtetëror i Çështjeve Gjinore për USAID/Kosovë*, Gusht 2012
- USAID, *Strategjia për Zhvillim dhe Ndryshim Klimatik*, Janar 2012
- USAID, *Vlerësimi i Konfliktit: Rrënim i Mureve të Padukshme*, Shtator 2012
- USAID, *Strategjia për Arsim: Përmirësimi i Jetesës Përmes Mësimnxënies*, 2005
- USAID, *Udhëzues për Praktikën më të Mirë për Zgjedhje të Sigurta*, Mars 2013
- USAID, *Korniza për Zgjedhje të Sigurta*, Korrik 2010
- USAID, *Politika për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave*, 2012
- USAID, *Doracak për Zhvillimin e Kapacitetit Njerëzor dhe Institucional*, Gusht 2011
- USAID, *Zhvillimi i Kapacitetit Njerëzor dhe Institucional, Vlerësim: Kosova*, Gusht 2012
- USAID *Kosova: Analizë e FAA 119 Biodiversiteti, Pjesa e Dytë, Plotësimi i Nevojave për Konservim të Biodiversitetit në Periudhën 2013-2018*, tetor 2012
- USAID, *Diagnozë e Rritjes në Kosovë: Analizë e Pengesave*, Shtator 2012
- USAID, *Sigurojmë të Ardhmen: Strategji për Rritjen Ekonomike*, Prill 2008
- USAID, *Studim mbi Efektin e Furnizimit të Parregullt me Rrymë Elektrike në Bizneset Kosovare*, Nëntor 2012
- USAID, *Diagnozë e Rritjes në Kosovë: Analizë e Pengesave*, Shtator 2012
- USAID, *Vlerësimi i Fondit Kosovaro-Amerikan për Arsim (KAEF)*, Gusht 2012
- USAID, *Politika për Zhvillimin e Rinisë*, 2012
- UNDP, *Raport i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2012*
- UNDP dhe USAID, *Raporti nr. 4 i Pulsit Publik, 4 gusht 2012*
- UNDP dhe USAID, *Raporti nr. 5 i Pulsit Publik*, Shkurt 2013

Qeveria e ShBA-së (Shtëpia e Bardhë), *Nisma e Presidentit Obama për Zhvillim të Politikave dhe për Ndryshimin e Klimës Globale*, Tetor 2010

Banka Botërore, *Treguesit e Zhvillimit Botëror 2012*

Banka Botërore, *Strategji Shtetërore për Partneritet*, Maj 2012

Banka Botërore, *Raporti i të Bërit Biznes 2013*

Banka Botërore, Njësia për Ulje të Varfërisë dhe Menaxhim Ekonomik, *Kosova Zhbllokon Potencialin për Rritje: Strategjitë, Politikat, Veprimet; Memorandum Ekonomik i Shtetit*, Prill 2010